

# PAQJA

REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË



Viti V . Nr. 48. 19 nëntor - 19 dhjetor 2010. Organ i shoqatës kulturore "Zëri Ynë"

Çmimi 0.80€

**Prof. dr. Milazim KRASNIQI**

**VDEKJA E KAHMOTSHME E SHKRIMTARËVE  
NË TOKËN E MULLENJAVE**




**Prof. dr. Naser RAMADANI**

**KONGRESI 'PA' VENDIME**



Intervistë me pilotin shqiptar, James Berisha

**GJYSMËS SË PLANETIT ME AEROPLAN  
PËR TË LOBUAR PËR KOSOVËN**



**Zëri Ynë**  
SHOQATA KULTURORE



**6** Sindikatat e (pa)fuqishme

**Portreti i muajit:** Klithmë ishte emri i tij ..... 2

**Milazim Krasniqi:** Vdekja e kamotshme e shkrimtarëve në Tokën e Mullenjave ..... 3-4

**Shenasi Xheladini:** 98 vjet më parë ..... 5-6

**Lulzim Ahmeti:** Sindikatat e (pa)fuqishme ..... 6-7

**Isa Mehmeti:** Një qasje më serioze ndaj kërkim-lëmoshës ..... 8

**Përparim Bublaku:** Brenda gjashtë muajve, 32 vetëvrasje në Kosovë ..... 9

**Mr. Milazim Mustafa:** Regjistrim i popullsisë apo...? ..... 10-11

**Edona Magashi:** Ademi: Uniforma po respektohet nga njerëzit e ligjit ..... 12

**Drita Vitia:** Shkrim-lexim për të gjithë studentët 13

**Fitim Fetahu:** Përplasje Shqipëri – Kosovë rreth gjuhës shqipe ..... 14-15

**Astrit Veliqi:** Zvarriten procedurat e nostrifikimit të diplomave ..... 16

Intervistë me pilotin shqiptar, James Berisha... 17-19

Poster i Rexhep Tajip Erdogan ..... 20-21

**Emine A. Vezaj:** Bakshishet e Erdoganit! ..... 22-23

Intervistë me gjinekologjen Arbenita Beqiri-Arifi.. 24-25

**Fatos Shala:** Viteve të fundit Kosova ka rënie të natalityetit ..... 26

**Qëndresë Mustafa:** Kërkojmë repart të veçantë për të burgosurit me çrregullime mentale ..... 27

**Fatos Rushiti:** Zbulohet ilaçi që zhduk kujtimet e këqija ..... 28

**Naser Ramadani:** Kongresi 'pa' vendime ..... 29

**Arsim Jonuzi:** Kush fitoi dhe kush humbi në Irak? . 30-31

Intervistë me artistin Naser Shatrolli ..... 32-33

**I. T.:** Alfabeti i Antropologjisë ..... 34

**Imer Topanica:** Bukuria e zërit ..... 35

**E. Ymeri:** Letërsia bëhet shkencë ..... 36

**Artan N. Bejta:** Diabeti epidemia e mijëvjeçarit të tretë ..... 37-38

**Alban Bilalli:** Nuk pi alkool, jam musliman ..... 39

**Alban Bilalli:** Futbollistja shqiptare e nominuar për "Topin e Artë" ..... 40



**8** Brenda gjashtë muajve, 32 vetë...




**10** Regjistrimi popullsisë apo...?



**16** Zvarriten procedurat e nostrif...



**24** Intervistë me Arbenita Beqiri



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,  
KULTURË, ARSIM, ETIKË  
Viti V / Nr. 48

19 nëntor 2010 - 19 dhjetor 2010

Botues

Zëri Ynë

O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor

Muhamed Jusufi - KAJOLLI  
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës

**Avni AVDIU**

avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës

**Flamur MALOKU**

flamurmalku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika

**Osman D. GASHI**

osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore

**Mimoza SINANI**

e-mail:

revistapaqja@gmail.com

revistapaqja@hotmail.com

http://www.zeri-yne.org

Adresa:

Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,  
përballë teatrit Dodona,  
Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

# KLITHMË ISHTE EMRI I TIJ

**P**oezia e Din Mehmetit ishte pasqyrim i realitetit shqiptar, i atij realiteti të hidhur që u bë frymëzim për poetin. Metaforat e tij nuk ishin fiktive – iluzion i ndonjë inspirimi të rastësishëm, por ishin përballje me stuhitë e kohës, së cilës i qëndroi me dinjitet, duke marrë mbi supe një mision, sa fisnik aq edhe të guximshëm: për t'i jetësuar ëndrrat e ëndërruara me shekuj, për të dhënë sinjalin simbolik se po vinin ditë më të mira që ato ëndrra të bëheshin realitet. Dhe ashtu edhe ndodhi. Vargjet e tij poetike kënaqën veshin e shumë dashamirëve të fjalës së shkruar, shëruan shumë shpirtra të zhytura në mjerim dhe i dhanë forcë krahëve të shqipes së plagosur që të fluturojë majave për t'u ngjitur drejt

pedestalit të lirisë. Poezia e tij dha forcë e besim ndër kohëra për ta mbajtur të pashuar fanarin e shpresës së megjithatë vinin ditë më të mira. Ai i dha frymë popullit të plandosur përdhe, që sërish ta marrë veten e të ngrihet në këmbë stoik përballë furtunave të kohës, i dha zemër për ta sfiduar botën e pazemër. Vepra dhe biografia e tij do të mbetet flakadan që ndriçon rrugën drejt ardhmërisë. Me penën e tij, ai arriti ta materializojë idenë e dashurisë për atdheun, lirinë dhe qëndresën. Libri i tij me titull "Fatin tim nuk e nënshkruaj" nënkupton simbolikën që u jepte vasalëve të kohës se nuk duhet vënë firma që kurdisin fatin tragjik të popullit. Shkroi aq shumë për Kosovën, të cilën e deshi shumë fort. Me forcën, dijen dhe penën e tij, ai ia dha hakun Kosovës, por atij nuk i dolën hakut ata që ishin kompetentë ta bënin këtë. ■



## BIOGRAFIA:

Në moshën 78 vjeçare ndërroi jetë **Din Mehmeti**, një ndër poetët më të shquar të Kosovës. Lindi në fshatin Gjocaj të Junikut. Gjuhën dhe letërsinë shqipe e kreu në Beograd. Më pas punoi si profesor në Shkollën Pedagogjike të Gjakovës. Poezinë e parë e botoi në vitin 1949 në revistën letrare 'Jeta e re'. Ka botuar edhe kritika letrare dhe ka edhe një dramë. Veprat më të njohura të tij janë: 'Në krahët e shkrepave' (1961), 'Rini diellore' (1966) 'Dridhjet e dritës' (1969), 'Heshtja e kallur' (1972), (1974), 'Fanar në furtuna' (1981) 'Agu, dramë' (1982), 'Prapë fillimi' (1996), 'Mos vdis kur vdiset' (2001), 'Klithmë është emri im' (Tiranë 2002). Gjatë luftës ishte përhapur lajmi i rremë se qe vvarë nga policia serbe.

Në varrimin e Din Mehmetit

# Vdekja e kahmotshme e shkrimtarëve në Tokën e Mullenjave

Poetët si Din Mehmeti i ndjerë, edhe kur janë iluzionistë të pandreqshëm, e meritojnë një grimë respekti që buron nga ngrohtësia e afërsisë njerëzore, e jo një mal respekti të rremë që prodhohet nga hipokrizia

## Milazim KRASNIQI

**L**ajmin për kohën kur do të bëhej varrimi i poetit Din Mehmeti në varrezat e Gjakovës, ma kumtoi një miku im, derisa po hyja në oborrin e xhamisë për të falur xhumanë. Kjo ditë mua ma shton gëzimin e jetës, sepse është ditë e takimit me shumë miq, ditë e lutjeve të shtuara dhe ditë kur e ndiej më shumë ngrohtësinë e afërsisë vëllazërore me njerëz, madje edhe me ata që nuk i njoh. Ka vite që kjo atmosferë e ngrohtësisë njerëzore ma ka zëvendësuar zymtinë e vetmisë “poetike”, e cila është e njohur për jetën e shumë poetëve/ shkrimtarëve. Pas faljes së xhumasë, m’u desh të largohem më shpejt nga oborri i xhamisë, pa mundur ta marr të plotë atë kënaqësi të afërsisë vëllazërore me njerëz, sepse bashkë me tre kolegë u nisëm drejt Gjakovës, për të marrë pjesë në varrimin e kolegut e mikut tonë të vjetër. Pra, po shkonim në varrimin e tij e jo në vdekjen e tij, gjë që ka një domethënie të veçantë në tërë këtë tregim.

Sa i përket vdekjes biologjike, ai kishte vdekur po këtë të premte në orët e mëngjesit, ndërsa sa i përket vdekjes si poet, si shkrimtar, ai bashkë me kolegët e tjerë, ka vdekur shumë më herët. Ka vite që në këtë vend ka vdekur vetë profesioni i shkrimtarit, sepse askush, ama bash askush, nuk mund të jetojë prej këtij profesioni. Ngjashëm me disa zeje të tjera që janë zhdukur e po zhduken, edhe zeja e shkrimtarit praktikisht është zhdukur në këtë vend, për arsye se ata që gjoja i bëjnë ligjet po që në fakt e bëjnë ligjin, nuk kanë nevojë për ta as për prodhimet e tyre.

Pushteti praktikisht i ka përjashtuar shkrimtarët nga shoqëria e nga shteti, edhe më keq nga sa propagandonte Platoni te “Shteti” i tij. Platoni së paku i mëshironte

ata poetë që do t’u këndonin të mirave, ndërsa në vendin tonë - të mullenjave, i kanë përjashtuar edhe ata poetë e shkrimtarë që do t’u këndonin himne pushtetarëve. Thjesht e kanë zbatuar me rigorozitet të paparë idenë e Platonit që shteti të jetë pa shkrimtarë, madje edhe pa fjalën e tyre të shqiptuar me zë të ngjirur e me figura të errëta.

Kosova jonë e dashur, e cila nga poetët si Din Mehmeti, është shndërruar në një vizion mitik për botën e për lirinë, është vend në të cilin të dy asociacionet e shkrimtarëve, Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës dhe PEN Qendra e Kosovës, nuk kanë objekte të vetat, ku do të kishin një adresë në të cilën shkrimtarët do të mund të takoheshin. Lidhjes (ish- Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës) i është marrë ndërtesa, për të ngritur aty një muze të pavarësisë. Ka shumë njerëz në këtë vend që nuk e dinë pse është ngritur muzeu i pavarësisë bash në atë ndërtesë modeste, e cila ishte e shkrimtarëve. Dhe nuk kanë faj që nuk e dinë, sepse nuk

ua ka shpjeguar askush. Paradoksalisht, shkrimtarët janë lënë pa objektin e tyre, janë lënë në rrugë, për shkak të meritave të mëdha që kanë pasur për lirinë e pavarësinë e vendit tonë. Në atë ndërtesë, shkrimtarët shqiptarë të Kosovës kanë planifikuar bisedat e famshme me shkrimtarët serbë në prill të vitit 1988, me të cilat u tronditën nga themelet përrallat e “vëllazërim-bashkimit” dhe e “barazisë së kombeve e të kombësive të Jugosllavisë”. Një diplomat britanik që pati ardhur në atë ndërtesë një muaj pas atyre bisedave, pati deklaruar se për herë të parë në ato biseda e kishte kuptuar se sa i thellë ishte konflikti ndërmjet shqiptarëve e serbëve për Kosovën. Nga njohuritë që u zbuluan për “qarqet ndërkombëtare”, falë atyre bisedimeve, Ibrahim Rugova u fokusua si lideri i ardhshëm i shqiptarëve të Kosovës dhe shkrimtarët shqiptarë u fokusuan si zëri autentik i këtij populli. (Muzeu u ngrit veç për Rugovën, duke përjashtuar e harruar të gjithë kolegët e tij shkrimtarë, me të cilët ai punoi në projektin e madh të pavarësisë së vendit.) Në atë ndërtesë janë shkruar me dhjetëra protesta, reagime e memorandume, ku kërkohej drejtësi për Kosovën. Para asaj ndërtese janë organizuar, po nga shkrimtarët, shumë protesta kur në vitin 1990, regjimi serb e okupoi atë dhe e mbylli, krahas okupimit dhe mbylljes së Radiotelevizionit të Prishtinës dhe të ndërtesës së Kuvendit të Kosovës. Ndër të tjera, në atë ndërtesë është formuar Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, Lidhja Demokratike e Kosovës e shumë asociacione të tjera. Ajo ndërtesë vërtet ka bërë një pjesë të historisë së këtij vendi. Sa për përkujtesë për të gjithë të painformuarit dhe ata që harrojnë qëllimisht, dua të përkujtoj se gjatë viteve 1986-1998, në të cilat roli i shkrimtarëve të mbledhur në Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës ka qenë kaq i madh, Din Mehmeti



ka qenë anëtar i kryesisë së saj dhe njëri nga zërat e fortë më mbrojtje të kauzës shqiptare përballë terrorit dhe okupimit serb. Sado që nga natyra ishte i ndrojtur dhe i trembur, ai e thoshte fjalën e vet qartë, me gjithë emocionin që shpesh ia bënte zërin të dridhshëm.

Vetë nuk kam hyrë në atë muze të pavarësisë, të ngritur në ish-ndërtesën e uzurpuar të shkrimtarëve (nuk më ka ftuar kush në hapjen e saj, edhe pse në vitet 1988-1999 kam qenë administruesi zyrtar i saj si sekretar i Shoqatës) dhe nuk e di a ka ndonjë fotografi të Dinit aty, por nëse nuk ka, ai muze nuk është i plotë. Sidoqoftë, godina ku ata shkrimtarë kanë vepruar, ku ata kanë formësuar vizionin e një Kosove të pavarur, ku kanë rezistuar kundër represionit e okupimit, e ka fituar satisfaksionin e saj, duke u shndërruar në muze, ndërsa vetë shkrimtarët janë lënë në rrugë, janë lënë jashtë ligjit, janë harruar për gjallje. Si branshë praktikisht janë përjashtuar nga shoqëria.

Shpeshherë jam munduar ta gjej arsyen e kësaj urrejtjeje ndaj shkrimtarëve dhe dijetarëve në Kosovën e pasluftës, por nuk e kam gjetur. As sot nuk e kam të qartë, sepse urrejtja dhe hakmarrja ndaj tyre është në shpërpjesëtim të madh me fajet eventuale të tyre, cilat do që të kenë qenë ato. Më duket se ndër të tjera, motivi i kësaj urrejtjeje ndaj shkrimtarëve ka të bëjë me fshirjen e kujtesës, me synimin që të thuhet se historia e Kosovës ka filluar me këta burra që po e bëjnë ligjin në këtë vend. Cektësia e ligjërimit të tyre fshihet më lehtë kur nuk është e krahasueshme me fjalën e bukur, me gjuhën e pasur dhe me dashurinë sublime për kombin, që janë prodhime të shkrimtarëve. Llomotitja vulgare e politikanëve e ka mundur poezinë, sjellja brutale po e politikanëve, e ka zëvendësuar fisnikërinë e poetëve, urrejtja e motivuar politikisht ndaj bashkëkombësve e ka zëvendësuar dashurinë që ishte mesazhi më sublim i artit poetik të shkrimtarëve shqiptarë, gjithsesi edhe të poezisë së Din Mehmetit.

Një teoricien i njohur i artit ka thënë se gjuha e poezisë e ngjall ndjenjën e njeriut ndaj gjuhës dhe të gjuhës ndaj realitetit, duke mundësuar fisnikërimin e njeriut dhe njohjen më të plotë të realitetit. Profiterët që nuk dinë të formulojnë drejt një fjali të vetme, por që brenda pak viteve janë bërë pasanikë, nuk kanë nevojë as për fisnikërim e as për njohje më të plotë të realitetit. U mjafton të njohin zbrazëtitë e ligjit dhe e shohin veten të fituar. Prandaj as nga kjo anë nuk ka nevojë që shkrimtarët të jenë pjesëtarë të shtetit e të shoqërisë, sepse ata më të shumtën nuk pajtohen me të keqen, protestojnë ndaj saj dhe e tregojnë me gisht keqbërësin, qoftë dhe vetëm me figura të errëta poetike si ato për Kainin (Kabilin), Judën ose Brutin.

Në varrimin e Dinit mbërritëm me kohë, si në një reprizë teatri, ku askush nuk është për ngut. Takuam edhe shumë nga kolegët tanë, ngushëlluam njëri-tjetrin, ndonëse për ata që kanë vdekur moti, ngushëllimi më shumë është hipokrizia, se sa shprehje e sinqertë e dhimbjes. Ngushëllimet në këtë rast ishin me vend për Dinin si familjar, si bir i Gjocajt, si qytetar i Gjakovës, por jo si poet. Sepse ky profesion ka kohë që ka vdekur në këtë vend.

Paradoksalisht, në varrimin e Dinit, askush nuk u lut për shpirtin e tij. Si për ta mbyllur tërë tregimin për vdekjen absurde të shkrimtarit, me një kapitull të ri absurdi jetësor, që po shpalos kthetrat si mullenjë e zezë mbi këtë vend: varrimi pa adete fetare.

Vetë e lashë që të bëjë një lutje për shpirtin e Dinit, kur ta

marr veten nga hidhërimi që më shkaktoi trajtimi jokorrekt ndaj tij edhe për së vdekuri.

Së paku një lutje e ka merituar, edhe si i harruar dhe i përjashtuar nga shteti e nga shoqëria. Poetët si Din Mehmeti i ndjerë, edhe kur janë iluzionistë të pandreqshëm, e meritojnë një grimë respekti që buron nga ngrohtësia e afërsisë njerëzore, e jo një mal respekti të rremë që prodhohet nga hipokrizia. ■

# 98 VJET MË PARË

**Shenasi XHELADINI**

**P**ërvjetori i pavarësisë së shtetit shqiptar, ose dita e flamurit, përkon edhe me paraqitjen e parë publike të UÇK-së (1997) dhe ditëlindjen e komandantit legjendar Adem Jasharit (1955). Simbolika e këtyre ngjarjeve është e madhe për nga pesha dhe rëndësia që ngërthejnë ato në vete. Më 28 nëntor të vitit 1912 njëmend u shpall pavarësia e Shqipërisë, por e një Shqipërie të cunguar, të përgjysmuar, të sakatuar në gjymtyrët e saj. Jashtë trugut të saj mbetën rreth e rrotull troje të ndara me popullatë shqiptare, pazarllëk ky i pamëshirshëm i Fuqive të Mëdha të asaj kohe. Kështu, përgjatë afro një shekulli, shqiptarët 'festojnë' ditën e shtetit shqiptar, kombëtarisht të cunguar. Ishte dita e flamurit ajo që mbajti gjallë ndjenjat kombëtare të më shumë se gjysmës së kombit shqiptar të mbetur jashtë kufijve zyrtarë të shtetit shqiptar. 'Rreth flamurit të bashkuar' ishte refreni i himnit kombëtar, por edhe simbolikë që nënkuptonte se shqiptarët asnjëherë nuk e harruan idenë e të qenit një e të pandarë, ndonëse kjo pamundësohej fizikisht përmes kufijve të shumtë. Regjimet totalitare vunë pengesa me tela e gjemba, por nuk ia arritën dot ta shuajnë frymën, shpirtin dhe mendjen e kombit. Ajo rrihte pa pushim nën hijen e shqiponjës dykrenore, e cila bënte roje ditë e natë. Kështu, vrulli për t'i jetësuar idealet nuk u ndal për asnjë çast. U punua në ilegalitet, u veprua pa asnjë hezitim dhe ishin të shumtë ata që s'i trembeshin dot sfidave të hekurta të regjimeve, por u radhitën trup më trup si një armatë e tërë për ta bërë të pamun-

durën e kohës, vetëm e vetëm që të mbahej i pasuar flakadani i lirisë. Qindra e mijëra bijë e bija të popullit pësuan lloj-lloj torturash, por nuk u thyen. Ato i çelëkosën edhe më shumë ata. Ranë edhe shumë viktima. Sa e sa lule u vyshkën për të mbirë përsëri. Çelën lule të tjera – të reja për të mos humbur kurrë aroma dhe hijeshia e vrullit të vegjëlisë. Ishin figurat më emblematike të kombit si vëllezërit Gërvalla, Kadri Zeka, Afrim Zhitia etj, pastaj figura të tjera të qëndrësës, si Adem Demaçi me shokë, që u bënë frymëzim për qindra e mijëra të rinj e të reja. Pushtuesi serb e kishte më kot të vriste, sepse sa më shumë që vriste aq më shumë shtonte ushtarë. Po ashtu, kot e kishte edhe të bënte çfarëdo qoftë tjetër, sepse çdo represion, shoqërohej me më shumë presion ndaj tyre. Kësisoj lindi edhe UÇK-ja sfiduesja moderne e falangave serbe, trashëgimtarja e idealeve të Lidhjes së Prizrenit. Rastësia mund të jetë mbretëresha i ngjarjeve, por jo rastësisht ajo lindi në ditën e pavarësisë, në ditën e flamurit. Ajo lindi mu në këtë datë madhështore për të rinisur një fillim të ri të shekullit, për t'i puqur dy shekujt (20 dhe 21) në një pedestal

të lavdisë kombëtare. UÇK-ja lindi në ditën e pavarësisë së Shqipërisë për ta sjellë ditën e pavarësisë së Kosovës. Lindi në ditën e flamurit për të sjellë në dritë flamurin të shtetit më të ri në botë. Lindi në kohën kur puqeshin shekujt për ta sjellë kurorën e të gjitha shekujve. UÇK-ja lindi në ditën

kur kishte lindur edhe komandanti i saj legjendar Adem Jashari. Edhe kjo 'rastësi e parastësishtë' flet shumë për atë që ndodhi dhe pritej të ndodhte. Kështu u shkrua historia. Filloi (më 1912) e përgjysmuar, vazhdoi për t'u përplotësuar dhe me gjasë do të përfundojë me realizimin e ëndrrave shekullore për bashkimin kombëtar. Në histori kurrë nuk ka vija të kuqe, kurrë nuk ka të pamundura. Për shumë njerëz, kjo që është arritur as që ka mundur të imagjinohej. Mirëpo proceset ecin përpara. Zoti i inkurajon njerëzit ta realizojnë të drejtën e tyre. Mjafton që njerëzit të kenë vullnet, guxim dhe besim për ta bërë atë.

Ndonëse 28 nëntori nuk është në kalendarin e festave shtetërore të Republikës së Kosovës, ai do të festohet nga populli. Populli do të festojë, sepse ai e di vlerën e historisë së vet. Ai është i vetëdijshëm se kjo ditë nuk ka ardhur me shkopin magjik, se janë dashur mund e sakrificat të mëdha për të pasur dy shtete shqiptare.

Mirëpo, krahas kësaj krenarie, për fat të keq, edhe ky 28 nëntor, 98 vjet prej Pavarësisë së Shqipërisë, me gjasë do t'i gjejë shqiptarët të ndarë.

Në Shqipëri opozita ka paralajmëruar protesta, të cilat mund të eskalojnë e të bëhen të dhunshme. Ramës nuk i mjaftoi as liberalizimi i vizave për të kuptuar se interesi i përgjithshëm është mbi atë partiak e klanor. Berisha, po





ashtu, e ka ashpërsuar gjuhën e kritikës, duke mos dhënë shenja për kurrfarë kompromisi. Në Kosovë ethet e zgjedhjeve kanë filluar. Përplasjet e partive politike janë bërë përditshme. Akuzat dhe kundër akuzat ndërpartiake e kanë shndërruar skenën politike në një cirk tragjiko-komik, ku dikush thyen qafën e të tjerët zbardhin dhëmbët. Varfëria vazhdon të trokasë në dyert e një pjese të popullit. Ndërsa politikanët, të gjithë pa përjashtim, premtojnë se do të punojnë për të mirën e këtij populli (derisa sa t'i marrin votat). Dashtë Zoti që lufta e fituar për bërjen e shtetit, të mos humbasë në luftën për krijimin e shtetit (stabil dhe me zhvillim normal). Kësaj radhe kam drojë se edhe Dita e Flamurit do të kalojë nën hije, nga zgjedhjet që kush e di a do të ofrojnë ndonjë farë zgjidhje (të situatës së krijuar). Ka rrugë të gjerë dhe të hapura, por edhe rrugica, lakesa dhe qorrsoakë. ■



Gjendje e rëndë e punëtorëve kosovarë

# SINDIKATAT E (PA)F

**Themelimi i sindikatave dhe i organizimeve sindikale në Kosovë ka hyrë shumë në modë, por ato nuk po mund të jenë të fuqishme aq sa duhet, edhe pse për nga numri i tyre janë të shumta. Të vogla janë për nga mundësia e ndikimit në proceset që po ndodhin në Kosovë dhe në përmirësimin e gjendjes së punëtorëve, të cilët çdo ditë e më tepër po e kanë më të vështirë. Për këtë kemi shumë sindikata të pafuqishme. Por një shpëtim për punëtorët do të ishte funksionalizimi i Këshillit Ekonomik dhe Social, si dhe implementimi i Ligjit të Punës, që Qeverisë së Republikës së Kosovës do t'i kushtonte 1.8 milionë euro**

**Lulzim AHMETI**

**K**rijimi i sindikatave dhe i grupeve, të cilat proklamohen si mbrojtëse të të drejtave të punëtorëve dhe bizneseve, kohëve të fundit është goxha i madh. Pothuaj çdo sektor në Kosovë ka formuar sindikatën e vet të "fuqishme". Faktin se sindikatat nuk e kanë fuqinë e duhur e pranojnë edhe udhëheqësit dhe ekspertët e tyre, edhe pse kjo ndoshta mund të asociojë me skepticizëm, por, duke i parë proceset në të cilat kanë kaluar dhe po hyjmë, mund të konstatojmë se sindikatat janë të pafuqishme për të ndikuar sadopak në vendimet e Qeverisë. Që nga fillimi i procesit të privatizimit në Kosovë, në vitin 2004, sindikatat kanë ngritur zërin vazhdimisht, por ato nuk ka ndikuar që ky proces të ndërrojë formën dhe mënyrën e privatizimit të ndërmarrjeve kosovare. Si pasojë e këtij procesi janë shitur shumë ndërmarrje të mëdha me shuma qesharake parash, por kanë mbetur edhe shumë punëtorë pa punë. Llogaritet se, që nga fillimi i tij e deri më tash, 75 mijë punëtorë i kanë humbur vendet e tyre të punës. Pavarësisht protestave, ata kanë arritur të ndikojnë pak ose aspak në vendimet, të cilat janë marrë e që shumë shpesh kanë qenë në kurrizin e tyre.

## Gjendja e rëndë e punëtorëve

Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), Haxhi Arifi, e përshkruan gjendjen e punëtorëve kosovarë si tepër të rëndë. Sipas tij, mosfunksionalizimi i Këshillit Ekonomik dhe Social (KES), aplikimi i Ligjit të Punës në praktikë dhe normave të tjera, po e vështirëson edhe më shumë

këtë gjendje dhe po e bën situatën çdoherë e më shumë të pafavorshme për punëtorët. Edhe pse është kjo gjendje e punëtorëve, Arifi ka thënë se organizata, të cilën e drejton ai, po punon në atë drejtim që të përmirësohet gjendja e punëtorëve. "Gjendja e punëtorëve është shqetësuese, por më shqetësuese është se nuk po vërehet drita e gjelbër për përmirësimin e gjendjes në fund të tunelit", - ka thënë Arifi. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, sipas tij, është duke insistuar që pas miratimit të Ligjit të Punës të përmirësohet gjendja e punëtorëve. Arifi ka thënë se gjendja është e vështirë edhe për punëtorët të cilët punojnë në sektorin privat. "Ne si BSPK jemi duke u munduar që, pas miratimit



# FUQISHME

të Ligjit të Punës, të funksionalizohet Këshilli Ekonomik dhe Social, sepse pa hyrë këto në binarët e vet gjendja e punëtorëve nuk mund të përmirësohet”, - ka thënë numri një i BSPK-së, Haxhi Arifi.

## KSLK-ja s'ka bashkëpunim me BSBK-në

Edhe nënkryetari i Konfederatave të Sindikatave të Lira të Kosovës (KSLK), Ali Dragusha, pajtohet se sindikatave u ka humbur fuqia për të ndikuar në proceset dhe në përmirësimin e kushteve të punëtorëve. Sipas tij, kjo është edhe si pasojë e mosbashkëpunimit në mes të BSPK-së dhe sindikatës të cilën e përfaqëson ai. Dragusha ka thënë se i kanë bërë ftesë BSPK-së për bashkëpunim, por ata nuk kanë shprehur gatishmëri për një gjë të tillë. “Ka dy tri vite që fuqia e sindikatave është dobësuar, sepse energjitë nuk po drejtohet në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, por brenda sindikatave”, - ka thënë Dragusha. Ai e ka quajtur procesin e privatizimit si të paefektshëm. “Privatizimi deri më tash është i dështuar sepse nuk ka krijuar vende të reja pune, e po ashtu nuk ka bërë që vendi të zhvillohet ekonomiki-

sht”, - ka theksuar nënkryetari i KSLK-së, Ali Dragusha.

## Sindikatat pa ndikime në procese

Ndërkaq, eksperti i ekonomisë Alban Zogaj ka thënë se sindikatat në Kosovë janë të pafuqishme për shkak se nuk kanë mundur të ndikojnë shumë në procese. Sipas tij, një fakt është mos ushtrimi i ndikimit të mjaftueshëm gjatë procesit të privatizimit. “Roli i sindikatave të punëtorëve në procesin e privatizimit, në përgjithësi, nuk ka qenë me ndikim të madh. Sindikatat në Kosovë nuk kanë fuqi të madhe ndikuese. Kjo është parë në shumë raste, si në procesin e privatizimit, ashtu edhe në proceset e tjera”, - ka theksuar Alban Zogaj, i cili është edhe drejtor për hulumtime në Institutin “Riinvest”. Udhëheqësi i Organizatës ‘Çohu’, Avni Zogiani, vlerësoi se sindikatat në Kosovë janë të blera nga Qeveria, ose janë të paafta për të përfaqësuar vullnetin e punëtorëve për çështjet më të rëndësishme. “Në vazhdimësi, sindikatat kanë humbur rastin që t’i organizojnë punëtorët për t’i mbrojtur ata përballë veprimeve më të rëndësishme të Qeverisë që kanë prekur direkt interesat e punëtorëve”, - ka thënë Zogiani. Por pa funksionalizimin e Këshillit Ekonomik dhe Social, si dhe fillimin e zbatimit të Ligjit të Punës, gjendja e punëtorëve nuk mund të përmirësohet, sepse ende nuk ekzistojnë

mekanizmat e duhur. Sipas parallogaritjeve ta bëra, implementimi i Ligjit të Punës, do t’i kushtonte Qeverisë së Republikës së Kosovës 1.8 milionë euro në vit, por me të, sipas sindikalistëve, do të shpëtoheshin shumë punëtorë, të cilët i kanë humbur vendet e tyre të punës pa fajin e tyre. Privatizimi, i cili ka filluar më 2004, ka prodhuar vetëm një situatë të pakëndshme për shumicën e punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara. Prandaj mund të thuhet se privatizimi ka qenë dhe mbetet proces i dështuar, sepse paratë nga shitja e ndërmarrjeve mbahen ende jashtë vendit dhe nuk investohen në ekonominë e vendit, e cila ka nevojë, si kurrë më parë, për para dhe për hapjen e vendeve të reja të punës.

## 601 ndërmarrje të privatizuara

Ndryshe, deri më tani Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka privatizuar 601 ndërmarrje të reja, prej të cilave 576 janë privatizuar përmes metodës së Spin Off-it të rregullt, ndërsa 25 prej tyre janë privatizuar përmes metodës së Spin Off-it special.

Nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, deri më tani, janë grumbulluar 460 milionë euro, nga procesi i likuidimit me shitje të aseteve të ndërmarrjeve janë grumbulluar 27 milionë euro, kurse nga fondi i privatizimit, punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore iu janë shpërndarë rreth 30 milionë euro. ■



# NJË QASJE MË SERIOZE NDAJ KËRKIM-LËMOSHËS

**Isa MEHMETI**

**K**ëtyre ditëve në Kosovë filloi fushata me moton: “Mos u jepni para fëmijëve lypës... Mos e përkrahni shfrytëzimin e fëmijëve”. Fushata përfshin spote në TV dhe radio, posterë dhe broshura. Ajo do të zgjasë dy muaj. Në një prononcim të tij, kryesuesi i Departamentit për Çështje të Komunitetit, koloneli Fahredin Verboci, e konsideroi të rëndësishëm çdo veprim që ndërmerret për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. “Policia e Kosovës konsideron që çdo aktivitet ose çdo veprim që ndërmerret në mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve është shumë i rëndësishëm për krijimin e një shoqërie të shëndoshë dhe të qëndrueshme. E ardhmja e shoqërisë në përgjithësi varet nga investimet që shoqëria bën në mbrojtjen e fëmijëve”, - ka thënë Verboc. Ai ka njoftuar se si rezultat i kësaj gjendje aktuale operative e policisë së Kosovës në Prishtinë ka lëshuar një plan dhe është kërkuar nga të gjitha drejtoritë rajonale që të hartojnë planin operativ për largimin e lëmshë-kërkuesve nga rrugët. Sipas tij, zgjidhja e këtij problemi me fëmijët që kërkojnë lëmshë, kërkon punë të përbashkët në mes policisë, autoriteteve komunale, punëtorëve socialë dhe organizatave joqeveritare. “Fëmija do edukim, shërbim shëndetësor, mbështetje, dashuri, shpresë dhe inkurajim”, - shtoi Verboc. Policia disponon një provë materiale, në bazë të së cilës vërtetohet se një pjesë e fëmijëve janë të detyruar dhunshëm të kërkojnë lëmshë rrugëve. Në një incizim dëgjohet një fëmijë të jetë shprehur: “Zgjojhem në orën 7.00, në orën 8 dal prej shtëpie. Dal rrugëve dhe kafeneve, kërkoj para. Në shtëpi kthehem në ora 18.00. Në orën 19 dal prapë rrugëve e kafeneve. Prindërit e mi mund të punojnë, por ata duan që unë t’u blej cigare e gjësende të tjera. Më thonë për këtë punë të kemi bërë”. Zëvendës drejtori i policisë rajonale për operacione Nexhat Gutiqi, është shprehur se orientimi kryesor i policisë është rehabilitimi i fëmijëve që kërkojnë lëmshë. Ai ka përmendur rastet e shpeshta kur policia ka identifikuar personat e rritur që kanë udhëhequr me duart e shtrira dhe lutjet

e fëmijëve për lëmshë. Gjithashtu, edhe zëvendës shefi i OSBE-së për të drejtat e njeriut dhe çështje të komunitetit, Volf-Mishel Mors, ka shprehur mbështetjen e misionit të OSBE-së për fushatën. “OSBE-ja do e mbështet policinë, ashtu sikurse e ka mbështetur në një kohë të gjatë dhe ne duam ta mbështesim këtë me kërkesën e policisë. Ai u shpreh se kërkimi i lëmshës nga fëmijët është një brengë e madhe e një shoqërie. Ai, në formë pyetje, ka shprehur shqetësimin e tij para lutjes së një fëmije që kërkon para. “Pse ky fëmijë nuk shkon në shkollë? Pse nuk është në lojë me moshatarët e vet? “Nëse u jepni para fëmijëve, ju nuk i ndihmoni ata. U ndihmoni të rriturve që qëndrojnë para duarve dhe fatit të këtyre fëmijëve. Ne duhet t’i nxjerrim fëmijët nga rruga dhe t’i orientojmë në shkollë. Por duhet angazhim i krejt mekanizmave të shoqërisë. Secili qytetar mund të jetë institucion në vetë, që duhet ta brengosë dora e shtrirë e fëmijës në rrugë”, - ka thënë Volf Mihael. Fushata është rezultat i monitorimit të punës së policisë nga ana e OSBE-së, që ka për qëllim t’i ndihmojë policisë, të jetë efektive, e përgjegjshme dhe të veprojë në pajtim me parimet e të drejtave e njeriut.

Përndryshe, sipas statistikave të Policisë së Kosovës, gjatë periudhës janarshtator të vitit 2010, Policia e Kosovës ka evidentuar 121 raste të fëmijëve që kërkojnë lëmshë, si dhe 180 raste kur lëmshë kanë kërkuar njerëzit e moshës madhore. Të dhënat e njëjta tregojnë se

një pjesë e madhe e lëmshë-kërkuesve janë nga Shqipëria, kurse një numër simbolik nga Kosova.

Kjo fushatë për vetëdijesimin e qytetarëve kundër mbështetjes së kërkimit të lëmshës nga ana e fëmijëve në rajon, duhet parë nga disa aspekte. Pikësëpari është mirë që më në fund u fillua të mendohet për këtë problem. Rrugët e qyteteve në Kosovë janë përplot lypsarë, dhe jo vetëm fëmijë. Klithma e zërit të tyre të çjerrë të çon mornicat dhe është shqetësuese për qytetarin e rëndomtë. Çdo qytetar krahas halleve të tij të përditshme duhet të përballet edhe me këtë fenomen, edhe atë në çdo 20-30 metra. Kjo është më se shqetësuese. Vlen të ceket fakti se edhe në drejtim të Bibliotekës Kombëtare Universitare, rrugës që shpie drejt fakulteteve, ku është frekuentimi më i madh i studentëve vazhdimisht qëndrojnë nga së paku dy lypsarë, që klithin e qajnë, që zhvishen në shi e të ftohtë, duke urrëqethur dhe kanë pamje lemeritëse. Kjo skenë sa shqetësuese aq tronditëse, s’ka dyshim se ndikon emocionalisht te studentët, të cilët ndoshta mund ta humbasin edhe koncentrimin në orët mësimore ose në provime për shkak të këtyre skenave. Është dashur kahmota që organet kompetente të mendojnë në këtë drejtim. Mirëpo gjithashtu ia vlen të thuhet se edhe rrugët që janë paraparë për ta luftuar këtë dukuri nuk janë edhe aq kompatible me rrethanat. Lypsari ka kudo, madje edhe në vendet më të zhvilluara. Kjo dukuri njëmend lidhet edhe me rrjetet e keqpërdoruesve dhe matrapazëve të ndryshëm, por në Kosovë mund të ketë edhe lyp-sari prej zorit dhe kjo është më se e vërtetë. Kjo formë nuk luftohet duke i dëbuar policia lypsarët me dhunë prej rrugëve, sepse ata kërkim-lëmshën e kanë mekanizëm të vetëm të mbijetesës. Atyre u duhet para së gjithash mbështetja institucionale. Në të kundërtën, nëse lypsarëve u mbyllen të gjitha dyert e ekzistencës, atëherë mund të bëhemi gati për të dëgjuar vetëm raste tragjike, siç ndodhi së fundmi në Shqipëri, ku për shkak të varfërisë gjetën vdekjen katër fëmijë në zonën e Sukthit. Pra, luftimi i kësaj dukurie kërkon qasje më serioze. ■



**Viktimat me nënën e tyre:**  
**Robert Xheka lindur më 18 janar 1998**  
**Vilson Xheka lindur më 27 janar 2000**  
**Kasandra Xheka lindur më 17 mars 2002**  
**Nertila Xheka lindur më 5 qershor 2004**

Në Kosovë rritet numri i vetëvrasjeve

# Brenda gjashtë muajve, 32 vetëvrasje në Kosovë

“Pas luftës, ndërkohë që ende janë të freskëta tmerret shkatërruese që bëri okupatori serb në Kosovë, shoqëria dhe institucionet duhen më shumë se asnjëherë të aplikojnë programe parandaluese, psiko-edukative që do të përfshinin individin, familjen, shkollën dhe tërë komunitetin”, - shprehet psikologu Besnik Peci

## Përparim BUBLAKU

**N**umri i vetëvrasjeve në Kosovë vazhdon të jetë një dukuri shqetësuese për shoqërinë kosovare. Sipas Brahim Sadriut, nga Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës (SIPK), që nga 1 janari e deri më 30 qershor të vitit 2010, në Kosovë janë shënuar 32 vetëvrasje, kurse numri i tentimeve për vetëvrasje brenda kësaj periudhe arin deri në 182 raste. Sadriu gjithashtu bëri të ditur se meshkujt janë ata të cilët kanë kryer një numër më të madh të vetëvrasjeve, kurse femrat prijnë sa i përket tentimeve për vetëvrasje. “Bazuar në të dhënat nga SIPK-u, vërehet se meshkujt kanë kryer vetëvrasje tri herë më shumë sesa femrat. Kjo lidhet me faktin se ata i zgjedhin edhe metodat më shumë vdekjeprurëse siç janë: varja në litar, vetëvrasjet me armë zjarri, etj. Ndërkaq, sa i përket numrit të vrasjeve në tentativë vërehet se femrat kanë tentuar të vetëvriten tri herë më shumë sesa meshkujt për faktin se depresioni i godet ato më shumë sesa meshkujt, ndërsa vërehet se ato zgjedhin metoda më pak vdekjeprurëse siç janë: marrja e tepërt e medikamenteve mjekësore, preparateve kimike, prerja e venave, etj.” - ka bërë të ditur Sadriu. Ai, gjithashtu, deklaroi se sa i përket grupmoshave vërehet se me numër më të madh të vetëvrasjeve janë personat nga 21-30 vjeç dhe 41-50 vjeç, kurse numri i personave të cilët kanë tentuar të vetëvriten i takojnë grupmoshës prej 21-30 vjeçare. Bazuar në të dhënat e Sistemit Informativ të Policisë së Kosovës, në vitin e kaluar, në tërë territorin e Kosovës janë shënuar 73 raste të vetëvrasjeve dhe 293 raste të vrasjeve në tentativë.

## **Vetëvrasja – sfidë për të gjithë**

Psikologu Besnik Peci vlerëson se dukuritë si vetëvrasja janë dukuri që pri-



jnë në listën e fenomeneve më sfiduese dhe më komplekse për profesionistët e shëndetit mendor. Sipas tij, janë disa faktorë që çojnë drejt vetëvrasjes te personat e moshës madhore. “Në moshën e pjekurisë mungesa e perspektivës, papunësia, reflektimi i saj në kushtet dhe raportet ekonomike, zhgënjimi i mundshëm, mosuksesi në punë dhe studime, janë disa nga faktorët me të cilët ballafaqohemi që të gjithë, prandaj këto valë të jetës duhet të merren sa më natyrshëm. Ndërsa pas moshës dyzet e pesë vjeçare vijnë në shprehje zhgënjimi total, mosrealizimi i vetes, mosrealizimi i ambicieve, pamundësia e ndryshimit të gjërave, moskujdesi i të tjerëve, humbja e respektit nga të tjerët dhe humbja e perspektivës. Të gjithë këta janë disa nga faktorët me të cilët ballafaqohet një individ i moshuar”, - u shpreh Peci. Ai ka thënë se është obligim primar për çdo shoqëri që të kujdeset për mirëqenien fizike dhe mendore të popullatës së vet, duke theksuar se edhe shoqëria jonë dhe institucionet tona duhet të bëjnë më shumë për parandalimin e kësaj dukurie. “Në Kosovën tonë të pasluftës ku ende e kemi të freskët luftën shkatërruese që bëri okupatori serb, shoqëria dhe institucionet e saj duhen të aplikojnë më shumë se asnjëherë programe parandaluese psiko-edukative që do të përfshinin individin, familjen, shkollën dhe tërë komunitetin”, - tha Peci. Ndërkaq, sipas tij, edhe religjioni si institucion shpirtëror mund të

këtë ndikim të madh në parandalimin e vetëvrasjeve. “Ne jemi të vetëdijshëm se asnjëra nga fetë dhe besimet fetare nuk e përkrah këtë akt, përkundrazi ato shprehen se ky akt do ta lë individin pa shpërblim në këtë botë dhe botën e amshueshme. Edhe hulumtimet që kemi konsultuar e mbështesin këtë. Individët që janë të lidhur me Krijuesin që ata e besojnë, kanë predispozita shumë më të vogla për ta bërë një akt të tillë. Dihet se religjioni i dënon ashpër aktet e tilla. Feja kumton se asnjë njeri nuk ka zgjedhur se kur duhet të lindë, e as nuk mund të zgjedhë se kur duhet të vdesë!” - deklaroi Peci. ■

## **Prin rajoni i Prishtinës**

Në Republikën e Kosovës vetëvrasjet dhe tentimet për vetëvrasje janë prezente në të gjitha rajonet dhe në shumicën e komunave të Kosovës, ku, me numrin më të madh, prin rajoni i Prishtinës. Edhe rajonet e Prizrenit, Pejës dhe Mitrovicës nuk qëndrojnë larg, kurse më pak të prekurra nga kjo dukuri janë rajonet e Ferizajt dhe Gjilanit.

# REGJISTRIM I POPULLSISË APO...?

**Mr. Milazim MUSTAFA**

**R**egjistrimi i popullsisë është një ndër proceset normale dhe të rregullta në të gjitha shoqëritë botërore. Me anë të këtij procesi, goxha të komplikuar, regjistrohet niveli dhe numri i popullsisë, i amvisërive, i bane-save e kështu me radhë. Në veçanti, në Maqedoni ky proces fiton një rëndësi të veçantë, kryesisht pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit. Kjo marrëveshje, me garanci ndërkombëtare dhe e inkorporuar në sistemin juridiko-politik, parasheh që të gjitha bashkësitë që nuk janë shumicë në këtë republikë ish-jugosllave dhe përbëjnë 20 % të popullatës kanë një kategori të caktuar të drejtash. Këtë numër, përveç maqedonasve, e plotësojnë vetëm shqiptarët. Në regjistrimin e fundit të kryer në vitin 2002, shqiptarët përbënin 25,17% të popullatës së përgjithshme të Republikës së Maqedonisë. Kjo solli një pakënaqësi në të dy taborët me të mëdha në Maqedoni. Faktori maqedonas trumbetonte se shqiptarët nuk janë me shumë se 20%, kurse në anën shqiptare thuhej se

ky numër nuk është i vërtetë dhe se në Republikën e Maqedonisë shqiptarët përbëjnë mbi 30 % të popullatës së përgjithshme. Kjo huti vazhdon edhe më tej të mbaj në amulli popullatën e këtij shteti. Këto fakte i ngrenë



**Flora Kadriu**

tensionet për çështjen e regjistrimit, pasi ky proces që duhej të ishte normal dhe i zakonshëm si në çdo shoqëri tjetër, përveç aspektit profesional statistikor merr edhe karakterin politik.

Për të qenë paradoksi dhe dyshimi edhe më i madh është fakti se shtimi natyror i popullatës shqiptare në Maqedoni është shumë më i madh në krahasim me atë maqedonase. Mirëpo edhe përkundër këtij fakti, prapë se prapë përqindja e shqiptarëve nuk rritet në nivelin e shtimit natyror të popullsisë.

Debatet u shpeshuan sidomos me rastin e propozim-ligjit që është në procedurë parlamentare të RM-së. Ky propozim-ligj gëzon edhe përkrahjen e partisë politike shqiptare në pushtet. Ky regjistrim është i paraparë të mbahet në prill të vitit të ardhshëm edhe të zgjasë vetëm 15 ditë. Për të qenë më bindëse rezultatet e këtij regjistrimi, me kërkesën e faktorit shqiptar në pushtet, është siguruar edhe garancia ndërkombëtare, pasi këtë regjistrim do ta përcjellë dhe monitorojë edhe një delegacion special i Eurostatit – zyra për çështje të statistikave e Bashkimit Evropian.

Derisa faktori politik maqedonas hesht dhe pret datën e 1 prillit për të filluar procesin e regjistrimit, në tabarin shqiptar ballafaqohemi me mospajtime dhe konfrontime të skajshme. Partia në pushtet, BDI-ja e Ali Ahmetit, dilemën e vetme e ka në përpunimin dhe publikimin e të dhënave, sepse në Entin Shtetëror për Statistikë, përfaqësimi i shqiptarëve është nën të gjitha nivelet e dëshiruara. Andaj dyshimi i popullatës për këtë institucion është i madh, pasi se, sipas informatave që vijnë nga persona që i njohin punët, thuhet se është bastion i nacionalizmit maqedonas, që me çdo



**Asllan Selmani**

kusht duan ta ulin numrin e popullatës shqiptare në vend.

Partitë e tjera shqiptare opozitare në RM, kanë deklaruar qëndrime edhe më radikale. Partia Demokracia e Re e Imer Selmanit, deklaroi se koha e mbajtjes së regjistrimit është e papërshtatshme dhe se regjistrimi i popullsisë duhet të bëhet në muajin korrik, kur një numër i madh i mërgimtarëve shqiptarë do të



jenë në vendlindje në mënyrë që edhe ata të përfshihen në regjistrimin e popullsisë. Deputetja e kësaj partie, znj. Flora Kadriu, deklaroi se "Demokracia e re, me të gjitha forcat demokratike do të përpiqet që koha e mbajtjes së regjistrimit të popullsisë, e familjeve dhe amvisërive, të shtyhet për muajin korrik, pasi, sipas analizave dhe të dhënave tona, diku afër 30% e shtëpive të shqiptarëve në rrethin e Kërçovës, Strugës dhe Dibres, në periudhën kur është i paparë të mbahet regjistrimi, janë të mbyllura, sepse këto anë janë të njohura për numrin e madh të mërgimtarëve. Përveç se kërkojmë që regjistrimi të mbahet në periudhën e verës, ne, si parti politike shqiptare, kërkojmë që edhe kohëzgjatja e regjistrimit të jetë më e madhe, konkretisht, regjistrimi të zgjat 1 muaj e jo 15 ditë, në të kundërtën do ta thërrasim popullatën shqiptare të dalin me protesta para qeverisë."

Partia tjetër PDSH e Menduh Thaçit, kërcënon se do ta bojkotojë regjistrimin për arsye se shqiptarët akoma nuk e kanë zgjidhur në tërësi problemin e shtetësisë. Pastaj problem tjetër është edhe mosprezenca e diasporës shqiptare, por edhe mungesa e regjistruësve shqiptarë në pjesën maqedonase.

Faktori shqiptar në pushtet mendo-

het që ta largojë këtë dilemë, duke theksuar faktin se regjistrimin do ta kryejë Komisioni Shtetëror për Regjistrim, ku do të ketë proporcionalisht edhe përfaqësues shqiptarë (gjithsej do të ketë 20 veta), e jo Enti Shtetëror për Statistikë. Por ana profesionale e këtij të fundit dhe mospërfshirja e shqiptarëve në këtë ent, e vë në pikëpyetje besueshmërinë dhe legjitimitetin e faktorit shqiptar në shtet.

"Nga vetë fakti se Enti Shtetëror Republikan ka botuar dhe boton çdo vjet statistikën vitale për lindjet dhe vdekjet, shihet shumë qartë se shqiptarët marrin pjesë në shtimin e numrit të përgjithshëm të popullsisë mbi 80 për qind. Kështu për shembull në periudhën prej vitit 1994 deri në vitin 2002 numri i popullsisë shqiptare ka shënuar shtim natyror prej 68 mijë banorëve, ndërsa numri i maqedonasve ka qenë diçka më pak se 3 mijë," - thotë demografi Asllan Selmani. "Ky bastion duhet të demaskohet", - thotë demografi i njohur, - për shkak të numrit të vogël të përfaqësimit të shqiptarëve, sidomos në dikasterin kyç, nga i cili burojnë iniciativat dhe politikat qeverisëse. Ai shton se "statistikat përgjithësisht janë të pasakta, të manipulueshme lehtë dhe pak të besueshme. Mjafton të ndryshohet një numër dhe shumë gjëra ndryshojnë".



Sipas të njëjtit, përqindja e shqiptarëve në RM duhet të jetë mbi 30 %.

Në institucionin që numëron gati 280 të punësuar, përqindja shqiptare është simbolike, deri në 10 për qind, por edhe kjo përqindje përbën shkallët më të ulëta të hierarkisë zyrtare. Vetëm një person është i pozicionuar në post drejtues, ndërsa të tjerët evidentohen si nëpunës të specializuar, si edhe administratorë.

Regjistrimi i popullatës do të realizohet në terren prej 1-15 prill dhe këtë regjistrim do ta bëjnë 20 mijë persona. Paraprakisht kemi një strukturë organizative e cila i bën përgatitjet dhe organizimin e këtij aktiviteti. Rezultatet e para të cilat bëhen në nivel të komunave, do të shpallen pas 60 ditësh, ndërsa ato definitivet do të publikohen në korrik të vitit 2012.

Derisa partitë shqiptare si zakonisht edhe për çështjet e rëndësishme nuk kanë konsensus, brenga më e madhe bie te popullata dhe sektori civil në vend. Popullatën nuk e kënaq aspak as prezenca e theksuar e monitorimit ndërkombëtar, pasi ata vetëm do ta monitorojnë regjistrimin e popullsisë, gjë që nuk është shumë kontestuese, pasi në regjistrimin e popullsisë shqiptare do të marrin pjesë edhe regjistruës shqiptarë, por problemi qëndron se në pjesën maqedonase shqiptarët nuk kanë qasje. Mirëpo dilema më e madhe mbetet në përpunimin e të dhënave, konkretisht në fazën e fundit, ku përfaqësimi i shqiptarëve është zero. ■



Gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë janë duke e respektuar urdhëresën për mbajtjen e uniformës gjatë proceseve gjyqësore.

# Ademi: Uniforma po respektohet nga njerëzit e ligjit

“Vendimi për mbajtjen e uniformave gjatë një procesi gjyqësor ka qenë edhe më përpara, mirëpo që nga muaji korrik, kur kam filluar punën, e kam funksionalizuar vendimin dhe iu kam kërkuar dhe i kam obliguar të gjithë gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët, që t’i mbajnë uniformat përkatëse. Deri më tani, ky vendim është duke u respektuar”, - është shprehur Isak Ademi



Isak Ademi - kryetar i Gjykatës së Qarkut



## Edona MAGASHI

**P**rishtinë, 9 nëntor – Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Isak Ademi, ka thënë për revistën “Paqja” se gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët në këtë gjykatë janë duke e respektuar urdhëresën për mbajtjen e uniformës gjatë proceseve gjyqësore.

“Vendimi për mbajtjen e uniformave gjatë një procesi gjyqësor ka qenë edhe më përpara, por që nga muaji korrik, kur kam filluar punën, e kam funksionalizuar vendimin dhe iu kam kërkuar dhe i kam obliguar të gjithë gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët, që t’i mbajnë uniformat përkatëse. Deri më tani është duke u respektuar ky vendim”, - është shprehur Ademi.

Kryetari ka paralajmëruar se do të ketë pasoja nëse ndonjë nga punonjësit e kësaj gjykate nuk do ta respektonte këtë vendim.

“Së pari, ata që nuk do ta mbajnë uniformën nuk do të hynë në një proces gjyqësor. Ndërsa nëse nuk e respektojnë këtë vendim, sigurisht, që do t’i paralajmëroja e pastaj sigurisht do të ketë pasoja”, - është shprehur Ademi.

Ndërsa Hamdi Ibrahim, gjyqtar i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, ka treguar se uniformën e gjyqtarit e mban tash nënë vite dhe, sipas tij, kjo do të vazhdojë derisa ta ketë këtë pozitë.

“Mbajta e uniformës gjatë seancës

gjyqësore për mua nuk është kurrfarë risie, sepse e mbaj që nga viti 2002 dhe do të vazhdoj derisa të jem në pozitën e gjyqtarit”, - ka thënë Ibrahim, duke shtuar se kjo është përmbushje e një rregulli që është dashur të bëhet shumë më herët.

Ibrahim madje ka treguar se në kohën kur ai mbante uniformën disa persona e quanin me shaka edhe pop.

“Nuk i kam filluar seancat gati kurrë pa uniformë, madje disa më thoshin me shaka se përngjaja si një pop”, - ka theksuar Ibrahim.

Mbajtja e uniformës është urdhëruar edhe për avokatët, të cilët janë të pranishëm në seancat gjyqësore në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Nikë Shala, avokat, ka thënë se që nga fuqizimi i vendimit nga ana e kryetarit Ademi është duke e mbajtur uniformën në çdo proces gjyqësor, pasi sipas tij ky vendim është i arsyeshëm dhe i domosdoshëm.

“Mendoj që është e arsyeshme dhe e domosdoshme që avokatët të mbajnë uniformën, ashtu si gjyqtarët dhe prokurorët, që të dallohen dhe të identifikohen nga të tjerët. Personalisht jam duke e respektuar këtë vendim në çdo proces gjyqësor”, - është shprehur Shala, duke thënë se këto uniforma mbahen në çdo shtet demokratik.

Shala ka treguar se elementi që i dallon uniformat e avokatëve nga ato

të gjyqtarëve dhe prokurorëve qëndron vetëm te ngjyra.

“Dallimi i uniformës mes trupit gjykues, prokurorit dhe avokatëve qëndron te ngjyra. Ngjyra e uniformës së avokatëve është e kuqe dhe e zeze, për dallim nga trupi gjykues që e ka të kaltër me të zeze dhe prokurori vjollcë me të zeze. Ky është elementi i vetëm që i dallon”, - ka theksuar Shala.

Ai ka treguar se uniforma i është ndarë në kuvendin e rregullt të mbajtur pranë Odës së Avokatëve të Kosovës, pas periudhës së pasluftës në Kosovë.

“Një numër i caktuar i këtyre uniformave na janë ndarë në Kuvendin e rregullt që është mbajtur pranë Odës së Avokatëve të Kosovës, pas periudhës së pasluftës, ndërsa deri më tash ato nuk i kemi përdorur”, - është shprehur Shala.

Në fund të deklaratës së tij, Shala ka treguar se nuk është aspak vështirësi që uniformat të mbahen në çdo seancë, pasi që, sipas tij, është një kënaqësi e veçantë.

“Nuk është aspak vështirë të mbahet kjo uniformë. Personalisht e mbaj me dëshirë dhe ndiej kënaqësi që e kam atë”, - ka thënë avokati Shala.

Deri më tani në proceset gjyqësore vetëm gjyqtarët e EULEX-it ose ish-gjyqtarët e UNMIK-ut i kanë veshur uniformat. Kolegjet e tyre kosovarë e kishin respektuar këtë rend vetëm në rastet kur ishin pjesë e paneleve të gjyqtarëve ndërkombëtarë. ■

# SHKRIM-LEXIM PËR TË GJITHË STUDENTËT

Universiteti i Prishtinës pritet që, nga fillimi i semestrit të dytë të vitit akademik 2010/11, ta shtojë lëndën e gjuhës shqipe si lëndë të obliguar në të gjitha njësitë akademike. Një gjë të tillë e ka premtuar rektori i këtij universiteti, Mujë Rugova, me arsyetimin se studentët e UP-së nuk kanë nivel të mjaftueshëm të shkrimit dhe të folurit. Megjithatë, disa studentë të UP-së, nuk janë të kënaqur me këtë vendim. Sipas tyre, gjuha shqipe është një lëndë që nuk u duhet dhe njëkohësisht e ngarkon edhe më tepër planprogramin, siç janë shprehur studentët, edhe ashtu të ngarkuar

## Drita VITIA

**B**urbuqe Kadriu, studente e vitit të parë në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës, nuk e ka mirëpritur lajmin për vendimin që ka marrë UP-ja për shtimin e lëndës së gjuhës shqipe si lëndë të obliguar nga janari i vitit të ardhshëm. Ajo është shprehur e pakënaqur me këtë vendim, edhe pse ka theksuar se nuk ka dëgjuar më parë për një nismë të tillë. Për Burbuqen kjo është ngarkesë për studentët pasi, sipas saj, edhe ashtu planprogramet mësimore janë të ngarkuara dhe me mjaft literaturë. “Nuk e di, nuk mendoj se është e nevojshme kjo lëndë, sidomos në fakultetin tonë, sepse edhe ashtu kemi mjaft lëndë të ngarkuara me terminologji të ngarkuar, mendoj se kjo është e nevojshme për fakultetet e gjuhës, por jo edhe për neve”, - është shprehur Burbuqja. Mendim të ngjashëm me Burbuqen ka edhe kolegja e saj Liridona Gashi, e cila tashmë është në vitin e tretë në po të njëjtin fakultet. Sipas saj, vendimi për futjen e lëndës së gjuhës shqipe si lëndë të obligueshme, nuk është vendim i mirë, pasi që, sipas saj, në fakultet shkohet për të studiuar dhe gjuha shqipe duhet të mësohet në shkollimin e mesëm. “Unë këtu kam ardhur për të studiuar Juridikun dhe jo për të mësuar gjuhën shqipe. Fundja të shkruarit dhe të folurit e drejtë duhet të mësohet në shkollimin e mesëm

dhe jo në fakultet”, - është shprehur Liridona, e cila gjatë tre vjetëve studim në këtë fakultet, nuk ka mësuar asnjë semestër gjuhë shqipe.

## Mësimi i Gjuhës Shqipe, vendim i mirë

Mirëpo, ka edhe studentë të tjerë që e pëlqejnë vendimin e rektorit Rugova për një gjë të tillë. Albulena Kastrati, studente e vitit të tretë në Fakultetin e Arteve, ka thënë se nuk ka dëgjuar për një nismë të tillë, por është shprehur përkrahëse e vendimit. Sipas saj, kjo është një ide shumë e mirë pasi që, çdokund flitet me gjuhë të rrugës. “Shumë ide e mirë, sepse jemi mësuar të dëgjojmë edhe në fakultet edhe çdokund gjuhën e rrugës, në mungesë të shprehjes së gjuhës standarde”, - ka thënë Albulena. Ndërkohë, për studenten e vitit të parë në Fakultetin Ekonomik, Albana Gashi, në këtë fakultet ka lëndë në të cilat mësohet shkrimi dhe shprehja e mirëfilltë, e cila sipas saj është e mjaftuar për një kulturë të përgjithshme të të shprehurit drejt.

## UP-ja tashmë ka hartuar edhe programin e gjuhës shqipe

Megjithatë, komisioni i formuar në kuadër të Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Prishtinës, tashmë e ka hartuar edhe programin e lëndës së gjuhës shqipe, e cila do të futet si lëndë e obliguar në nivel të universitetit. Kjo është

bërë e ditur nga kryesuesi i këtij komisioni, Bardh Rugova. Ai është shprehur se puna e komisionit ka përfunduar, projekti është dorëzuar në Rektoratit e Universitetit të Prishtinës, ndërsa lënda është emërtuar “Kulturë Gjuhe dhe Shkrimi”. Rugova ka theksuar se programi është hartuar si kulturë gjuhe dhe shkrimi, bashkë me normën e shqipes dhe shkrimin akademik. Ndërsa, sipas tij, projekti do të realizohet në formën e ushtrimeve elektorale dhe jo në formën e ligjëratave klasike. Edhe përfaqësues të Universitetit të Prishtinës kanë bërë të ditur se Universiteti e ka pranuar programin e hartuar të lëndës së gjuhës shqipe. Ndërkohë, sipas udhëheqësve të UP-së, tashmë mbetet vetëm ana teknike e realizimit.

## Nivel i ulët i të folurit dhe të shkruarit

Rektori i Universitetit të Prishtinës, Mujë Rugova, me marrjen e mandatit kishte premtuar se kjo lëndë do të jetë lëndë e obliguar në nivel të universitetit më 1 tetor 2010, me arsyetimin e përmirësimit të nivelit të të shkruarit dhe të folurit në vend, pasi që, sipas tij, në Kosovë shumica e popullatës flasin një nivel shumë të dobët të gjuhës standarde shqipe. Mirëpo, edhe pse një gjë e tillë nuk ishte realizuar në kohën e paraparë, projekti tashmë është në përfundim të realizimit dhe pritet të zbatohet nga semestri i dytë i vitit akademik 2010/11. ■



# PËRPLASJE SHQIPËRI – KOSOVË RRETH GJUHËS SHQIPE

**Fitim FETAHU**

**E**...përderisa Universiteti i Prishtinës filloi nismën e re për t'ua përmirësuar gjuhën standarde studentëve, gjuhëtarët dhe albanologët shqiptarë ende kanë dilema se cila do të duhej të ishte gjuha standarde shqipe. Në datat 15-17 dhjetor, Qendra e Studimeve Albanologjike e Shqipërisë organizon konferencën "Shqipja në etapën e sotme: politika e pasurimit dhe e përmirësimit të standardit". Pritet që studiues nga trevat shqiptare të ulen në tryezë për të diskutuar për problemet dhe nevojat e rishikimit të standardit. Qëllimi i kësaj konference thuhet se është shtjellimi i problemeve që dalin për standardin e sotëm, duke marrë parasysh se jeta ecën përpara me hapa të shpejtë. Studiuesit nga Shqipëria janë të mendimit se vetë hapja e vendit pas viteve '90 ka krijuar situata të ndryshme nga ato që ishin më përpara në shtetin diktatorial dhe kjo hapje e vë para provës standardin e shqipes, për të kryer më mirë detyrën e komunikimit, jo vetëm me të gjitha trevat shqiptare, por sidomos përballë gjuhëve të huaja. Në këtë drejtim, konferenca do të studiojë edhe rrugët e përmirësimit dhe pasurimit të këtij standardi, me qëllim që të kryejë më mirë funksionin si gjuhë e përbashkët e shqiptarëve.

Shqyrtimi i standardit mendohet të jetë detyrë shkencore dhe patriotike, sepse gjuha është fenomeni më i rëndësishëm shoqëror i një kombi që i bashkon shqiptarët në të katërta anët e botës.

Nga ana tjetër, në konferencë pritet të shqyrtohet edhe mënyra e futjes në standardin e sotëm edhe të prurjeve të reja që ka sjellë vetë modernizimi i jetës.

Të gjitha këto prirje do të debatohen dhe çdo gjë duhet të argumentohet me fakte nga pikëpamja shkencore.

Kjo konferencë kërkon të sensibilizojë opinionin e përgjithshëm, sepse gjuha është fenomen i prekshëm për të

gjithë. Në konferencë, po ashtu, pritet të ketë edhe kërkesa ose propozime për ndryshime të disa rregullave drejtshkrimore, që do të jenë në funksion të fuqizimit dhe të përmirësimit të standardit.

Studiuesi Koleç Topalli nga Shqipëria në një intervistë për një media vendore ka sjellë vetëm dy shembuj se përse duhen rishikuar disa rregulla drejtshkrimore. "Në gjuhën shqipe, sipas rregullave të drejtshkrimit është parashikuar që emrat e festave fetare të shkruhen me shkronjë të vogël. Kjo është një reminishencë e asaj kohe kur feja luftohej nga shteti, por mendoj se pas periudhës së demokratizimit të vendit, nuk ka më arsye të shkruhen me të vogël, ashtu sikurse emri Zot në asnjë gjuhë nuk shkruhet me të vogël kurse në shqipe, sipas rregullave të drejtshkrimit duhet të shkruhet me shkronjë të vogël. K e t o g j e r a duhet t e s a n k -

të tilla që e afrojnë gjuhën e folur me gjuhën e shkruar, duke mënjanuar përjashtimet e shumta në rregullat e drejtshkrimit. Kjo gjuhë, që është shenja e identifikimit të kombit, të shërbejë edhe si një shenjë e bashkimit të shqiptarëve në mbarë rruzullin tokësor.

Mirëpo prof. dr. Qemal Murati, këshilltar shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, në Sektorin e Kulturës së Gjuhës, kryeredaktor i revistës "Gjuha Shqipe" dhe autor i një sërë veprash që marrin në studim shq -

siono-  
hen". Ai shprehet se mendimi i tij është i prerë: "një komb, një gjuhë. Në asnjë mënyrë unë nuk mendoj që një shtet tjetër që banohet nga shqiptarët, e kam fjalën për Kosovën, të ketë një standard tjetër. Të gjithë shqiptarët duhet të merren vesh mes tyre me një standard. Prandaj shtrohet problemi që të studiohen, analizohen dhe të bëhen ndryshime

ipen standarde, shprehet se standardi nuk duhet të preket në asnjë mënyrë.

"Unë, bashkë me kolegët e tjerë të Institutit Albanologjik të Prishtinës, jemi konsultuar dhe kemi marrë qëndrim të përbashkët që të mos paraqitemi, sepse thjesht kemi dyshuar në qëllimet dhe platformën e konferencës. Vetë titulli i konferencës sugjeron diçka të tillë: "... politika e pasurimit dhe e përmirësimit



të standardit". Kurrkush nuk ka mandat që në mënyrë të tillë gjysmë klandestine të marrë qëndrime a vendime për ndërhyrje në standardin e shqipes. Në gjithë këtë tregim, unë mendoj se këtu nuk ka një konflikt institucional ndërmjet Prishtinës dhe Tiranës, edhe s' mund të ketë diçka të tillë. Por mbase mund të ketë një konflikt personal ose grupor, të mos themi klanor: disa ushqejnë konceptin e tyre lokalist a krahinor dhe angazhohen për recidiva të formave parastandarë, disa të tjerë nuk pajtohen me ato politika dhe rrjedhimisht nuk bëhen pjesë e atyre

projekteve. Do të ishte vërtet gjëja më e tmerrshme sikur të ktheheshim prapë te fillimi, te gjuhët e fisit, ngjashëm si te banorët e fisit Papu. Në këtë pikë ne do t'u ngajmë papuve: ku çdo fis ka gjuhën e vet. Gjuha standarde nuk është një truall ku mund të bëhen eksperimente sa herë dhe si t'ia dojë qejfi dikujt.

Duke kujtuar për një gazetë tiranase se në gjuhë hyjnë në qarkullim çdo ditë nga 1500-2000 fjalë e krijime të reja, prof. dr. Qemal Murati ka shtuar se "do të duhej të merremi me formën e drejtë dhe semantikën e përdorimit të

tyre, e jo të merremi me gjëra triviale, se a duhet të rikthehen format dialektore në standard".

Në konferencë nuk pritet të merren vendime, sepse ato arrihen vetëm në ndonjë kongres gjuhësor ose nga një komision me specialistë që mund të ngrihen në të ardhmen.

Përndryshe në Shqipëri e Kosovë ka kohë që ka zëra të ndryshëm, sipas të cilëve gjuha standarde shqipe duhet të rishikohet dhe të korrigohet, sepse ajo është produkt i sistemit diktatorial të Enver Hoxhës. ■

# Zvarriten procedurat e nostrifikimit të diplomave

**Astrit VELIQI**

**E**dhe më tej vazhdojnë procedurat e komplikuar për nostrifikimin e diplomave. Procesi i stërzgatur ka bërë që shumë aplikantë të ankohen për vonesa të panevojshme. Fjala vjen, përderisa në Shkup nostrifikimi i diplomave të marra në Shqipëri zgjat një muaj, kjo në Kosovë zgjat më shumë se katër muaj. Zyrtarët e Ministrisë së Arsimit e arsytetojnë këtë, duke thënë se çdo gjë është e paraparë me ligj. Sipas tyre, nostrifikimi i diplomave duhet t'i nënshtrohet procesit serioz të verifikimit. Studentja nga Tetova, Majlinda Hetemi, është shprehur e pakënaqur me procedurën e gjatë të nostrifikimit të një diplome në Kosovë. Ajo shprehet se ka mjaft kohë që ka aplikuar për të bërë nostrifikimin e diplomës së saj në Kosovë dhe procedurat administrative, sipas saj, po bëjnë që diploma e saj të mbetet pa validitet nostrifikues.

## **Nostrifikimi, proces i 'gjatë'**

"Procedurat e gjata dhe të ndërlikuara po bëjnë që unë të pres gjatë për të bërë nostrifikimin e diplomës në MASHT dhe kjo zvarritje edhe neve po na krijon kokëçarje pa masë", - thekson Majlinda.

Sipas saj, procedurat administrative janë të atilla dhe ne patjetër po duhet t'u përmbahemi, ngase nostrifikimin e diplomës, gjegjësisht validitetin e saj, po na e kërkon edhe puna që aktualisht jemi duke e bërë këtu në Kosovë.

Nga MASHT-i theksojnë se vonesat eventuale paraqiten vetëm në rastet kur verifikimi për validitetin e diplomës nuk vjen me kohë. Përndryshe, sipas tyre, pjesa tjetër e procedurës kryhet brenda një kohe shumë të shkurtër.

Mirsada Voca, udhëheqëse në NARIC Kosova në MASHT, thotë për revistën "Paqja" se tashmë e kemi racionalizuar procedurën dhe, sipas saj, kërkesat e paraqitura në MASHT për njohje të barasvlerës nuk dërgohen në Universitetin e Prishtinës, që pastaj rektorati t'i dërgojë në fakultetin përkatës, por kërkesa mbetet në MASHT.

"Paraprakisht, kemi parashtruar kërkesë në Universitetin e Prishtinës për caktimin e ekspertëve nga secili fakultet dhe nga secili dekanat dhe na është dërguar lista me ekspertët, të cilët mund t'i ftojme në MASHT për shqyrtimin e kërkesave", - thotë Voca.

Sipas saj, ekspertët përkatës kanë mundësitë e njohjes (nëse nuk ka drejtim adekuat ose nuk përputhet planprogrami) ose të njohjes me barasvlerë (kur planprogrami përputhet mjaftueshëm me një nga programet e Universitetit të Prishtinës).

## **Procedura e aplikimit për nostrifikim**

Për të aplikuar për nostrifikimin e diplomës merret formulari dhe kërkesa në MASHT. Kandidati duhet të dorëzojë një CV, originalin e diplomës për shqyrtim - kopjen e lë të vërtetuar në ministri, originalin e notave për shqyrtim - kopjen e vërtetuar e lë në ministri, temën e diplomës dhe kurrikulumin. Në rast kur p. sh: një kandidat ka përfunduar mjekësinë në Tiranë, në momentin e aplikimit të kandidatit, fillimisht bëhet kërkesa për konfirmim të diplomës. Nëse fjala vjen kemi rastin me Shqipërinë, e kërkojmë atë nga Universiteti i Tiranës. Kur kthehet përgjigjja, rasti procesohet në ministri dhe për një procedurë që llogaritet tre muaj, ashtu edhe siç parashihet në udhëzimin administrativ, njihet diploma.

Mirsade Voca sa i përket kohës optimale për të bërë një nostrifikim diplome thotë së NARIC Kosova, në përputhje me UA përkatës, fillon procedurën për diplomat që janë fituar jashtë Republikës së Kosovës, në universitetet publike ose në universitet private të akredituara nga një agjenci e autorizuar kombëtare e njohur ndërkombëtarisht, si dhe e regjistruar në regjistrin e organizatave si ENQA.

## **428 kërkesa për nostrifikim për vitin 2010**

Voca thotë se NARIC (Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik e Kosovës) fillimisht bën kërkesën pranë Ministrisë së Arsimit në shtetin ku kandidati ka përfunduar studimet për të verifikuar autenticitetin, pastaj ftohen ekspertët përkatës për shqyrtimin e lëndës.

Ajo thotë së mendimi i komisionit të ekspertëve kalon te Këshilli Kombëtar për Njohje, i cili jep mendimin përfundimtar dhe NARIC Kosova nxjerr vendimin dhe njofton palën për përfundimin e procedurës.

Por, Voca thotë se procedura për njohje të barasvlerës së diplomave që fitohen jashtë vendit merr kohë edhe në shumicën e vendeve të tjera.

"Tani, te ne, me ndryshimin e disa dispozitave në udhëzimin përkatës, mendoj se procedura përfundon brenda një kohe normale".

Voca thotë së interesimi për njohjen e diplomës së fituar jashtë Republikës së Kosovës është gjithnjë në rritje dhe, si rezultat, vetëm në vitin 2010 kemi pasur gjithsej 428 kërkesa dhe procedura është përfunduar për 350 kërkesa. ■

# GJYSMËS SË PLANETIT ME AEROPLAN PËR TË LOBUAR PËR KOSOVËN!

Për Kosovën duhet të llojmë me të gjitha mënyrat. Po të jetë nevoja edhe me traktor, vetëm për të bërë publicitetet pozitiv, e jo publicitetet negativ, siç kemi pasur deri vonë"- është shprehur për revistën "Paqja", piloti shqiptar James Berisha.

**Intervistoi: Alban BILALLI**

**J**ames Berisha, i lindur në Brestofc të Rahovecit, u largua nga Kosova në moshën 16 vjeçare për në perëndim drejt një jete më të mirë. Në Amerikë ai gjeti jetën të cilën e kërkonte. Kreu shkollën për pilot, e cili i kushtoi qindra mijëra euro. Milazim Berisha e ndërroi emrin për shkak që t'u shmangej komplikimeve që lindnin nga administrata e Bushit për pilotët në SHBA, pas sulmeve të 11 shtatorit. Pasi kreu shkollimin, ai hyri në punë si pilot. Edhe pse e rregulloi jetën e vet dhe të familjes së tij, Berisha kurrë nuk e harroi Kosovën. Ai vendosi të kontribuojë për Kosovën. Mënyra se si e ndihmoi Kosovën është e veçantë. Berisha fluturoi me aeroplanin e tij gjysmën e planetit të tokës për të lobuar për Kosovën.

Në intervistën dhënë revistës "Paqja", James Berisha flet për fillimet e tij si pilot, për të veçantat që e karakterizuan udhëtimin e tij drejt Amerikës

Jugore për ta njohur ato shtete, shtetin e tij si të pavarur. Më tej ai

flet

për misionin e tij në Afrikë, si dhe për injorimin që i bëri Skender Hyseni, Ministri i Jashtëm i Kosovës. Për më shumë flet në një intervistë për revistën "Paqja", piloti shqiptar me nënshtetësi amerikane James Berisha.

**"PAQJA": Z. Berisha ju jeni pilot me profesion. Na flisni rreth fillimeve tuaja si pilot.**

**JAMES BERISHA:** Si fëmijë kur isha 3-4 vjeçar, isha në bahçe duke punuar me gjyshin dhe kur e pashë një aeroplan duke fluturuar në qiell, e pyeta gjyshin se ku po shkon ai aeroplan. Gjyshi më jepte përgjigje të ndryshme, që unë nuk isha në gjendje t'i kuptoja. Prej atëherë unë kam pasur dëshirë të fluturoj dhe të dijë më tepër për aeroplanin. Që 17 vjet punoj si pilot, nëpër vende të ndryshme të Amerikës. 6 vitet e fundit punoj si pilot profesionist.

**"PAQJA": Kur jeni larguar nga Kosova?**

**JAMES BERISHA:** Nga Kosova jam larguar në vitin 1988, në moshën 16 vjeçare. Jam larguar i vetëm. Daja im ka qenë në Zvicër. Ai më pas mori familjen e tij me vete në Zvicër. Njërin nga fëmijët e tij unë e doja shumë, jam rritur me të. Dhe kur daja shkoi, edhe unë vendosa pasdisa

muajsh të shkoja në Zvicër dhe të isha më afër tij. Prej aty kam shkuar në Australi e më pas në Amerikë.

**Pilotimi është profesioni im, por për Kosovën llojmë edhe me traktor**

**"PAQJA": Z. Berisha prej nga ju lindi ideja për të lobuar me aeroplan për Kosovën?**

**JAMES BERISHA:** Është në pyetje profesioni. Aviacioni është shumë atraktiv. Çdokush në botë e do. Aviacioni luan rol të madh. Derisa Serbia na ka paraqitur si të prapambetur, me qerre me kuaj, me traktorë, unë kam dashur t'i tregoj botës se edhe shqiptarët dinë dhe kanë aftësi në fusha të ndryshme të jetës. Për Kosovën duhet të llojmë me të gjitha mënyrat. Po të jetë nevoja edhe me traktor, vetëm për të bërë publicitetet pozitiv, e jo publicitetet negativ, siç kemi pasur deri vonë.

**"PAQJA": Kur dhe ku e keni realizuar fluturimin e parë për të lobuar për Kosovën?**

**JAMES BERISHA:** Prej Teksasit jam nisur në drejtim të Meksikës. Pastaj në Belize, Guatemala, El Salvador, Honduras, Nikaragua, Kosta Rika, Panama. Pastaj kam fluturuar në shtet e Amerikës Jugore, si dhe në Ishujt e Karibeve.

**"PAQJA": Keni udhëtuar nëpër vende të ndryshme. Si jeni pritur dhe cili ka qenë opinionin e tyre për Kosovën?**

**JAMES BERISHA:** Në Kubë nuk më kanë lejuar që të hyj me aeroplan, ngase aeroplani im ka regjistrim amerikan. Ata nuk i duan amerikanët. Por si qytetar kam hyrë dhe e kam përcjellë mesazhin tim për ta njohur Kosovën. Paraguai më ka pritur shkëlqyeshëm. Një grup të rinjsh më ftuan në një darkë, për nder se kam ardhur nga Kosova. Ata të rinj i kanë shkruar një letër Ministrisë së Jashtme, se pse ende nuk po e njohim Kosovën. Po ashtu në media është shkruar për Kosovën dhe për lobimin tim për Kosovën. Paraguai është



i ngjashëm me Kosovën, është një shtet i vogël. Është në kufi me dy shtete të mëdha Argjentinën dhe Brazilin dhe prej këtyre dy shteteve, ky shtet i vogël ka shumë probleme. Ministria e Jashtme më ka thënë se ne e njohim realitetin e krijuar në Kosovë, por ne kemi një arsye të fortë pse nuk e njohim shtetin tuaj. Ne eksportojmë 65 për qind të mishit në Rusi. Nëse e njohim Kosovën, kemi frikë se Rusia do na e ndalojë eksportin e mishit dhe kjo do ishte fatale për ekonominë e Paraguait. Ju e dini se Rusia është aleat i fortë i Serbisë. Kam shkuar edhe në Suriname. Ministria e Jashtme e Surinameve më ka thënë “se asnjë letër nuk ka marrë nga Kosova për ta njohur. Unë di shumë pak. Një gjë kam dëgjuar, që ambasada juaj ia ka dhënë një letër ambasadës sonë, por ajo kurrë nuk ka ardhur te ne”. Këtë gjë ia kam thënë edhe Skënder Hysenit. Ai më ka thënë “se ne ia kemi dërguar letrën përmes OKB-s”. Unë i thash “O Skender, unë kam folur me ministren e jashtme dhe ajo më tha se nuk ka ardhur. Këtu dikush po rren”. Kosova duhet të bëjë më shumë për lobim. Buxhetin e kemi. Të gjitha i kemi, por nuk po punojmë për shtet, po për vete. Po punojnë për t’u pasuruar sa më parë. Kështu nuk bën.

**“PAQJA”:** *Kush ju ka ndihmuar rreth shpenzimeve?*

**JAMES BERISHA:** 90 për qind janë fonde të miat, fonde personale. 10 për



qind janë fonde të tjera. Në Prishtinë janë grumbulluar afro 700-800 euro, si dhe diaspora e Dallasit, e Alaskës, e Zvicrës më kanë ndihmuar me një shumë. Kurse tërë kampanja ka kushtuar mbi 200 mijë euro. Kjo është për turin e fluturimeve të para në Amerikë. Kurse tani, për turin e Afrikës, misionin tim janë duke e përkrahur shumë pak. Vetëm 371 euro janë grumbulluar nga sms. Kurse nga donatorët kam shumë fjalë, por nuk po i mbajnë fjalët, nuk po i japin parat. Por ka edhe të atillë që po e përkrahin, dikush 500 euro, dikush 1000. Ama shumë pak po e përkrahin. Ne nuk jemi patriot sa shtiremi. Unë jam shumë i lumtur që e kemi fituar luftën, se përndryshe do të kishim pasur shumë probleme. Në rregull e kemi fituar luftën, por tash duhet ta çojmë shtetin përpara.

### **“Flying for Kosovo” në 54 shtete afrikane**

**“PAQJA”:** *Si e keni planifikuar ta bëni fluturimin për në kontinentin afrikan?*

**JAMES BERISHA:** Nga Prishtina do të shkoj në Greqi dhe në Maltë. Këto dy vende e njohin shumë mirë realitetin në Kosovë, por do të shkoj për t’u rikujtuar edhe një herë se duhet njohur sa më parë Kosova. Pastaj do vazhdoj në drejtim të Tunizisë, Algjerisë, Marokut, Saharës Perëndimore, Mauritanisë. Nga ana perëndimore e Kontinentit të Afrikës do të shkoj në drejtim të jugut dhe nga jugu do të shkoj në veri, nëpërmjet anës lindore të Kontinentit Afrikan. 54 shtete dhe 2 shtetet evropiane që do të shkoj, bëjnë gjithsej 56. Nëse e kam shëndetin që ta përfundoj këtë mision, i bie se i kam rënë gjysmës së planetit me aeroplan për të lobuar për Kosovën.

**“PAQJA”:** *Pas Afrikës cili do të jetë misioni tjetër, apo ky do jetë i fundit?*

**JAMES BERISHA:** Fjala ‘jo’ është fjalë e madhe. Por, besoj se do të ndalem. Unë nuk do të përtoja të fluturoja për çështjen e Kosovës, edhe për 10 vite. Por me këtë qeveri unë nuk mund të vazhdoj. Unë qe dy vite nuk marr rrogë. Shkolla ime ka zgjatur me vite, ka kushtuar me qindra mijëra euro. Nuk bën me e lënë dhe me e hedhë në tokë një investim kaq të madh. Sikur qeveria të më ndihmonte unë do vazhdoja, por jo në këtë mënyrë. Qeveria deri më tani më ka injoruar, e lërë të më ndihmojë. Unë duhet të merrem me harxhime, me



logjistikë, me pilotim, me organizim, me çdo gjë.

**“PAQJA”:** *Në një rast keni përmendur se do ta hapni një shkollë të fluturimit në Kosovë. Na flisni më tepër për këtë?*

**JAMES BERISHA:** Shkolla e aviacionit është e domosdoshme për ne. Nëse e kam shëndetin dhe nuk më pengojnë në këtë drejtim, unë do ta hap këtë shkollë. Ne jemi një popullatë mbi 2 milionëshe dhe kemi 5 a 6 pilotë. Kjo është e tmerrshme. Në Amerikë 1 për qind e popullsisë janë pilotë: pilotë ushtarakë, pilotë në polici, pilotë që punojnë në kompani private etj., të fushave të ndryshme. Duhet të ngremë fushën e aviacionit. Aviacioni i nevojitet shumë shtetit tonë. Tregun tonë të aviacionit e marrin kompanitë nga shtetet e Zvicrës, Austrisë, Sllovenisë etj. Ne jemi një ndër popujt që udhëtojmë shumë. Jemi mbi 2 milionë dhe një



milion udhëtarë udhëtojnë nëpërmjet aeroportit tonë. Kosova ka nevojë për zhvillimin e aviacionit.

### Skender Hyseni më injoroi

**“PAQJA”:** *Cili është opinionimi juaj për Ministrinë e Jashtme të Kosovës?*

**JAMES BERISHA:** Ministria e Jashtme më ka injoruar totalisht. Isha në një takim një orësh me Skender Hysenin. Në atë takim ai më ka injoruar totalisht. Ai është njeri injorant, arrogant. Ai donte ta thoshte fjalën serbe “Ja sam ja”. Ai në një farë mënyre, veç sa s’më tha “Lëre këtë punë, unë jam ai që dua të bëj çfarë të dua. Unë dua të kënaqem me udhëtime të klasit të parë të aeroplanëve. Unë dua të kalojë mirë, ky popull le të vuajë”. Është mjerim për ne që e kemi një ministër të tillë. Unë nuk e di se a e di ai ministër, që unë qe dy vite nuk marr rrogë. Unë e kam lënë anash punën që më ka kushtuar

shkollimi me qindra mija euro. Sot unë, si bir i kësaj toke, mundohem të bëjë diçka të vogël për vendin tim, e ai më injoroi totalisht. Por unë nuk ndalem. Për Kosovën jam i gatshëm të lloboj edhe me traktor. Kosova është vendi im, është gjaku im. Prandaj do të jap çdo gjë për këtë tokë. Tash pasi shkoi ky ministër injorant dhe në vend të tij erdhi Vlora Citaku, ka ndryshime në këtë ministri. Vlora ka shkruar një letër dhe ua ka dërguar të gjitha vendeve në botë, se misioni “Flying for Kosovo” është në pëlqim me Ministrinë e Jashtme. Po ashtu, Vlora ka shkruar 42 letra, që unë kur të shkoj nëpër ato shtete t’ua dërgoj këto letra Ministrive të Jashtme, nga Ministria e Jashtme e Kosovës për ta pranuar pavarësinë e Kosovës. Kjo është shumë e mirë. Paramendo sikur ne t’i dërgonim një milion letra Ministrisë së Jashtme të Mauritanisë, e mora si shembull. Unë jam i bindur se kjo

gjë do kishte pasur shumë ndikim në këtë shtet dhe besoj se do kishte ndikuar që ky shtet, por edhe shtetet e tjera, ta njohin Kosovën sa më shpejt. Por fatkeqësisht kjo nuk po ndodh. Për më tepër Ministria e Jashtme po mundohet t’i minimizojë edhe ata individë që po mundohen për Kosovën.

**“PAQJA”:** *z. Berisha të falënderoj për intervistën dhe të dëshirojmë suksese në udhëtimin tuaj drejt kontinentit afrikan.*

**JAMES BERISHA:** Unë ju falënderoj shumë juve, si dhe revistën tuaj për kohën që keni gjetur për t’i kushtuar vëmendje misionit tonë “Flying for Kosovo”. Unë shfrytëzoj rastin t’i përshëndes të gjithë ata individ dhe kompani që e kanë përkrahur këtë mision dhe dashtë Zoti që Kosova të njihet sa më parë nga tërë bota dhe shteti ynë të mos ketë pengesa drejt zhvillimit dhe integriteteve evropiane. ■

# Erdogan





# BAKSHISHET E ERDOGANIT!

“Të mendojmë! Të mendojmë ndershëm dhe vetëm ndershëm, qoftë edhe kundër të gjithëve, sepse ashtu mendojmë për të gjithë!”

Romen Rolan

**Emine A. VEZAJ**

**Kronikë ditore:**

**P**ër herë të parë Kosovën e vizitoi një kryeministër i Turqisë. Vargu që ishte bërë gati ta prisnin ishte tepër i madh. Në ballë të tij ishte vendosur zv/kryeministri në ikje Hajredin Kuçi, ndërsa një pritje madhështore i ishte organizuar në Prishtinë, pritje të cilën siç komentonin mediet ditore, se kishte as znj. Hillary Clinton, e cila kohë më parë vizitoi Kosovën. Pritja në Prishtinë ishte edhe më madhështore sepse Kryeministri në ikje Hashim Thaçi kishte dalë ta priste me krejt pjesën e mbetur të kabinetit të tij qeveritar. Edhe togu ceremonial i FSK- së ishte në pritje, madje kësaj radhe edhe me armë, si asnjëherë më parë.

Erdoganit vërtet iu bë një pritje madhështore! Në Prizren iu dha titulli “Qytetar Nderi” dhe iu dhurua edhe çelësi i qytetit. Në Prishtinë z. Hashim Thaçi e quajti “vëlla”, Universiteti i Prishtinës i dha titullin “Doctor Honoris Causa” në shenjë mirënjohje për meritat e veçanta në shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe lobimin për njohjen e Kosovës nga shtetet e tjera të botës. Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi e dekoroi me “Medaljen e Artë” të Pavarësisë së Kosovës... Sa shumë bakshishe! Rrallë kush do t'i ketë marrë të gjitha këto për dy ditë në Kosovë, mendoj për miqtë e Kosovës, madje as ish-presidenti i Amerikës Bill Clinton, i cili konsiderohet hero i Kosovës. Pse gjithë këto bakshishe për Erdoganin?

**A i meritoi të gjitha këto bakshishe kryeministri Erdogan???**

**Retrospektivë**

**Arsyet:**

**1. Njohja e shtetësisë së Kosovës**

Fjalët e tij të para, që nuk mund të jenë të panjohura për të gjithë ne, Erdoganin i tha sapo arriti në Prishtinë. Ai tregoi faktin se si vetë kishte biseduar një ditë para shpalljes së pavarësisë së Kosovës me homologun e tij nga Kosova Hashim Thaçin. Njohja e parë e shtetë-

sisë së Kosovës nga Turqia jo vetëm se ishte një sihariq i madh për të gjithë shqiptarët, por ishte një rrugë që dha shembull për të tjerët. Këtë nijet të pastër të Turqisë, vetë kryeministri Erdogan e bëri publik edhe njëherë në Prishtinë: “Njohja e menjëhershme e pavarësisë së Kosovës nga Turqia është sinjali që ne u dhamë të gjitha shteteve për rrugën që duhet të ndjekin”. Pyesim: A ishin të mjaftueshme bakshishet për të?

**2. Interesi për Konferencën Islamike**

Diplomacia kosovare veproi shumë mirë në muajin gusht 2008 kur organizoi në Prishtinë një tubim shqiptaro – arab për të shkëmbyer mendime për një kuptim më të mirë të çështjes së Kosovës në botën arabe dhe për të kapërcyer ftohtësinë politike të krijuar

midis popujve. Megjithëse, natyrisht ishte një veprim shumë i vonuar. Sada Cumber ishte shprehur me keqardhje se: “Që nga viti 1990 liderët kosovarë nuk kanë qenë të interesuar të krijojnë takime me vendet me popullsi myslimane, përveç disa vizitave në Turqi”. ‘Ja tani, do të shfrytëzojmë momentin e duhur’ - thanë kosovarët. Sekretari i përgjithshëm i Konferencës Islamike, Ekmeludin Ihsanoglu, pasi bëri një deklaratë personale, më 18 shkurt 2008, për të përshëndetur dhe mbështetur popullin e Kosovës për pavarësinë e tyre, i këshilloi kosovarët që në të ardhmen të kenë një politikë më aktive ndaj vendeve islamike dhe arabe, në mënyrë që të shpjegojnë arsyet konkrete se pse Kosova është e veçantë dhe pse e meriton pavarësinë e saj. A ishin të mjaftueshme bakshishet për të?



### 3. Çështjet ekonomike:

Gjatë vizitës në Kosovë të ish-ministrit të jashtëm të Turqisë, Ali Babacan, aktualisht zv/kryeministër përgjegjës për ekonomi, për dallim nga shumë ministra e burrështetas të tjerë që vizitojnë Kosovën, ai solli me vete 140 biznesmenë turq. Që nga viti 1990, në Kosovë manovrojnë 250 kompani turke që në forma të ndryshme zhvillojnë veprimtari afariste. Deri tani kjo veprimtari ka qenë e shtrirë kryesisht në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve. Gjithashtu është investuar edhe në sektorin bankar dhe sektorë të tjerë. Ka një interesim në rritje nga firmat e ndërtimit dhe ato të energjisë dhe minierave. Kreu i qeverisë turke, në epiqendër të bisedës së tij të vizitës në Kosovë, përmendi edhe bashkëpunimin ushtarak dhe ekonomik që kanë këto dy vende. Ai përmendi edhe dy kompanitë turke “Behtel and Enka” dhe “Lihmak”, të cilat janë të angazhuara në ndërtimin e autostradës dhe në projektin për modernizimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, pa harruar



të cekte edhe interesimin për sektorin e telefonisë. Përmes agjencisë turke për Rindërtim dhe Zhvillim “TIKA”, Turqia bën edhe rikonstruktimin e një vargu objektesh kulturore dhe historike. Gjatë kësaj vizite të kryeministrit Erdogan në Kosovë u bë hapja e një spitali turk, si dhe inaugurimi i fabrikës së miellit në Fushë Kosovë...

### 4. Shengeni Turqi:

Që nga 6 qershori i vitit të kaluar, qytetarët e Kosovës, të cilët janë të pajisur me pasaporta të Republikës së Kosovës, mund ta vizitojnë Turqinë pa viza. Ky “shengen turk” u dha mundësi qytetarëve të Kosovës që, pas shumë kohësh, të kalojnë kufirin turk pa vizë. Sigurisht, ishte një sihariq i mirë për të gjithë ne... A ishin të mjaftueshme bakshishet për të?

### Si e kemi parë ne Turqinë deri më sot?

Fjalët dhe simbolet turke, që dikur kanë qenë faktor i kohezionit dhe pjesë e identitetit shqiptar, edhe tani, nga disa persona që ende frymojnë në komunizëm, janë simbole e shenja irrituese dhe të padëshiruara.

Sa për ilustrimin e ngjarjes, karizma e liderit turk nuk e la pa prekur edhe kryeministrin në largim H. Thaçi. Për Erdoganin, në ditën e përrurimit pas restaurimit të xhamisë “Sulltan Mehmet – Fatih”, Thaçit i shkoi për dore të bëj diçka që nuk ka arritur ta bëjë ndokush para tij në pozitën e tij. Jo kot thuhet, për disa njerëz, posti është provë karakteri. Thaçi së bashku me homologun turk Erdogan ngritën duart (ngritja e duarve për lutje, “simbol turk” dhe jo i këndshëm për shumë politikanë) për t’iu bashkangjitur në lutje Myftiut Naim Tërnava me rastin e këtij përrurimi. Mediet ditore e panë si shumë të madhe këtë gjest të H. Thaçit, madje ngritja e duarve gjatë kësaj lutje ishte shumë naive për shumëkënd. Thaçi kohë më parë kishte bërë vetëm urime për këto festa, ndërsa nuk kishte marrë pjesë vetë në ndonjë lutje...

“Vëllai Erdogan”. Interesant! Shih edhe çfarë ‘gafe’ bën kryeministri në ikje Hashim Thaçi, e quan vëllai homologun Erdogan! Pse e bëri këtë? Për të joshur nacionalitetin turk në Kosovë që t’i japin votën edhe kësaj radhe dhe për t’i krekosur edhe më ata që kundërshtuan stemën e Lidhjes së Prizrenit pas

kaq vitesh, për të treguar se nje turq ishten nga pak, apo për t’i hyrë në hatër Erdoganit? Po si komentohet vëllazërimi mes nesh dhe Turqisë, si e kuptojmë ne miqësinë me Turqinë, mos “gafa” e Thaçit është vetëm për interes dhe jo për miqësi????! Më kujtohet një frazë e prof. Hajredin Kuçit: “Politikës i lejohet të abuzojë me realitetin, por nuk e mohon atë”. Charles De Gaull ka thënë: “Mes popujve nuk mund të ketë miqësi, ka vetëm interesa”! Llogaris se është shumë e drejtë. “Qeveria e Kosovës nuk diti të shesë as patate” (shih; “Zëri” e mërkurë, 3 nëntor 2010) e lërë më të mbijetojë pa miqtë e saj...

Kosova dhe qytetarët e saj ende e kanë të mjegulluar identitetin e tyre fetar si pasojë e historive deformuese të mësuara vite e vite me radhë. Një grusht të fortë për këtë histori të deformuar kanë dhënë edhe studiuesit si Aurel Plasari e Noel Malcolm. Sipas Plasarit, në analizën me titull “Barleti – përrallëtar, gënjeshtar apo i vërtetë...!?” e vështruar me mundësitë që i jep perspektiva historike gati pesëshekullore, “Historia” e Barletit, u është dukur shumë autorëve të vonshëm, por sidomos atyre modernë, si vepër panegjirike, e mbushur me zmadhime, me ngjyime mitike, madje me fiksione letrare, me anakronizma dhe, sidomos, me pasaktësi jo të pakta. Pothuajse, bashkëkohësi i tij, Pal Jovi (Paulus Jovius) e akuzoi i pari Barletin që, për shkak të “atdhetarisë” dhe të “urrejtjes ndaj barbarëve”, i kishte fryrë fort punët në librin e tij...” Për rrjedhojë, as Noel Malcolm, studiuesi më objektiv i historisë së vjetër të shqiptarëve, nuk e analizon më ndryshe situatën e “pushtimit” të Perandorisë Osmane. Gjithnjë, sipas tij, “Faktikisht, asnjë komb tjetër në Evropë nuk ka pasur përjetimin e gjenocidit, shpërnguljes, tkurrjes edhe aparteidit që kanë pasur shqiptarët, duke pasur parasysh përmasat demografike dhe territoriale. Kur u shpall pavarësia prej Perandorisë Osmane, shqiptarët jetonin në rreth 75 mijë kilometra katrorë dhe sot, pothuajse një shekull më pas, shqipja flitet vetëm në rreth 45 mijë kilometra katrorë.”

Turqia është një mik i shtrenjtë i yni. Duhet të mësohemi ta respektojmë fqinjësinë e mirë sa nuk është vonë, përndryshe “Jeta e ka mënyrën e vet për t’i dënuar ata që vonohen” (Gorbaçov). ■

# SUKSESI DHE AKTIVITETI I GJINEK

**Intervistoi: Iljasa SALIHU**

**K**udo qofshin shqiptarët, të paktë janë ato koka gjeniale që arrijnë të çmohen sa duhet në vendin e tyre. Zakonisht ato fashiten siç shuhen meteorët. Ua zë frymën injorimi, anashkalimi dhe nënvlerësimi. Ata që në saje të rrethanave arrijnë t'i shpërthejnë kufijtë e kësaj 'bllokade' dhe dalin jashtë vendit, me shkëlqimin e suksesit të tyre bëhen yje ndriçues që i japin nder kombit. E tillë është edhe Arbenita Beqiri – Arifi, nga fshati Tërnavë i Luginës së Preshevës. Më hollësisht për kualifikimet dhe kontributin e saj, si ish-studente e universitetit të njohur në botë, Universitetit të Heidelbergut, si punonjëse në Qendrën Perinatale në Ludwigsafen, në vitin e katërt të specializimit në gjinekologji, si dhe rreth majave të suksesit të saj do të njoftohemi në intervistën në vijim, që bëhet ekskluzivisht për revistën 'Paqja'.

**PAQJA: Në mesin tonë është krijuar bindja e inferioritetit të shkollave në Luginën e Preshevës dhe gjithandej nga frymojnë shqiptarët. Madje ata që pas shkollës së mesme merrnin rrugën e mërgimit, as që konsideroheshin se kishin të kryer diçka. Kurse ju e dëshmuat të kundërtën e këtyre bindjeve. Çfarë mund të na thoni më hollësisht për këtë fenomen?**

**ARBENITA BEQIRI - ARIFI:** Është një bindje e gabueshme, nuk mund të hamendësohet në këtë mënyrë, ngase nga shkollat tona kishte, ka dhe do të ketë persona që kanë pasur suksese dhe do të kenë edhe në vazhdimësi, sidomos në vendet evropiane. Mirëpo duhet cekur se për një sukses të tillë është më se e nevojshme edhe vetë-disiplina, si dhe qëllimet sublimë individuale, e mbi të gjitha elani për arritje të tilla.

**PAQJA: Ju shkuat në mërgim, gjegjësisht në qytetin Mannheim-it të Gjermanisë, pasi u martuat, për të filluar kështu një jetë bashkëshortore dhe për të krijuar familje. Por, a ishte ky synim i vetëm, apo qysh më herët menduat që ta kryeni fakultetin diku jashtë shtetit?**

**ARBENITA BEQIRI - ARIFI:** Njëra ju bashkëngjit tjetrës. Ideja ose më mirë të them kushtet dhe rrethanat në

vitin 1996 ishin të atilla, që unë isha e detyruar që planet t'i ilustroja dhe planifikoja ashtu, më shumë për jashtë sesa në vendlindje, konkretisht për në Shqipëri, por caktimi i Zotit ishte që unë ndërkohë u njoftova me bashkëshortin tim dhe kështu kanalizimi i planeve filloi të ngjizet në një jetë familjare dhe paralelisht me të edhe karriera ime.

**PAQJA: Si ju lindi ideja për t'u regjistruar në fakultetin e mjekësisë në universitetin e njohur botëror, Heidelberg, kur dihej mirëfilli se ju nuk e njihnit gjuhën gjermane dhe ishit e angazhuar rreth mirëmbajtjes familjare. Ku e gjetët gjithë atë forcë për t'u rrekur kështu një fakulteti tejet të rëndë?**

**ARBENITA BEQIRI - ARIFI:** Qysh prej fëmijërisë sime, mjekësia ka qenë favoriti im i domosdoshëm dhe nuk kishte asnjë alternativë tjetër për mua. Ndërsa, ideja për të studiuar në Heidelberg, duke marrë parasysh faktin se është një universitet i lashtë me renome botërore dhe gjendet në afërsi të Mannheimit, ishte si synim i parë për mua dhe e shenjësova qysh ditën e parë të arritjes sime në Gjermani, gjë që edhe u realizua pas një viti, pas përvetësimit të gjuhës gjermane.

Është e vërtetë se ishte një betejë e madhe për mua, që t'i kundërvihem të gjitha funksioneve të tjera, ose të them të krijoj rrugë paralele familje-karrierë, rrugë që ishin plot me sfida, duke u munduar gjithnjë të gjej një ekuilibër, por Fuqia nga Allahu xh.sh. dhe bindja e fortë, vetëbesimi dhe përkushtimi i pandërprerë më shoqëruan dhe më ndihmuan t'i kaloja të gjitha këto peripeci.

**PAQJA: A mund të na shkoqitni ndonjë moment interesant, që mund t'ju ketë ndodhur në ditët e para në atë universitet gjigant?**

**ARBENITA BEQIRI - ARIFI:** Njëri ndër rastet me një përshtypje të thellë për mua, ishte hyrja ime për herë të parë në sallën e anatomisë - pjesa praktike e sectionimit, ku aty gjendeshin rreth 30 kufoma. Pra, ishte një lloj sfide e re për mua, e ngjashme me ligjin "gjithçka, apo asgjë", kështu që i mbylla sytë dhe hyra brenda, gjë që me kohë mori edhe kahe indiferente, mirëpo edhe pa e humbur respektin e merituar ndaj atyre të

ndjerëve që kishin lënë testament trupin e tyre për çështje shkencore.

Edhe një fenomen që ia vlen ta përmend ishte, edhe akoma shpesh më ndodh, që unë të identifikohem nga të tjerët si turke ose iraniane, krejt kjo si rrjedhojë e mbulesës sime islame. Por pas prezantimit tim, për shumicën ishte befasuese se paska edhe shqiptare me mbulesë islame, gjë që për shumicën kishte qenë një absurditet.

**PAQJA: Sa ishte e vështirë të studiosh dhe njëkohësisht të merresh me edukimin e dy vajzave? Mbase me këtë veprimtari, ju sikur e hodhët poshtë praktikisht një tezë se gjoja për t'u bërë njeriu shkencëtar/e, patjetër duhet të heqë dorë prej fëmijëve, me këtë edhe prej krijimit të familjes?**

**ARBENITA BEQIRI - ARIFI:** Fatmirësisht, unë pata vazhdimisht mbështetje nga i gjithë rrjeti familjar. Është e vërtetë se një post të tillë dhe njëkohësisht përgjegjësia për edukimin e fëmijëve i kushton shumëkujt forcë, energji fizike e psikike.

Por unë jam edhe më tutje e mendimit se mund të arrihen suksese në të dy lëmenjtë, nëse pra bëhet planifikimi



# OLOGES SHQIPTARE NË GJERMANI

ose organizimi i mirë i jetës, që në asnjë rreth veprimtari të mos ketë mungesë.

**PAQJA: Sa keni mundur ta dalloni vijën ndarëse ndërmjet fakulteteve në Perëndim dhe fakulteteve në trojet tona, veçanërisht fakulteteve të mjekësisë?**

**ARBENITA BEQIRI - ARIFI:** Sipas mendimit tim, mund të polemizohet shumë rreth kësaj çështje, por unë do të cekja konkretisht mundësinë e avancimit të praktikës, si dhe mundësinë e specializimit. Janë këto dy shtylla që i mungojnë goxha shumë universiteteve tona, ose aplikohen me shumë vështirësi ta ne.

**PAQJA: Ju edhe në studime ishit kështu e mbuluar me mbulesë islame. Vallë a paraqiste kjo pamje ndonjë problem brenda atij fakulteti, apo ndodhi e kundërta?**

**ARBENITA BEQIRI - ARIFI:** Gjatë studimeve mund të them se kisha respekt të veçantë, ngaqë vetë pamja e jashtme jepte sinjale më serioze. Natyrisht e subjektivisht, sidomos gjatë konkurimit për punësim, do të thosha se me doemos mbulesa ka luajtur një rol të rëndësishëm për faktin se pas studimeve kisha vështirësi për t'u punësuar, ngase



kushti im primar ishte që të punoja me mbulesë.

**PAQJA: Si mund ta përshkruani shkurtimisht një orë ligjërata në atë fakultet?**

**ARBENITA BEQIRI - ARIFI:** Ishin ligjërata tejet intensive, përplot me gjallëri - që nuk të merrte dot gjumi.

**PAQJA: Pasi e mbaruat drejtimin e mjekësisë së përgjithshme në Universitetin e Heidelbergut, menduat se jetësuat një ëndërr të kamotshme, apo menduat se korrët një sukses që para gjashtë viteve as që kishte ekzistuar në agjendën tuaj të mëtutjeshme?**

**ARBENITA BEQIRI - ARIFI:** Po, siç mund të keni nënkuptuar edhe nga përgjigjet e lartpërmendura. Natyrisht se ishte një "ëndërr" e imja që ta kryej këtë fakultet dhe t'i shërbej popullit tim, kështu që anasjelltas këtë sukses domosdo e kisha të pozicionuar në agjendën time profesionale, gjë që edhe me ndihmën e Allahut xh.sh. e arrita më në fund.

**PAQJA: Përkaj gjithë këtij angazhimi tuaj profesional dhe familjar, ju gjendeni në vitin e katërt të specializimit në Repartin e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës në Qendrën Perinatologjike në Ludwigsafen dhe aktualisht jeni edhe një shtyllë e fortë dhe si financuese e shoqatës "Qendra e Solidaritetit Humanitar". Vallë, si mundni t'ia dilni mbanë gjithë këtij konglomerati aktiviteteve?**

**ARBENITA BEQIRI - ARIFI:** Themelimi i kësaj shoqate "Qendra e Solidaritetit Humanitar" (www.solidariteti.org) daton nga viti 2007, ku përmes angazhimit tim dhe shumë anëtarëve të tjerë të vyeshtëm të kësaj shoqate, më në fund u realizua dëshira jonë, që në këtë mënyrë t'i ofrojmë ndihmë bashkëvendëseve nevojtare në Preshevë e Bujanoc.

Fillimisht, derisa u krijuan strukturat e brendshme funksionale, angazhimi ishte më intensiv se sot, kurse sot mbështetja ime është ajo financiare dhe dhënia e ideve për projekte të reja, që të cilat mandej përpilohen dhe realizohen direkt përmes stafit vendor. Se si arrij që t'i përmbahem gjithë këtij vrulli angazhimesh, kërkoj ndjesë, por unë nuk mund t'ia shpjegoj, jo vetëm juve, por askujt tjetër, sepse kjo forcë dhe ky elan s'ka dyshim se është vetëm dhunti nga

ana e të Plotfuqishmit, kurse unë në komentimin dhe përvetësimin e dhuntive kam ndjesi të madhe.

**PAQJA: Ju në vitin 2009, së bashku me bashkëshortin tuaj, kryet edhe një obligim islam - haxhin. Çfarë mund të na rrëfejë një mjeke për atë vend të shenjtë dhe për ndikimin e atij ambienti në shëndetin e njeriut (shpirtëror dhe fizik)?**

**ARBENITA BEQIRI - ARIFI:** Falënderimi i takon Allahut xh.sh. që unë së bashku me bashkëshortin tim u privileguam nga Krijuesi në vitin 2009, i Cili sikur na bëri thirrje për këtë vizitë në vendet e shenjta Mekë dhe Medinë dhe ne, me plot dëshirë, e pranuan këtë ftesë dhe e kryem kushtin e pestë të Islamit, duke u mundur t'i rrumbullakojmë shtyllat e besimit islam.

Është një gjë e papërshkrueshme, më mungojnë fjalët e duhura për një përshkrim të emocioneve të atilla. Shkurt, një pasurim dhe balsam spiritual, por edhe stimulues i imunitetit pa asnjë dyshim. Mundem të të them vetëm një gjë: - Allahu ja mundësoftë çdo besimtari një përjetim të tillë.

**PAQJA: Planet tuaja për të ardhmen?**

**ARBENITA BEQIRI - ARIFI:** Së pari, natyrisht pres përfundimin e suksesshëm të specializimit, për më tutje kam plane konkrete që të kthehem në vendlindje dhe të jap atje kontributin tim në këtë fushë të specializimit, pra, në Gjinekologji dhe Obstetrikë.

**PAQJA: Mendoni se me shtimin e gjinekologeve shqiptare në vendin tonë, vajzat dhe gratë shqiptare do t'i shpeshtojnë kontrollat gjinekologjike, mbasi dihet mirëfilli se deri tani, për shkaqe turpi (temë tabu) dhe mos vetëdije sa duhet, vajzat dhe gratë shqiptare i kanë vizituar shumë rrallë ambulancat gjinekologjike?**

**ARBENITA BEQIRI - ARIFI:** Shpresoj se po. Së paku duhet të ekzistojë mundësia që t'ju ofrojmë një gjë të tillë, e sa do të arrijmë në ngritjen e vetëdijesimit të gruas është çështje e kohës dhe e angazhimit tonë të përbashkët.

**PAQJA: Ju falënderoj shumë që ndatë kohë për këtë intervistë tejet të begatshme dhe këshillëdhënëse!**

**ARBENITA BEQIRI - ARIFI:** Ju falenderit gjithashtu! ■



# VITEVE TË FUNDIT KOSOVA KA RËNIE TË NATALITETIT

**“Zyra e UNICEF-it ka përkrahur mbledhjen e të dhënave që nga viti 2000, në bashkëpunim me OBH-në dhe UNFP-në. Ky bashkëpunim është fuqizuar edhe me Ministrinë e Shëndetësisë”. “Në bazë të të dhënave që kemi, ka rënie të numrit të lindjeve. Nuk është bërë ndonjë analizë se pse është duke ndodhur kjo, mirëpo mendoj se ndikon gjendja ekonomike, pastaj planifikimi familjar, etj. Edhe pushimi i lehonisë është shkaktar që ndikon në rënien e natalitetit”, - ka thënë Agron Gashi, nga zyra e UNICEF-it në Kosovë**

## **Fatos SHALA**

**N**ë vitin 2000 ka pasur 12 mijë e 300 lindje dhe nga atëherë nataliteti gradualisht ka pësuar rënie. Kushtet në Klinikën e Gjinekologjisë nuk janë të mira. Aty ka pajisje që përdoren tash e 30 vjet. Viteve të fundit në Kosovë shënohet rënie e dukshme e natalitetit. Vetëm gjatë vitit të kaluar, në Klinikën Obstetrike-Gjinekologjike në QKUK janë shënuar rreth 11 mijë lindje”, - ka thënë Minavere Hoxha, shefe e repartit të neonatologjisë. Sipas saj, mungesa e kushteve elementare për punë, po e rrezikon shëndetin e fëmijëve të lindur. Ndërsa, zyrtarë të QKUK-së, ka thënë se priten investime kapitale në këtë repart.

### **Brenda vitit 2 mijë pacientë**

Në repartin e neonatologjisë, që vepron në kuadër të Klinikës Gjinekologjike të QKUK-së, trajtohen shtatzënat me rrezikshmëri të lartë, siç janë: lindje para kohe si dhe fëmijë të rrezikuar nga sëmundjet trashëguese nga prindërit”, - ka thënë Minavere Hoxha, shefe e repartit të neonatologjisë. Në kuadër të kësaj klinike, funksionon njësia e kujdesit intensiv neonatal, ku brenda vitit trajtohen rreth 2 mijë pacientë, ndërsa në Klinikën

Gjinekologjike, për një vit, shënohen rreth 11 mijë lindje”, - tha Hoxha. “Në vitin 2000 ka qenë një numër prej 12 mijë e 300 lindjeve dhe gradualisht ka pësuar një rënie. Këto vitet e fundit sillet rreth 11 mijë lindje brenda vitit. Krahasuar me numrin e lindjeve në mbarë Kosovën, kemi pasur diku rreth 38 mijë lindje. Hetohet rënie diku në 28 mijë, do të thotë gati 10 mijë lindje regjistruhen në Kosovë”, - tha Hoxha. Nga viti 2000, kemi një rënie të lehtë edhe të mortalitetit”, - theksoi Hoxha. “Në vitin 2000, kanë vdekur 31 fëmijë në çdo 1 mijë të lindur të gjallë, ndërsa në vitin 2008 kanë vdekur 13 fëmijë”, - shtoi Hoxha. Megjithatë, problemet në vazhdimësi e përcjellin këtë repart, e që rrezikojnë edhe jetë fëmijësh”, - u shpreh Hoxha. “Kemi pajisje të cilat i përdorim që 30 vjet, si për shembull disa inkubatorë, të cilët nuk kanë rregullatorë të temperaturës, e të cilët mund t’i rrezikojnë foshnjat. Ne kemi rreth 55 foshnja që kanë nevojë për kujdes intensiv, të cilat kanë nevojë edhe për inkubatorë, e ne shërbehemi vetëm me 20 inkubatorë”, - shtoi ajo.

### **Gjendja ekonomike, shkaktar i rënies së lindjeve**

Edhe Agron Gashi, nga UNICEF-i,

konfirmon trendin e rënies së natalitetit, duke cekur faktorët që ndikojnë në këtë çështje. “Zyra e UNICEF-it ka përkrahur mbledhjen e të dhënave që nga viti 2000, në bashkëpunim me OBSH-në dhe UNFP-në. Ky bashkëpunim është fuqizuar edhe me Ministrinë e Shëndetësisë”. “Në bazë të të dhënave që kemi, ka rënie të numrit të lindjeve. Nuk është bërë ndonjë analizë se pse është duke ndodhur, por mendoj se ndikon gjendja ekonomike, pastaj planifikimi familjar, etj. Edhe pushimi i lehonisë është shkaktar që ndikon në rënien e natalitetit”, - theksoi Gashi. Ndërkaq, sipas Skënder Sylajt, udhëheqës i Organizatës Botërore të Shëndetësisë në Kosovë, optimale do të ishte që ligji t’u mundësonte lehonave së paku 6 muaj pushim, sepse, sipas tij, rekomandimet janë që fëmija të ushqehet me qumësht gjiri 6 muaj. “Ende nuk ka ligj për sigurime shëndetësore, as ligj të punës. Andaj, në të ardhmen, OBSH-ja rekomandon fuqimisht që të ketë një bashkëpunim më të mirë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe asaj të Punës dhe Mirëqenies Sociale, në mënyrë që kjo çështje të analizohet, të hartohen dhe përpilohen ligjet, bazuar në kushtet që ekzistojnë, por gjithmonë duke pasur në fokus gruan dhe shëndetin e saj”, -ka përfunduar Sylja. ■

Të burgosurit e Spitalit të Burgut të Dubravës ankohen nga të burgosurit me çrregullime mentale

# Kërkojnë repart të veçantë për të burgosurit me çrregullime mentale

“Është nevoja që të burgosurit me çrregullime mentale të kenë një repart të posaçëm në Burgun e Dubravës, sepse ndonjëherë po kanë fërkime me të burgosurit e tjerë dhe pastaj po është e vështirë të menaxhohet një situatë e tillë”, - është shprehur drejtori i Burgut të Dubravës, Haki Maxharraj

## Qëndresë MUSTAFA

**P**rishtinë, 9 nëntor – Drejtori i Burgut të Dubravës, Haki Maxharraj, ka kërkuar ndërtimin e një reparti të veçantë për të burgosurit me çrregullime mentale, pasi që sipas tij një gjë e tillë do t'ia lehtësonte punën stafit të këtij burgu.

“Është nevoja që të burgosurit me çrregullime mentale të kenë një repart të posaçëm në Burgun e Dubravës sepse ndonjëherë po kanë fërkime me të burgosurit e tjerë dhe pastaj është e vështirë që të menaxhohet një situatë e tillë”, - është shprehur Maxharraj për revistën “Paqja”.

Në anën tjetër, krijimin e një reparti të tillë e ka parë të nevojshëm edhe drejtori ekzekutiv i KMDLNJ-së, Behxhet Shala, i cili ka thënë se të burgosurit me çrregullime mentale janë të rrezikshëm për veten dhe të tjerët.

“Ne kemi kërkuar që ndaj personave me çrregullime mentale, të cilët janë në rrezik për veten dhe për të tjerët, të ketë një njësi spitalore të veçantë, ku ata do të mbaheshin nën kujdesin mjekësor dhe nën kujdesin e shtuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës”, - ka thënë Shala, duke shtuar se për krijimin e një reparti të tillë duhet të obligohet Ministria e Drejtësisë së Kosovës. Mirëpo edhe pse e pyetur nga gazeta për krijimin e një reparti të tillë, zyrtarë nga Ministria e Drejtësisë nuk kanë dhënë kurrfarë përgjigje.

Në lidhje me këtë çështje, për revistën ka rrëfyer edhe një i burgosur i Dubravës, i cili, në kushte anonimiteti, ka thënë se njëri nga të burgosurit, B.K. me çrregullime mentale, ka kanosur fizikisht disa nga të burgosurit e tjerë.

Ai ka treguar se për këtë gjë kanë bërë një peticion me të cilin i janë drejtuar drejtorit Maxharraj.

“Ne të burgosurit kërkojmë izolim të menjëhershëm të personave me çrregullime mentale, sepse po paraqitet një rrezik ndaj nesh. Ditë më parë i burgosuri B. K. ka sulmuar fizikisht N. Osmanin, H.



Raban, L. Rrahmanin, B. Sabedinin dhe B. Malokun”, - është shprehur i burgosuri i spitalit të Dubravës.

## Maxharraj: 13 të burgosur me çrregullime mentale

Drejtori i Burgut të Dubravës, Haki Maxharraj, ka thënë se në këtë burg janë gjithsej 13 raste me çrregullime mentale.

“Tre nga ta i kemi me masë dhe me dënim, ndërsa të tjerët janë vetëm të dënuar, mirëpo janë më pak të rrezikshëm. Këta të burgosur kontrollohen vazhdimisht nga psikiatri dhe neurop-sikiatri”, - ka treguar Maxharraj.

Ai ka treguar se, edhe në kohën kur burgu i Dubravës ka qenë në telash me furnizimin e barnave, janë kujdesur që të burgosurit me çrregullime mentale të kenë terapinë tre javore.

“Në periudhën kur kemi pasur pak telashe, e kemi ndarë terapinë për ta, pra i kemi ndarë injeksionet specifike për ta, që merren çdo tre javë”, - ka deklaruar Maxharraj.

## Kolaj: Nuk kanë paraqitur ankesë të burgosurit

Në anën tjetër Astrit Kolaj drejtor për informim në Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës ka thënë se deri më sot asnjë i burgosur nuk ka adresuar ndonjë ankesë në lidhje me keqtrajtimet fizike nga ana e të burgosurve me çrregullim mendor.

“Të gjithë të burgosurit kanë të drejtë të parashtrajnë ankesa dhe kërkesa. Në këtë drejtim në Qendrën Korrektuese në Dubravë nuk ka pasur ndonjë ankesë që i është drejtuar Drejtorit të Institucionit, por edhe te Komisari i Shërbimit Kor-

rektues të Kosovës nuk ka pasur ankesa të natyrës së tillë”, - është shprehur Kolaj.

## Shala: 20 a 25 ankesa në KMDLNJ

Në anën tjetër, drejtori ekzekutiv i KMDLNJ-së, Behxhet Shala, ka treguar se në këtë këshill janë adresuar 20 a 25 të burgosur për keqtrajtimet e tyre nga të burgosurit me çrregullime mentale.

“Edhe KMDLNJ-ja ka disa vërejtje nga disa të burgosur që në njësinë spitalore të burgut të Dubravës ata qëndrojnë së bashku me personat të cilët kanë çrregullime mentale. Para disa ditësh ata janë sulmuar dhe rrahur nga një person me çrregullime mentale, i cili, në bazë të shëndetit që ka, nuk duhej të ishte aty në asnjë mënyrë. Në këshillin tonë janë adresuar 20 a 25 të burgosur ose të dënuar në lidhje me situatën e krijuar nga të burgosurit me çrregullime mentale”, - ka thënë Shala, duke shtuar se pas marrjes së informacionit, ata kanë kërkuar nga Shërbimi Korrektues që kjo situatë të rregullohet sa më shpejt.

Shala ka thënë se për këta të burgosur është e nevojshme krijimi i një reparti të veçantë, ku ata do të mbaheshin nën kujdesin mjekësor dhe nën kujdesin e shtuar të Shërbimit Korrektues.

“Në planin afatshkurtër janë të obliguar që këtë problem ta zgjidhin Drejtoria e Burgut të Dubravës dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa në planin afatgjatë ky është obligim i Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, të cilët duhet të ndërtojnë një institucion përkatës, ku do të vendoseshin këta të burgosur”, - ka thënë Shala.

Të burgosurit e Burgut të Dubravës janë të vendosur në tetë pavijone banimi, ndërsa në pavijonin e spitalit janë të vendosur pacientët dhe të sëmurët mentalë, të cilëve u ofrohet ndihma mjekësore, përpos rasteve të rënda, të cilat dërgohen në spitalet publike. Jashtë murit rrethues të burgut gjendet pavijoni gjysmë i hapur ku janë të vendosur të burgosurit me rrezikshmëri të ulët, të cilët kanë përcjellje minimale. ■

# Zbulohet ilaçi që zhduk kujtimet e këqija

**Fatos RUSHITI**

**B**ota në të cilën jetojmë na mbush përplot stresse. Jeta jonë është e stërngarkuar dhe thuhet se çdo ditë përballemi me ngjarje që lënë gjurmë në kujtesën tonë. Disa më shumë e disa më pak, të gjitha herët a vonë na shfaqen përpara syve duke na turbulluar mendjen dhe duke na lënduar shpirtin. Sigurisht fjala është për kujtimet e dhimbshme, që edhe kalimi i kohës i ka zbehur shumë pak. Shkencëtarët prej kohësh po përpunojnë t'japin fund kësaj torture për njeriun, e cila do të çonte në shmangien e shumë sëmundjeve, sepse stresi, ose sëmundja e jetës moderne, është shkaktari kryesor i qindra sëmundjeve. Shkenca dhe mjekësia kanë të drejtë kur thonë se kura më e mirë që mund të ekzistojë është lumturia. Deri më tani askush nuk e dinte se në tru ekziston një proteinë, që ashtu si një gomë mund të eliminojë nga mendja jonë përgjithmonë kujtimet e dhimbshme. Ata që e kanë zbuluar, përmes një testi të minjtë, kanë qenë kërkuesit amerikanë të Universitetit "John Hopkins". Ky studim, sipas tyre, përbën një shpresë konkrete për të arritur tek ilaçet, në gjendje të luftojnë shqetësimet e shkaktuara nga stresi post-traumatik. Studimi i publikuar në revistën "Science Express" përbën një thesar të vërtetë për diagnostikimin e shumë sëmundjeve të lidhura me trurin. Të udhëhequr nga profesor Richard Huganir, përmes një testi të minjtë, kërkuesit në fillim identifikuan dhe pastaj hoqën një proteinë në një zonë të veçantë të trurit në gjendje të largonte kujtimet e frikshme nga kujtesa. Për të verifikuar vlefshmerinë e intuitës së tyre, i frikësuan kafshët përmes përdorimit të tingujve dhe pastaj eliminuan

proteinën në fjalë. Pas këtij veprimi u zbulua se tingulli shkaktar kryesor i traumës, nuk ishte më një faktor i lidhur me frikën. Në ndryshim nga kafshët e tjera, minjtë që u bënë pjesë e këtij eksperimenti me pak fjalë e kishin harruar frikën që tingulli kishte shkaktuar tek ata në fillim. Proteina gjendet në atë zonë të trurit që është përgjegjëse për frikërat, si ato ndaj njerëzve edhe nga ato ndaj kafshëve. Për ta identifikuar, kërkuesit vëzhguan mekanizmin që i shtynte disa qeliza të kësaj zone të prodhojnë më shumë elektricitet kur njerëzit frikësohen. Impakti traumatik me frikën shkaktonte një rritje të numrit të këtyre proteinave. Studimi në fund tregoi se pikërisht këto proteina mund të largohen nga qelizat nervore. "Ideja është eliminimi i këtyre proteinave dhe dobësimi i lidhjeve me traumën e krijuar në tru, në mënyrë që të largohen nga kujtesa. Mund të duket si një libër fantastiko-shkencor kapaciteti për të eliminuar në mënyrë selektive kujtimet. Në të ardhmen kjo mund të aplikohet për trajtimet e njerëzve që vuajnë nga stresi post-traumatik, që lidhet për shembull me luftën, me përdhunimet ose ngjarje të tjera që kanë lënë gjurmë në jetën e pacientëve", - tregon profesor Hugner. "Kur verifikohet një episod i këtij lloji, krijohet një kujtim i tmerrshëm që mund të zgjasë gjithë jetën dhe të ketë efekt negativ. Zbulimi ynë përshkruan mekanizmat molekularë dhe qelizorë të përfshirë në këtë proces dhe i hap mundësinë manipulimit të kujtimeve me ilaçe që mund të prodhohen për të përmirësuar terapinë për këto lloje gjendjesh", - përfundon ai. Në fakt, prej vitësh po eksperimentohet për të hed-

hur në treg një ilaç që do na bënte të harronim kujtimet e këqija. Ilaçi do na jepte mundësinë të bënim një jetë më të qetë, pa kujtuar ngjarjet e dhimbshme të jetës sonë. Kërkuesit e Universitetit të Amsterdimit, krijuesit e kësaj pilule betablokuese që në fillim e kanë përdorur vetëm për të rregulluar tensionin e gjakut, kanë qenë në qendër të shumë polemikave. Nëse në fillim pilula që largonte kujtimet e këqija dukej si një mrekulli e shkencës, më vonë u ngritën një sërë dyshimesh. Ata që ishin kundër kësaj iniciative mendonin se kjo pilulë në përpjekje e sipër për të fshirë kujtimet e këqija dhe të dhimbshme mund ta bënte këtë gjë edhe me eksperiencat pozitive, pasi askush nuk mund të garantojë që ajo është në gjendje të bëjë dallim mes tyre. Për këtë arsye, vullnetarët iu nënshtruan me kënaqësi marrjes së kësaj pilule nën mbikëqyrjen e mjekëve. Rezultati befasoi shkencëtarët, jo vetëm sepse personat ishin më të qetë, por edhe sepse në harkun kohor brenda 24 orëve ata i kishin larguar edhe frikërat e tyre. E çfarë mund të ketë më mirë se një jetë e qetë, me kujtime të bukura pa frikë dhe fiksime? Por deri sa përdorimi i këtyre ilaçeve të bëhet masiv, në kuptimin që të dalë në treg dhe të përdoret nga të gjithë ata që vuajnë pasojat e traumave, do të duhet edhe pak kohë. Por po të mendosh se do jetosh i qetë dhe pa stresse, ia vlen të presësh. Njeriu ka nevojë të dijë e të kujtojë. Të ngulisë çdo ditë në mendje mendime, ide, të dhëna që do të duhej t'i përdorte në momente të caktuara të jetës si pika referimi e orientimi. Thuhet se çdo njeri vlen për aq sa di, por harrohet ose injorohet fakti se një njeri di aq gjëra sa mund të kujtojë. Procesi i kujtesës përkon me atë të komunikimit, të të mësuarit dhe të ndërgjegjes. ■

# KONGRESI 'PA' VENDIME

**Naser RAMADANI**

**O**bligimi islam i haxhit është komentuar në mënyra të ndryshme. Për këtë akt të lartë fetar është përdorur edhe termi 'kongres' dhe me këtë nënkuptohet tubimi i muslimanëve anekënd botës. Secili vend që ka banorë muslimanë mund të dërgojë proporcionalisht haxhilerë varësisht prej numrit të banorëve. Dhe ata haxhilerë simbolikisht llogariten përfaqësues – ambasadorë të vendit të tyre në vendin e shenjtë. Vizitorët e shtëpisë së Allahut, janë vizitorë vullnetarë dhe dallimi i tyre nga turistët e rëndomtë është jashtëzakonisht i madh. Haxhi është njëmend kongres, por që dallon prej të gjitha kongreseve që janë mbajtur e mbahen. Aty nuk ka llomotitje të kota. Në haxh dominon dhikri – madhërimi i Zotit. Në haxh nuk ka lider, të cilit i duartrokitet, as fjalime masive të përcjella me ovacione. Mirëpo ka këshilla dhe ligjërata me porosi të qarta. Në haxh nuk sillen vendime unanime të aprovuara në shkresa e akte të shkruara, por secili në vete sjell vendimin personal se ardhja në haxh do t'i shërbejë për t'u përmirësuar në çdo aspekt. Në këtë sens, haxhi nuk është pa vendime, por është kongres ku secili për vete sjell vendimin e vet në përputhje me misionin e përbashkët të të gjithëve. Kongresi i haxhit e ka uniformën e vet unike, që simbolikisht heq diskriminimin material në mes pjesëmarrësve. Ky tubim nuk është mbledhje e tensionimeve, por e shkarkimeve, sepse është vendi i vetëm ku interesi i egos për këtë jetë shtypet nga superegoja për interesin e botës së përtejme. Këtu qëllimi nuk është çka të përfitohet materialisht, por shpirtërisht. Pra, është një lloj egoizmi, por që nuk prek asnjë grimë interesin e tjetrit; është egoizëm që praktikisht shndërrohet në altruizëm për tjetrin. Tubimi rreth Qabesë nuk korrespondon me tubimet

e zakonshme, ku njerëzit bërtasin e zhurmojnë për të manifestuar pakënaqësi – e kënaqësi, për të kërkuar ose protestuar, por është grumbullim rreth një epiqendre, që realisht është pikëtakim dhe puqje e një synimi të përbashkët e sublim. Qëllimi këtu nuk ka të bëjë me tokën, por me qiellin. Njeriu i drejtohet hapësirave të larta për t'i kërkuar horizontet e mëshirës. Duke madhëruar e adhuruar Zotin, duke i kërkuar pendesë e falje Atij dhe duke shprehur frikërespekt ndaj Krijuesit të vetëm, njeriu, si krijesa më e përsosur e Tij, shpreh shkallën e madhe të vetëdijes për misionin e tij në këtë jetë. Kështu, duke e kuptuar qëllimin e jetës, ai sillet rreth Qabesë, jo sa për të kryer një formalitet ritual që për dikë tjetër mund të jetë i pakuptueshëm, por e bën këtë veprim duke synuar afrimin nga pikëtakimi. Qabeja është shtëpia që lidh të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen. Përballë shikimit të tashëm të Qabesë, besimtari e lidh të kaluarën me të ardhmen. Ai sjell ndërmend të shkuarën rreth Qabesë dhe të ardhmen rreth saj. Krahason brezat ndër shekuj dhe e mendon veten në këtë ndërlidhje. I mendon kongreset e kaluara, të tashmet dhe të ardhmet. Edhe këto i krahason. Rreth Qabesë sillet historia e muslimanëve. E shkuara e lavdishme, e tashmja e palakmueshme dhe e ardhmja e rikthesës. Haxhi, ky kongres simbolik i muslimanëve, duhet të jetë shembull për një kongres tjetër, kongres që do të lidhej me vendime ekonomike, politike, kulturore, sportive etj, me përfaqësues ajkën e intelektualëve nga të gjitha vendet ku jetojnë muslimanët; ku do të shkëmbeheshin mendimet, idetë, strategjitë dhe vizionet e së ardhmes. Kongresi shpirtëror duhet ta ketë edhe kongresin material – kongresi pa vendime, duhet ta ketë edhe kongresin me vendime. Zaten edhe jeta e muslimanit nuk është vetëm aktivitet për jetën e botës tjetër, por edhe për jetën e kësaj bote. ■

**Të gjithë besimtarëve muslimanë ua urojmë Festën e Kurban Bajramit!**



**Arsim JONUZI**

**N**ë një shkrim të korrespondentit të RFE (Radio Free Europe) Robert Tait, thuhet se, për hir të së vërtetës, duhet pranuar se ndërhyrja e SHBA-ve në Irak ka pasur mëkatet, dështimet, pasojat e paparashikuara dhe po shoqërohet me jo pak dyshime për të ardhmen. Ushtarët amerikanë që u larguan nga Iraku, lanë pas vetes një vend të goditur dhe të mbështjellë nga po aq paqartësi sa kishte ndoshta edhe atëherë kur "koalicioni i vullnetit" pushtoi Irakun për të rrëzuar regjimin e Sadam Hysein, në mars të 2003-ës. Sadami tashmë ka kohë që nuk është më, por pyetja se cila palë është fituese, ende nuk ka përgjigje të qartë. Krejt ndryshe edhe nga përshtypja që krijohet me largimin e ushtarëve luftarakë amerikanë, Iraku sot është shumë larg të qenët i sigurt. Kryengritja e militantëve vazhdon të mbetet shumë aktive. Zyrtarët irakianë thonë se në korrik humbën jetën 500 persona, përfshirë 396 civilë, duke e bërë këtë muaj me numrin më të madh të vrasjeve në dy vjet. Mundësia për më shumë viktima në këtë konflikt është reale. Ky vlerësim mund të mbështetet në statistikat e ofruara nga një organizatë e pavarur monitoruese, "Numri i vdekjeve sipas logaritmes së trupave irakiane është mes 97 mijë deri në

106 mijë civilë. Sa i përket demokracisë, Iraku ende nuk ka qeveri funksionale të zgjedhur për shkak të mosmarrëveshjeve për rezultatin e zgjedhjeve të marsit të kaluar. Kjo lë një vakum politik, prej të cilit rrezikohet lulëzimi i grupeve të dhunshme, njëjtë siç është Al Kaida. Ekonomia e Irakut gjithashtu mbetet e paqëndrueshme, ndërsa kohezioni shoqëror është i dëmtuar rëndë. Sipas shifrave të Pentagonit, lufta në Irak ka marrë jetën e gati 1500 ushtarëve amerikanë. Për këtë arsye, entuziazmi i papërmbajtshëm i forcave amerikane që largohen prej Irakut është i kuptueshëm.

# KUSH FIT KUSH NË



**Ushtarët amerikanë gati për t'u kthyer në shtëpitë e tyre**

Sidoqoftë, çka do që lënë prapa këta ushtarë, shumë pak mund të quhet paqe ose stabilitet. Eksperti i studimeve paqësore nga Universiteti Bradford në Angli, Paul Roxhers, thotë se rezultati i kësaj lufte është krejt ndryshe nga sa është pritur të jetë në mars të 2003-ës, atëherë kur presidenti Xhorxh Bush urdhëroi pushtimin e Irakut. "Është shumë ndryshe nga sa është pritur para 7 vjet e gjysmë, atëherë kur pritej që Iraku do bëhej shumë shpejt një shtet paqë-

sor pro perëndimor; ekonomi të lirë dhe shumë efektive". "Megjithatë, rezultati real është rreth 100 mijë civilë të vrarë, 4 milionë refugjatë dhe një

luftë shumë e zgjatur, ku së paku tani ka lënë një nivel tepër të lartë paqëndrueshmërie", - thotë profesori Roxhers. Këto pritje ngatërruese bëhen më të qarta kur dëshiron që t'i ndash fituesit nga humbësit. Në mesin e grupeve irakiane, kurdët duket që janë fituesit më të pastër. Ata kanë arritur të fitojnë autonomi në verilindje të Irakut, një rajon ky që mbetet relativisht stabil. Ndërkaq, jo për të gjithë, një fitues edhe më i madh konsiderohet komuniteti shiit. Ky komunitet ka fituar fuqi politike, prej së cilës ishte përjashtuar nga regjimi i Sadamit. Atëkohë,

pakica sunnite mbante frerët e shtetit. Komuniteti sunnit, krejt ndryshe nga dy komunitetet e mësipërme, ka humbur shumë në rrjedhat politike të shtatë vjetëve të kaluara. Mirëpo, ajo që shkakton humbjen e entuziazmit në perspektivën e politikëbërjes amerikane, është përparësia strategjike e fituar nga kundërshtari satanik i SHBA-ve, Irani. Ky shtet përfitoi me rrëzimin e regjimit të Sadam Hyseinit, me të cilin bëri një luftë të përgjakshme për tetë vjet, gjatë viteve të '80- ta. Sunduesit fetarë në Teheran patën mundësi që t'i shfrytëzojnë myslimanët shiitë, që përbëjnë shumicën e popullatës në Irak, që të fitojnë ndikim më të madh politik në të ardhmen. "Irani

ndoshta ka fituar më së shumti, ndërsa Arabia Saudite shumë më pak dhe për këtë ka shqetësime në mbretëri për mënyrën se si Irani e ka arritur këtë. Kjo, në fakt, nuk ka ndodhur pse shiat e Irakut janë shumë të lidhur me Iranin". Teologjikisht, mund të thuhet se Islami i shia-ve ka më shumë vende të shenjta në Irak se sa në Iran". "Për këtë arsye, duhet shumë vëmendje se si iranianët po tentojnë që të ndikojnë sa më shumë. Por, prapë po them që, në përgjithësi, Irani është përfituesi më i madh i ndryshimeve në Irak, sa i përket rajonit në tërësi", - vlerësoi profesori Roxhers. Fitimi i Iranit mund të jetë edhe humbja e Izraelit. Pak para nisjes së luftës, qeveria e atëhershme e Ariel Sharonit në Tel-Aviv, përkrahte heqjen e regjimit të Sadam Hyseinit. Ky qëndrim më shumë mbahej edhe për shkak të sulmeve me raketa Skud nga Iraku kundër Tel-Avivit më 1991. Në Izrael besohej gjithashtu se menjëherë pas pushtimit, duhej të investohej në Irak dhe pritej edhe një rritje e turistëve izraelitë në Irak, vendi prej nga hebrenjtë u larguan pas krijimit të shtetit të Izraelit më 1948. Tani, politika në Izrael më shumë preokupohet për rritjen e Iranit si armiku satanik i rajonit dhe si një kërcënim potencial. Derisa operacionet luftarake amerikane zyrtarisht përfunduan në mbarim të gushtit, 50 mijë ushtarë të tjerë amerikanë do të mbesin në Irak deri në fund të vitit të ardhshëm. Këta ushtarë, tani e tutje, më shumë do të jenë në pozitën e "këshilluesit", megjithëse mund të ndërhyjnë drejtpërdrejt nëse një gjë e tillë bëhet sërish e nevojshme. Për ekspertin irakian të shkencave politike, Hameed Fadhel, ligjërues në Universitetin e Bagdadit, Iraku do të vazhdojë ta mbështesë më shumë sigurinë e ofruar nga amerikanët. "Mendoj se prania ushtarake amerikane, ose mosprania, nuk do të ketë ndonjë efekt në SHBA. Shtetet e Bashkuara tani kanë ambasadën më të madhe të tyre në botë në Bagdad, nëse e masim për nga madhësia ose numri i punonjësve". "Megjithatë më duhet të them se Iraku është ende shumë i varur nga SHBA-të në shumë forma, p.sh., sa i përket sigurisë së jashtme irakiane, përkushtimit amerikan që të mbrojë Irakun nga sulmet e jashtme", - shprehet profesori Fadhel. Aktualisht, në Irak, mbrojtja ajrore mbetet tërësisht në duart e amerikanëve, pasi Iraku nuk ka kushte ose pajisje që ta bëjë vetë një gjë të tillë. Ndërkaq, për të ardhmen, pas largimit të trupave luftarake amerikane nga Iraku, pritet një rritje e organizatave private të sigurisë. Sipas Nju Jork Tajms-it, Departamenti Amerikan i Shtetit po planifikon që të dyfishojë numrin e gardianëve privatë të sigurisë, duke angazhuar shtatë mijë të tillë që t'i mbrojnë civilët. ■

# POI DHE HUMBI IRAK?

duresit fetarë në Teheran patën mundësi që t'i shfrytëzojnë myslimanët shiitë, që përbëjnë shumicën e popullatës në Irak, që të fitojnë ndikim më të madh politik në të ardhmen. "Irani



# Artisti që punon për artin

Besime RRUSTEMI

**T**ë jesh artist dhe të rrëfesh për artin është ashtu si të rrëfesh për shpirtin. Arti kërkon nga shpirti i artistit që të mbytet në të për të lindur diçka e re, në mënyrë që ta përfaqësojë atë nesër. Dihet se çdo lindje për nesër është me vaj, por me vajin duhet pajtuar me diçka tërheqëse. Për këtë artisti e do edhe më shumë punën. Janë këto fjalët e Naser Shatrollit, i cili punon dhe jeton për artin. Për të ditur më shumë, sjellim për revistën 'Paqja' një pasqyrë të shkurtër për artistin, skenaristin, dramaturgun dhe kritikun, që tashmë frymon për artin.

**PAQJA: Të jesh artist do të thotë të jetosh me realitetin dhe trillin, na përshkruaj pak jetën tuaj artistike?**

**S H A - TROLLI:** Po përvojat e mia dëshmojnë se unë jam një artist që punoj art, shkruaj art, jetoj për

të mbetur diçka nga unë dhe për mua, për shtëpinë time ku banoj dhe për sensin tim artistik, për teatrin, për filmin dhe për kritikën e kulturën në përgjithësi.

Pra, jam skenarist, dramaturg e kritik dhe tentoj që të ngelem në këto konure, brenda këtyre mureve artistike, për të jetësuar idealin tim jetësor. Pra, unë jam i përcaktuar për skenën dhe shiritin filmik, dhe si përfundim jam edhe aktor. Jeta ime lidhet me skenarin dhe me regjinë, edhe pse nuk jam duke bërë regji akoma, por skenari është regji. Skenari e bën regjinë, aty lidhen urat e një filmi të një përralle njerëzore si ngjarje e vërtetë ose e miksuar mes të vërtetës dhe trillerit dhe skenaristi është ai që lind i pari, pastaj të tjerët e jetësojnë atë lindje.

**PAQJA: Sa është vështirë të jeni artist dhe të jeni çdoherë në sens të mirë për të ushtruar profesionin?**

**SHATROLLI:** "Për të qenë" - duhet lindur për atë ideal, goxha guxim dhe krenari është nëse e ruan statusin e një artisti në këto rrethana. Nuk do të thotë që unë kaloj nëpër rrugë pa gropa, por ato gropa tentoj t'i tejkaloj sepse e kam obligim. Arti kërkon prej meje të mbytem në të, prandaj unë duhet të mbytem në art për të lindur diçka e re, që më përfaqëson mua nesër, për të mos mbetur i vetmuar në rrugëtimin tim.

Pra, vështirë është gjithmonë, çdo lindje është me vaj, por vaji duhet pajtuar me diçka tërheqëse dhe është puna që e mashtron vajin e një veprë të lindur. Unë e dua buzëqeshjen në veprat e mia dhe dua që kjo tendencë të dominojë mbi vështirësitë.

**PAQJA: Na e përshkruani pak rrugëtimin tuaj nëpër art, kur jeni ndierë në vaj dhe cilat janë sukseset që të kanë sjellë gëzime?**

**SHATROLLI:** Kam rrugëtuar nëpër dërrasa teatrore që një kohë, jam pjekur për dërrasat, ndërsa me krijimtari, drama dhe skenarë ka disa vite që jam duke shkruar dhe çdo gërmë për mua është vaj. E them singlerisht, po jetoj me këtë vaj, sepse të lindësh diçka që duhet inskenuar ose filmuar është dhembje dhe këtë dhembje vetëm vaji e shëron, ose e zbut, pra vaji është përgjegjësi dhe ngushëllim artistik për mua.

Sukseset maten me dashurinë që kam për sukseset e mia. Unë e dua më shumë punën sesa suksesin, sepse sukseset rrallëherë shpërblehen me trofe. Pra, unë nuk punoj për trofe, por për dëshmi artistike në histori dhe nëse më jep dikush trofe, unë i them publikisht faleminderit.

**PAQJA: A mund të na e shpalosni krijimtarinë tuaj artistike, e cila është vënë në skenë apo teatro për artdashësit?**

**SHATROLLI:** Tani kam shkruar katër drama teatrore. Janë zhanër komedi e zezë. Ato jam duke i përgatitur për t'i botuar në një libër të vetëm. Njërin nga ato do ta inskenoj vetë.

Kam shkruar një mori skenarësh për filma artistikë. Po ashtu, kam shkruar disa skenarë për studentë. Prof. Isa Qosja ma ka besuar këtë punë për studentët e tij. Po kështu kam shkruar edhe skenarin që fitoi në festivalin vendor "Nine-elleven", garë të cilën e cilësoj si garë të fortë.

**PAQJA: Është fjala për filmin "Muri"?**

**SHATROLLI:** "MURI" u filmua kësaj vere dhe mori pjesë në këtë festival në shtator të këtij viti dhe u shpërblje me një trofe. Po kështu, edhe në Maqedoni, ka fituar një skenar i imi i metrazhit të shkurtër, tek Qendra Kinematografike e Maqedonisë. Producent i këtij projekti është Avni Dalipi. Tash pritet të fillojnë xhirimet e këtij skenari.

Jam duke shkruar dy skenarë paralelë, njëri do të filmohet nga fundi i vitit, ndërsa skenari tjetër është i metrazhit të gjatë dhe po përgatitemi që të garojmë te QKK-ja.





Në bashkëpunim me mikun tim Ujkan Hysaj, këto ditë kemi punuar për përgatitjen e një dokumentari, një qasje a tendencë e re pune, që dokumenton se çka ka qenë këtë edicion ky festival dhe se kush kanë qenë pjesëmarrësit, në të njëjtën kohë, i përkujtuam doajenët e skenës vendore nëpërmjet "Kosovainfestit" dhe analizave të shumta mbase me dhjetëra, për të gjitha shfaqjet teatrore, festivalet e filmit, muzikës, galerisë, pra një galeri e tërë analizash për secilën ngjarje në këto pesë vitet e fundit. Në të njëjtën kohë, kam bërë një mori intervistash me emra të letrave, këngës, skenës dhe kulturës shqiptare kudo. Pra, ideja ime ka qenë që të krijohet ura artistike për të ndërtuar ura artistike në ecje.

**PAQJA: Na flisni konkretisht për filmin MURI?**

**SHATROLI:** MURI flet për muret

njerëzore, për muret fizike e psikike të njeriut para dhe pas luftës. Në fakt, fabula lidhet me luftën.

Personazhit tim "Ylberit", duke e tejkaluar murin e oborrit, ia vrasin gruan dhe ato mure do të shndërrohen në hasmëri për të, në mure që nuk të çojnë askund, në mure që të ndajnë nga fqinji, fshati, qyteti dhe shteti.

Pra, Ylberi, tenton që të shërohet vetë pas luftës. Me këtë sjell mesazhin se muret nuk sjellin paqe mes njerëzve e popujve. Përkundrazi, ato vetëm s'rrisin hasmëri. 'Murin' e ka përkrahur fort publiku në Prishtinë.

Tani jemi pjesëmarrës në një festival të njohur "TIF" në Tiranë. Të shohim si do pritët. Muri hapi një koncept të ri edhe për komunitetin artistik. Vërtet, thashethemet mes nesh duhen rrënuar me Çekiçin e Ylberit.

Pra, 'Muri' ka një histori brenda vetes dhe më vjen mirë që arritëm të filmojmë me mikun tim Gazmend Nelën, regjisor, dhe me ekipin e shkëlqyer: Xhelalin, Ilirin, Auritën, Dardanën, etj.

**PAQJA: A do të jeni pjesëmarrës në ndonjë nga festivalet e radhës?**

**SHATROLI:** Ne kemi konkurruar në Tiranë dhe më 1 dhjetor fillon festivali. Po ashtu, do të jemi pjesëmarrës edhe në dy festivale ndërkombëtare. Besoj që do të korrim suksese. Si përmbyllje, ky film më ka hapur shumë mundësi pune. Tash jam duke shkruar një serial televiziv. Nuk dua të jem patetik, thjesht, po tentoj të bëj punën time në raport me kërkesat.

**PAQJA: Cilat janë angazhimet e tua**

**të tjera?**

**SHATROLI:** Këto ditë do të fillojnë xhirimet për një film artistik, film që ka fituar për këtë vit tek QKK-ja. Pra, është një projekt serioz. Regjisor i këtij filmi është Agim Sopi.

Unë do të luaj një personazh negativ, një paramilitar serb që shkatërron shtëpi e jetë në Kosovë. Është një punë që shpresoj që do të ketë goxha punë në teren, por unë jam bërë gati. Studimet i kryej në klasën e prof. Haqif Mulliqit. Edhe aty kemi kërkesa të shumta për skenar, drama dhe forma të tjera fakultative, por dua të them se profesorët e mi janë pjesë e suksesit tim.

Po ashtu, ditë me parë kanë filluar edhe xhirimet për filmin "Agnus-day", me regji të Agim Sopit.

**PAQJA: Për fund një mesazh për lexuesit e revistës 'Paqja'.**

**SHATROLI:** Faleminderit shumë! PAQJA është pjesë e jetës sime. Kam shkruar disa herë për artin në këtë mozaik vlerash. Më beso të gjithë ata njerëz që punojnë dhe që kanë dhënë kontribut te kjo revistë njerëzore dhe artistike janë të mrekullueshëm. Fjalët më të mira dua që të m'i përcjellësh në adresë të tyre. Në të njëjtën kohë, më vjen mirë që pata mundësi e kënaqësi që biseduam së bashku. Dua të të shpreh mirënjohje dhe të përgëzoj për dashurinë që ke për artin gazetaresk. Fundja, është puna jote që e mban të gjallë edhe artistin dhe ti nuk je më pak e vlerësuar, përderisa tenton t'u ofrosh lexim të notuar me nota artistike lexuesve tuaj. Uroj që autostrada e paqes të ketë shtrirje kudo që njerëzit duan të udhëtojnë! ■



# ALFABETI I ANTROPOLOGJISË



**A**rsim Canolli, që në hapje të librit “Kultura K”, shpalos para lexuesit qëllimin autorial, i cili provon të na njoftojë me fenomenin e kulturës përtej argumentimit disiplinuar e interdyscyplinuar, duke polemizuar brenda këtyre kufijve dhe rreth këtij nocioni me dijet dhe dijetarët që janë marrë me këtë problem, si dhe duke e parë atë si fenomen të shtrirë brenda kontekstit aktual kohor. Kultura, si një fenomen reprezentativ i çdo shoqërie të civilizuar, është njësi matëse me të cilën vlerësohet një shoqëri. Duke lexuar librin KULTURA K, të Arsim Canollit, hetojmë një identifikim të hollë dhe të qëlluar, të argumentuar edhe empirikisht, por edhe në rrafshet e tjera, se: “...është vërtetuar se bukuria e kësaj kulture të lartë, të cilën e ruan refuzimi estetik, rri në fron të kulturës në përgjithësi.” Këtë lloj refuzimi Canolli e heton të kultivuar edhe në kulturën e re kosovare, jo vetëm në sferën artistike, jo vetëm të artikuluar në fushat humane, ekskluzivisht jo vetëm në arte, por edhe në sferën politike, kulturë të cilën Canolli e sheh si imediate në kontekstin kohor kur fillon të shfaqet.

Këtë formë të mendimit, në ruajtjen e kulturës dhe qenësisë së saj të vërtetë, fuqisë së saj estetike, në kontekstin e ri historik të Kosovës, ai e sheh të integruar edhe në sferën politike. Në këtë mënyrë shpjegohet, sipas tij, fuqia e mendimit ‘ndryshe’ në raport me atë që e prodhonte politika denigruese serbe. Në këtë mënyrë, fryma e re e mendimit e kultivuar fillimisht në letrat shqipe, kaloi kufijtë e botës së letrave, për të prodhuar një lloj filozofie politike e njohur ndryshe si politika paqësore.

Diferencimi i Kulturës K, me K të madhe të shkrimit nga kultura k, me k të vogël të shkrimit (ose pop kulturës) është segmenti brenda të cilit shtrihet mendimi, meditimi dhe kërkimi i Canollit, segment i cili rizbulon dhe rivërteton mendimin mbi konceptin e kulturës se: krahas kulturës së qenësishme, asaj të vërtetës, origjinale, përbri saj zhvillohet gjithnjë hija e saj, ajo që e përcjell dhe që Canolli e markon me emrin kultura k, me k të vogël të shkrimit.

“Medet! Ky (libri) ka me shkatërrue atë katedrale” - kjo referencë nga romani Katedralja e Parisit, të shkrimtarit francez Viktor Hygo, është një identifikim i fenomenit të dualitetit të natyrshmërisë së kulturës si nocion, dualitet të cilin Canolli përpiket ta diferencojë gjatë gjithë shkrimit/ diskursit të tij mbi fenomenin e kulturës. Por të merremi vesh, dualitet në kuptimin e identifikimit me këtë nocion, sepse edhe kultura me k të vogël të shkrimit, gjithnjë provon të dalë e para, respektivisht ta përjashtojë tjetrën si të pavlerë. Pra, edhe kur kthehet në retrospektivë, ai heton me të drejtë se ka ekzistuar kultura K e kultivuar nga elita e popullit, që ka kërkuar gjithmonë, në përhershmërinë e saj, konsumatorë të përzgjedhur dhe elitare. Por krahas kulturës me K të madhe të shkrimit,


është kultivuar një lloj kulture e ultë, masive, e cila ‘përthypet’ lehtë nga masa, nga masiviteti konsumatoresk. Letërsia e shkruar, sipas Canollit, është reprezentuesja dhe kultivuesja më e denjë e kulturës K, shpirti i të cilës, së bashku me artet e tjera klasike dhe moderne, janë rrezikuar sadopak ose sado shumë nga mundësia e madhe e kontaktit me masën. Natyrisht ky mendim është i rifikuar meqë u referohet edhe antropologëve të huaj që ndajnë të njëjtin mendim. Mediativiteti, publikimi aq i madh i veprës, aq i shpeshtë dhe mundësia për ta ‘ripërthypur’ atë nga masa, rrezikon tëhollimin dhe ‘diferencën’ ndërmjet dy llojeve të kulturave: Kulturës me K të madhe të shkrimit dhe antipodit të saj.

## Mbyllja

Libri KULTURA K ka pasuruar vitrinat dhe raftet e bibliotekave tona, duke përplotësuar mungesën e librave të kësaj fushe. Ai na ofron burime të shumta të dhënash mbi fenomenin e kulturës. Ai na ofron informacione të bollshme me të dhënat mbi lakesat dhe trajtesat që pati në teoritë klasike dhe moderne ky nocion. Duke shtuar edhe faktin se autori i këtij libri është kosovar, kjo ia shton pa dyshim vlerën këtij libri.

Ne po e mbyllim këtë shkrim duke pritur edhe projekte të tjera në fushën e Antropologjisë nga autori i këtij libri, i cili jep dëshmi për mjeshtërinë e dorës së tij në shkrime dhe hulumtime të tilla.

(I. T.)



# Bukuria e zërit

## BIO-FOTOGRAFIA



Shpresa Gashi

Imer TOPANICA

**S**'ka shumë që nga shpallja e pavarësisë e këndej që ne filluam të mësohemi me rikujtimin e të kaluarës sonë jo të largët, duke i rikujtuar emrat që defiluan në skenën vendore artistike. Disa prej këtyre emrave, ka ardhur koha t'i rikujtojmë si emra që përbëjnë historinë e kulturës së artit. Ndër këta emra të lakueshëm në këtë kuptim është pa dyshim edhe Shpresa Gashi. Emri i saj është referencë në kuptimin e orientimit drejt vlerave të mirëfillta artistike. Këtë vit, ajo festoi 40 vjetorin e karrierës së saj muzikore me anë të një koncerti muzikor në Teatrin Kombëtar të Kosovës.

Ajo u lind në një familje me traditë artistike. I ati i saj ishte një njeri i pasionuar pas fotografisë. Gjyshja e saj, Nicë Gashi, njihej për mjeshtërinë e saj në lojën me instrumentet harkore, si violina. E ëma e saj, Gjina Gashi dhe tezja e saj Jozefina e kishin pasion muzikën, respektivisht ishin këngëtare me profesion. Ndërkaq një kushërire e saj me emrin Gonxhe, ishte soprano me emër në Kosovë.

Pas përfundimit të shkollës së mesme të muzikës në qytetin e Prizrenit, punoi si mësuese në qytetin e Pejës, në qytetin e lindjes së saj. Kjo pauzë e shkurtër u bë para fillimit të studimeve të mëtutjeshme. Kështu, në vitin 1970 filloi studimet në Akademinë e Muzikës në degën e Teorisë së Muzikës. Përpos kësaj, ajo u angazhua dhe mori mësimë speciale për solokëndim te profesorët më eminentë të kohës në Tiranë, Shkup dhe Zagreb. Duke ndjekur gjurmët e idileve të saj të muzikës si Tefta Tashkos, Marie Krajës, Lucie Milotit dhe ikonën kosovare të muzikës së asaj kohe, Nexhmije Pagarushës, ajo arriti të bëhej pjesë e Ansambllit Profesional në Zagreb. Kjo ndodhi pas diplomimit të saj në vitin 1974, në Akademinë e Muzikës. Kontributi i saj u pa edhe pas themelimit të redaksisë së muzikës në Televizionin e Prishtinës. Ndërsa në vitet 1990 ajo përmbylli një pjesë të suksesshme si pjesë e korit të Radio Prishtinës, si soliste e këtij kori. Pastaj, pas vitit 1990, ajo përjetoi fatin e keq që e kishte përfshirë popullin

dhe vendin e saj. Shpresa Gashi ka kënduar në shumë festivale dhe skena muzikore, në hapësirën shqiptare dhe jashtë saj, në vendet ballkanike, në Evropë, SHBA dhe Australi. Zëri i saj, i sopranos lirike, me një koloraturë të veçantë, është në më se 60 incizime, shumë prej të cilave edhe janë vlerësuar me çmime të ndryshme. Shpresa është edhe kantautore e tetë këngëve. Ka disa këngë në duet me Bashkim Paçukun, Xhelal Bakraqin dhe një me djalin e saj, Edmondin. Te ky i fundit ajo mbështet shpresën se do të vazhdohet tradita kulturore e kultivimit të këtij arti të fisëm.

## EPILOG

Me gjithë moshën e saj, ajo ende duket vitale. Bukuria e zërit të saj i ka dhënë ngjyrim gjithë karakterit të saj, madje edhe pamjes. Ky shkrim modest do të mbyllet duke rikujtuar njërin nga kryeveprat e Shpresa Gashit, në të cilën Shpresa kishte shkëlqyer sipas kompozitorit Rafet Rudi. Ajo këtë vit, më saktë më 7 shtator, festoi gjashtëdhjetë vjetorin e lindjes dhe dyzet vjetorin e paraqitjes skenike të saj. Teatri Kombëtar i Kosovës, ishte nikoqir i një mbrëmje koncertale, në të cilën heroina e kësaj mbrëmjeje, Shpresa Gashi, interpretoi disa nga këngët e saj më të reja. Ajo na la pas një pasuri të madhe muzikore, një sharmë të veçantë të paraqitjes dhe një stil gjithsesi të veçantë. Fare në fund, ne urojmë që shëndeti dhe guximi i saj artistik ta sfidojë ende moshën e saj. ■



# LETËRSIA BËHET SHKENCË


## Neuronet e aktivizuara

**P**ërse na pëlqejnë romanet? Pse pasionohemi aq shumë pas personazheve që nuk ekzistojnë? Cilat procese mendore të fshehta aktivizohen kur lexojmë një libër? Deri më tani pyetjeve të tilla i përgjigjeshin vetëm kritikët letrarë, docentë të letërsisë dhe shkrimtarët. Tani këtyre pyetjeve po provon t'i përgjigjet edhe shkenca. Pas disa muajsh, një grup studentësh do t'i nënshtrohen një eksperimenti pa precedentë: atyre do t'u jepet që të lexojnë tekste të ndryshme, një artikull në gazetë, një roman të thjeshtë, një tjetër pak më të vështirë. Ndërkohë "kaviet" do të vëzhgohen nga një skaner për të matur qarkullimin e gjakut në qelizat e tyre cerebrale, ose më saktë për të dizajnuar një hartë të reageimeve të tyre neurologjike ndaj leximit. I organizuar nga Universiteti Yale, kjo iniciativë është pjesë e një studimi të ri të letërsisë, që është pagëzuar me emrin "neuro lit crit", kritika letrare neurologjike, por ka edhe nga ata që e quajnë "shkenca e letërsisë". Studimi është bërë fryt i një debati, i cili ka nisur në të dyja anët e Atlantikut, fillimisht në Shtetet e Bashkuara, pastaj në Britaninë e Madhe, për të vendosur nëse kritika letrare, pasi ka kaluar përmes skemave të marksizëm-leninizmit, të psikanalizës dhe feminizmit, pasi kaloi strukturalizmin dhe poststrukturalizmin, është në gjendje të bëjë një hap përpara revolucionar, këtë herë me ndihmën e mjekësisë dhe teknologjisë.

"Ka qeliza specifike cerebrale që i përgjigjen leximit dhe në këtë mënyrë mund t'i studiojmë", pohon profesor Richard Wise, neurolog i "Imperial

College" në Londër dhe një nga promovuesit e programit, në të cilin kanë marrë pjesë si shkencëtarë, ashtu edhe akademikë të formimit humanist. Por jo të gjithë janë dakord me këtë studim: "Mua më duket një marrëzi", - deklaroi për "Observer"-in e Londrës, doktor Ian Patterson, docent letërsie në Universitetin e Kembrixhit, kur u prezantua eksperimenti me

nesh ka me librat. "Të njohësh shkencën pas lëvizjeve të një komete, nuk e venit bukurinë e një qielli të mbushur plot yje", - komenton profesor Jonathan Gottschall i Universitetit Washington and Jefferson College në Pensilvani. "Është një nga zhvillimet më emocionuese në studimin e jetës intelektuale", - bashkërendon Blakey Vermeule, nga Universiteti i Stendfordit.



Por në çfarë kuptimi mund t'i analizojmë reagimet e trurit pasi lexojmë një vepër të Shekspirit, Prustit, ose Virxhinia Ulfrit? Një hipotezë që "neuro lit crit" ka si qëllim të verifikojë është se pasioni për tregimet ka një bazë në zhvillimin e njeriut: nëse njeriu e ka ndier gjithmonë dëshirën dhe nevojën për të dëgjuar dhe lexuar histori imagjinare, ndoshta do të thotë se kjo karakteristikë ishte e nevojshme, e parashikuar nga natyra, e vendosur në kodin tonë gjenetik të zhvillimit. Një tjetër aspekt i kësaj teorie është emërtimi, sepse te njeriu është zhvilluar shumë altruizmi, edhe pse gjenet tona egoiste kanë pasur një rol tepër të rëndësishëm në mbijetesën e llojit. "Për të na dhënë një nxitje që të bashkëpunojmë me të tjerët, ndoshta nëna natyrë na ka pajisur me një shqisë për të refuzuar padrejtësinë dhe

një ndjesi kënaqësie, e cila aktivizohet kur një njeri që gabon e pëson", - thotë William Fleisch, docent letërsie në Universitetin Brandeis. "Kjo është edhe arsyeja që na pëlqejnë romanet dhe tregimet, sepse braktisin 'ndëshkuesit altruistë', personazhe që përkrasin padrejtësitë, pa përfituar ndonjë për veten, nga Odiseja te Don Kishoti e Hamleti", - përfundon ai. ■

(E. Ymeri)

# DIABETI



## epidemia e mijëvjeçarit të tretë

Në bazë të hulumtimeve është llogaritur se një e treta e gjithë njerëzve që kanë diabet nuk janë në dijeni për gjendjen e tyre. Sipas statistikave, llogaritet që diabeti është shkak për gati dhjetë për qind të të gjitha vdekjeve të SHBA-së, për moshat 25 vjeç e lart. Ai është gjithashtu shkak kryesor i rasteve të reja të verbërisë në mesin e të rriturve 20-74 vjeç dhe është shkak kryesor i fazës së fundit të dështimit (mosfunksionimit) të veshkave. Përveç kësaj, diabeti është arsyeja kryesore për amputimin e gjymtyrëve, si dhe shkak kryesor i sëmundjeve të zemrës. Deri më tani në botë janë rreth 285 milionë njerëz të sëmurë nga diabeti dhe ky numër pritet të arrijë në 438 milionë në vitin 2030. Rreth 23.6 milionë (7.8%) fëmijë dhe të rritur në SHBA vuajnë nga diabeti tip një

**Artan N. BEJTA**

**S**ëmundje e rrallë që në dukje lë përshtypjen e një sëmundje “të butë” e në fakt krijon ndërlikime aq të mëdha e të shumta, të rënda. Po ashtu rrallë ndonjë sëmundje tjetër e prek dhe e dëmton aq heshhazi e ngadalë, thujse të gjitha organet kryesore të trupit pa përjashtim dhe sidomos enët e gjakut, duke krijuar aksidente kaq dramatike e madje tragjike.

### Çka në të vërtetë është diabeti?

Diabeti i sheqerit (hiperglikemia) ose rritja e nivelit të sheqerit në gjak është sëmundje organike që ka si bazament çrregullimin e metabolizmit të sheqerit në organizëm. Ky çrregullim i metabolizmit të sheqerit çon deri te çrregullimet e funksionit normal të organizmit si: dobësim të tij, dëmtim të organeve jetë-

sore, si veshkat, sytë, zemrën, sëmundjet kardiovaskulare (hipertension, ngushtim të enëve të gjakut/bllokim të tyre, iskemi, infarkt si dhe sulme që sjellin vdekje të papritur). Shkak kryesor i këtij çrregullimi është mungesa ose dobësimi i veprimtimit të hormonit insulin që transporton glukozën deri te qelizat për ta shfrytëzuar atë. Hormoni insulinë është një lëndë kiki-mike që prodhohet nga grupi B i qelizave të pankreasit dhe funksioni i tij është metabolizimi i karbohidrateve (sheqernave).

Në kuptimin e përgjithshëm, sëmundja e sheqerit është e tillë që karakterizohet nga rritja mbi shifrat normale të sheqerit në gjak dhe nga dalja e tij nëpërmjet urinës. Përveç çrregullimit të sheqernave në diabet çrregullohet metabolizmi i yndyrës dhe kripërave. Sëmundja e sheqerit jep ndërlikime akute të menjëhershme dhe ndërli-

kime kronike që zgjasin gjithë jetën. Në mënyrë të përgjithshme, ndërlikimet vijnë si pasojë e uljes ose e ngritjes së sheqerit në gjak dhe kur këto janë respektivisht të menjëhershme, të sëmurët bien në gjendje kome ose në gjumë të thellë. Por sëmundja e diabetit ndikon dhe prek gjithashtu arteriet e zemrës, nga ku mund të shfaqen edhe infarkte të cilat janë sëmundje tepër të rrezikshme ose kur dëmtohen arteriet e këmbës, shfaqet gangrena e këmbës, kur dëmtohen arteriet e syrit shfaqet një ndërlikim nga i cili sëmuren të dy sytë edhe i sëmuri mund të humbasë edhe shikimin, kur dëmtohen arteriet e veshkës shfaqet një dëmtim që në popull njihet me termin azotemia.

Diabeti i sheqerit në bazë të masës së mungesës së insulinës ndahet në dy tipe: diabeti tip I (i varur nga insulina) dhe diabeti tip II (i pavarur nga insulina).



Insulina merret nën lëkurë, çdo ditë në kohë të caktuar, gjysmë ore para marrjes së ushqimit. Doza e insulinës përcaktohet me njësi internacionale. Në fillim insulina jepet nga personeli mjekësor e më vonë pacienti (ose anëtar i afërm i familjes) mësohet dhe edukohet për mënyrën e dhënies së insulinës.

### Diabeti tip I

Lloji i parë dhe më i rëndë i sëmundjes së sheqerit është diabeti mellit tip një i ashtuquajtur edhe diabeti juvenil ose diabeti i të rinjve. Nga vetë emri i sëmundjes prek moshat e reja zakonisht nën moshën 25 vjeçare, madje shpesh fillon në fëmijërinë e hershme. Sëmundja paraqitet papritmas dhe fillimi i sëmundjes është i rëndë. Te ky tip i diabetit pacienti ha shumë, pi shumë, urinon shpesh, humb në peshë dhe mund të ketë kriza të ketoacidozës diabetike. Pasi që rezervat e insulinës te ky tip i diabetit janë të ulura është e nevojshme që ai të mjekohet me insulinë. Me fjalë të tjera të sëmurët me diabetin juvenil janë vartës të insulinës. Insulina merret nën lëkurë, çdo ditë në kohë të caktuar, gjysmë ore para marrjes së ushqimit. Doza e insulinës përcaktohet me njësi internacionale. Në fillim insulina jepet nga personeli mjekësor e më vonë pacienti (ose anëtar i afërm i familjes) mësohet dhe edukohet për mënyrën e dhënies së insulinës.

Tek ky lloj i diabetit shpesh kemi gjendje të rëndë nga hiperglikemia (rrit-

### Statistika

Deri më tani në botë janë të sëmurë nga diabeti rreth


285 milionë njerëz dhe ky numër pritet të arrijë në 438 milionë në vitin 2030. Rreth 23.6 milionë (7.8%) fëmijë dhe të rritur në SHBA vuajnë nga diabeti tip një.

ja e sheqerit në gjak) që shpesh krijon edhe gjendje kome (humbje e rëndë e vetëdijes). Për këtë, marrja e insulinës te këta të sëmurë është e vetmja mënyrë për ta rregulluar nivelin e glukozës në gjak.

### Diabeti tip II

Lloji i dytë i sëmundjes së sheqerit njihet me emrin diabeti tip dy ose i ashtuquajtur me emrin diabeti adult ose diabeti i të rriturve. Sëmundja fillon shpeshëherë në mënyrë të pakuktueshme. Rezervat e insulinës në pankreas gjatë diabetit adult janë normale, mirëpo kemi mosaftësi vepruese të insulinës për të tretur karbohidratet, prandaj te ky tip nuk ka nevojë mjekimi me insulinë.

Dobësimi i masës vepruese të insulinës në gjak vjen si rezultat i superprodimit të masës së disa hormoneve që luajnë rol antagonist (kundërshtues) përballë insulinës dhe dobësimi i disa hormoneve të tjera që bashkëpunojnë me insulinën dhe e forcojnë atë, e bëjnë



atë të aftë për të kryer metabolizmin e karbohidrateve në gjak. Në përgjithësi kuptohet se ky tip i diabetit është më i lehtë se lloji i parë i diabetit.

Shenjat dhe simptomat te ky tip i diabetit janë: humbja e madhe e lëngjeve, pirja e madhe e ujit, oreksi i shtuar, urinimi i shpeshtë, humbja e peshës, lodhjes etj.

### Këshilla

#### Këshilla dietike për të sëmurët nga diabeti:

- Ushqimi të ketë përbërje adekuate;
- Të jetë i shumëllojshëm dhe me shije;
- Të jetë i shpërndarë në intervale kohore të rregullta gjatë ditës;
- Të sigurojë energji të mjaftueshme etj.
- Gjatë dietës duhen të merren së paku 100 g karbohidrate, më pak yndyra dhe proteina, sheqeri duhet të eliminohet.
- Nga pemët mund të përdoren mollët e tharta, qershitë, kivi, dredhëza, vishnje, limonë, portokaj, mandarina etj.
- Është mirë që perimet të merren në formë sallatash ose të ziera.
- Duhet të përdoren lëngjet e pemëve pa sheqer, çaj, kafe në sasi të vogël dhe ujë mineral.
- Yndyrat me prejardhje shtazore është mirë të eliminohen nga ushqimet, ndërsa vajrat dhe yndyrat me prejardhje bimore mund të përdoren.
- Sa i përket mishit preferohet ai i peshkut, i shpezëve dhe i viçit.
- Nëse është dieta hipokalorike ose pacientja është shtatzënë, atëherë duhen shtuar minerale dhe vitamina në formë tabletash.

### Kujdes!

#### Çka nuk duhet përdorur të sëmurët me diabet!

Ndërsa ato që nuk lejohen të përdoren dhe që duhet gjithësesi të informohen pacientët janë: Duhani, alkooli, buka e bardhë, brumërat, gjalpi, ëmbëlsira, çokollatat, bonbonet, akulloret, sheqeri, majonezi, qumështi me shumë yndyrë, kosi i deleve, kajmaku, djathi i yndyrshëm, mishi i konservuar, të verdhët e vezës, bananet, shalqiri, pjepr, rrushi i tharë etj.

### Ndërlikimet e diabetit

Ndërlikimet e largëta, ose të ngadalshme, grupohen si më poshtë:

➤ Ndërlikime që shfaqen në enët e imta të gjakut, në kapilarët e arteriet me kalibër shumë të vogël.

o RETINOPATIA DIABETIKE është ndër ndërlikimet më të hershme

o NEFROPATIA DIABETIKE sidomos në fazat e përparuara të sëmundjes

o NEUROPATITË shkaktohen nga dëmtimi i kapilarëve ushqyes të nervave

➤ Ndërlikime aterosklerotike në enët e gjakut me kalibër të madh.

o INFARKTI I MIOKARDIT (nga bllokimi i arterieve që furnizojnë me gjak muskulin e zemrës).

o TROMBOZA ose hemorragjia cerebrale (nga bllokimi dhe çarja e arterieve që furnizojnë trurin)

o GANGRENAT në këmbë (nga bllokimi i arterieve që furnizojnë gjymtyrët e poshtme). ■

# NUK PI ALKOOL, JAM MUSLIMAN

**Deklarata e Lorik Canës se është musliman dhe nuk pi alkool ka bërë shumë bujë në opinionin turk. Mediat turke i kanë kushtuar shumë vëmendje deklaratës së futbollistit të kombëtares shqiptare**

**Alban BILALI**

**N**jë futbollist mund të hyjë në zemrat e tifozëve të klubit ku luan jo vetëm me lojëra të bukura. Jeta private shpeshherë ka thyer zemrat e tifozëve si për të mirë, si për të keq. Këto ditë, në opinionin turk, ka bërë shumë bujë deklarata e futbollistit shqiptar që luan për klubin më të madh turk Galatasaraj. I pyetur nga mediat turke rreth konsumimit të pijeve kur del me shokët e skuadrës për të festuar fitoret, Cana është shprehur se besimi i tij nuk i lejon të konsumojë të gjitha llojet e pijeve. “Unë i përkas fesë muslimane dhe feja ime e ndalon konsumimin e pijeve alkoolike”, - është shprehur Cana për mediet turke. Kjo deklaratë e Canas ka bërë shumë bujë në opinionin turk, të cilët janë popullsi muslimane mbi 90%. Gazetat turke kanë marrë edhe opinionin e shumë tifozëve të Gallatës në lidhje me deklaratën e Canës. Tifozët e Gallatës janë shprehur shumë të lumtur që në klubin e tyre të zerrës ka futbollistë që besojnë në një Zot dhe i praktikojnë rregullat e fesë islame. Cana është shprehur edhe më herët për besimin e tij. Madje Cana është parë edhe në fushën e lojës duke u lutur dhe kur ka shënuar gol ose ka asistuar për gol, ka bërë me gisht nga qielli, si dedikim për Allahun.

## Largimi i Raijkardit e bën hero Canën

Me largimin e trajnerit holandez Frank Raijkard, klubi turk emëroi për trajner të ri futbollistin e famshëm rumun George Haxhi. Që në



takimin e parë të drejtuar nga trajneri rumun, Cana fitoi zemrat e tifozëve të

“çmendur” të Gallatasarajit.

Mesfushori i përfaqësueses shqiptare ka luajtur vetëm 67 minuta në derbin ndaj Fenerbahçes (0-0), që shihet edhe si ndeshja kryesore e kampionatit turk. Duelet e tij në fillim me Niang, më pas me Emre dhe në fund me brazilianin Aleks, bënë që mediat turke t'i kushtonin një vëmendje të madhe. Titulli “Dashuria e re e tifozëve” dhe fotoja e Lorik Canës në dyluftim me Emre, mbizotëronte në shumë gazeta turke, duke nisur nga “Fanatik”, “365 Gunspor”, ose edhe në uebsajte të ndryshme në internet. Forma e mirë që po kalon me Gallatasarajin që nga ardhja e trajnerit të ri, shuan zërat se Cana mund të largohet që në afatin kalimtar të janarit. Edhe pse historia e transferimeve mund të tregojë të kundërtën edhe për Lorik Canën. ■



# FUTBOLLISTJA SHQIPTARE E NOMINUAR PËR "TOPIN E ARTË"

"Jam shumë e kënaqur me vendimin e FIFA-s për të më futur në këtë dhjetëshe. Ky vendim më bën tepër të lumtur. Jam e nderuar që jam në mesin e lojtareve më të mira në botë, si Marta e Smith", - ka thënë futbollistja shqiptare e lindur në Istog, Fatmire Bajramaj-Lira.

**F**utbollistja nga Kosova, Fatmire Bajramaj, është nominuar nga FIFA për të fituar çmimin më të madh për arritje personale në futboll "Topin e Artë". Ajo është futbollistja e parë shqiptare, si në konkurrencën e femrave ashtu dhe të meshkujve, që nominohet për këtë çmim, që do të ndahet më 10 janar të vitit të ardhshëm. Me rezultatet e arritura, si me përfaqësuesen e Gjermanisë si me klubin e saj Turbine Potsdam, Lira ka arritur të hyjë në mesin e dhjetë futbollisteve më të mira në botë. Lidhur me këtë nominim nga shtëpia më e mad-

"Jam shumë e kënaqur me vendimin e FIFA-s për të më futur në këtë dhjetëshe. Ky vendim më bën tepër të lumtur. Jam e nderuar që jam në mesin e lojtareve më të mira në botë, si Marta e Smith", - ka thënë Bajramaj. Edhe pse gjithçka në karrierë e ka fituar me përfaqësuesen e Gjermanisë dhe me klubet gjermane, Lira ndihet e kënaqur që përfaqëson Gjermaninë, por ndihet krenare që me këtë rast do të përfaqësojë edhe Kosovën në një ceremoni të tillë. "Jam krenare që do ta përfaqësoj njëherësh vendlindjen time, Kosovën", - ka thënë futbollistja shqiptare Fatmire Bajramaj.

Për të arritur këtë çmim Fatmire Bajramaj do të përballet me një konkurrencë të fortë, sepse të nominuara janë : 1. Fatmire Bajramaj - (GER), 2. Birgit Prinz - (GER), 3. Hope Solo - (SHBA), 4. Abby Wambach - (SHBA), 5. Marta - (Brazil), 6. So Yun Ji (Koreja e Jugut), 7. Caroline Seger (Suedi), 8. Kelly Smith (Angli), 9. Camille Abily (Francë), 10. Christine Sinclair (Kanada). Vetë emir i saj që është në këtë dhjetëshe është një e arritur shumë e madhe si për Lirën, po ashtu edhe për sportin shqiptar.

## Karriera e Lirës

Në vitin 1993 familja e Lirës u largua nga Kosova. Lira atëherë ishte 5 vjeçare. Në vitin 1998, Lira filloi karrierën futbollistike në klubin e FSC Mönchengladbach.

Ajo luajti 6 vite për këtë klub, derisa në vitin 2004 tratë

he e futbollit në botë FIFA, Lira është shprehur mjaft e lumtur dhe krenare.

në vitin nënshkroi kontraktin me klubin FCR Duisburg. Pas pesë vitesh me ndërroi mjedis për në vitin 2009 me klubin FCR Turbine Potsdam, klub në të cilin është aktualisht. Për Përfaqësuesen e Gjermanisë Lira luan që nga moshja 15 vjeçare. Ajo ka fituar me Gjermaninë Kampionatin Evropian për femra në vitin 2006. Kurse një vit më vonë fitoi edhe Kampionatin Botëror. Po ashtu Lira ka prezantuar Gjermaninë në Lojërat Olimpike në Pekin, në vitin 2008.

Duisburgun, ajo të nënshkroi klubin FFCTurbine Potsdam, klub në të cilin është aktualisht. Për Përfaqësuesen e Gjermanisë Lira luan që nga moshja 15 vjeçare. Ajo ka fituar me Gjermaninë Kampionatin Evropian për femra në vitin 2006. Kurse një vit më vonë fitoi edhe Kampionatin Botëror. Po ashtu Lira ka prezantuar Gjermaninë në Lojërat Olimpike në Pekin, në vitin 2008.

**Alban BILALLI**

# Hapësirë për reklamim në revistë!

**1/1**  
**100€**

**1/2**  
**50€**

**1/4**  
**25€**

Në vlerat e çmimeve nuk është përfshirë TVSH-ja

Studio për prodhimin e kuzhinave

**kezza**

**5**  
**VITE GARANCION**


Prodhimet tona mund të blihen me kredi përmes **Raiffeisen Bank**

**Made in Kosova**

kkeza@hotmail.com

mob. +377 (0)44 141 909

tel & fax. +381 (0)38 243 863



**Emine Şenlikoğlu**

## **Romani Marija**

Një roman fantastik që përshkruan jetën e një vajze gjermane. E rritur nga një nënë fanatike katolike dhe baba ateist. Ajo duke dashur që ta bind Mehmetin në fenë e saj... e gjen veten diku tjetër. Një rrëfim që të mban lidhur me romanin dhe që nuk të lë të largohesh pa e përfunduar së lexuari.



Kronologjia e ngjarjeve që  
sollën 12 dhjetorin

\* \* \* \*

Retrospektivë

\* \* \* \*

Garë e nxehtë në zgjedhjet  
e jashtëzakonshme

\* \* \* \*

Personat me nevoja  
të veçanta pa  
kushte votimi

Intervistë me analistin politik, Haqif Mulliqi

**KOSOVA DUHET TË KETË POZITË  
DHE OPOZITË TË FUQISHME**



# KRONOLOGJIA E NGJARJEVE



## Gëzim QERIMI

### Gjykata Kushtetuese: Presidenti Sejdiu ka shkelur Kushtetutën

Zhvillimi i ngjarjeve është përshkruar me një dinamizëm të paparashikueshëm. Më 24 shtator 2010, Gjykata Kushtetuese "Në Rastin KI 47/10 "Naim Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Fatmir Sejdiut, Presidenti i Republikës së Kosovës", konstatoi me shumicë votash se kërkesa e dorëzuar më 25 qershor 2010 është e pranueshme. Gjykata, gjithashtu, konstatoi se ka shkelje serioze të Kushtetutës së Kosovës, respektivisht të nenit 88.2, nga Fatmir Sejdiu, duke mbajtur njëkohësisht postin e Presidentit të Republikës dhe të kryetarit të partisë politike Lidhja Demokratike e Kosovës. Vendimi është marrë me shumicë votash. Ndërkohë, pas këtij vendimi, ashtu edhe siç është pritur, ka pasur shumë zhvillime të rëndësishme, sidomos në LDK, por edhe në tërë skenën politike të Kosovës. Sipas Kushtetutës së Kosovës, në nenin 91, ku flitet për shkarkimin e presidentit të Republikës, në pikën 1 të saj thuhet se Presidenti mund të shkarkohet nga Kuvendi nëse është dënuar për kryerjen e krimit të rëndë, ose nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës. Për shkarkimin e tij nevojiten 2/3 e votave të deputetëve të Kosovës. Por, duket që

presidentit Sejdiu i ishte bërë shprehi shkelja e Kushtetutës, ngase ai e shkeli atë edhe në rastin e Qazim Qeskës, duke mos i shpallur zgjedhjet në Rahovec, edhe pse një gjë e tillë i ishte kërkuar nga ministri i Pushtetit Lokal, 8 ditë pasi që Qeska kishte dhënë dorëheqje. Burime të KTV-së insistojnë se vendimi që Rahoveci duhet të shkojë në zgjedhje tashmë është marrë nga Gjykata. Ky burimi i ka thënë KTV-së se më 14 të këtij muaji, MAPL-së i është thënë se duhet të përgatiten për t'ia marrë man-

datin Qeskës dhe për të shpallur zgjedhjet e reja, ngase Qeska kishte shkelur ligjet për zgjedhjet lokale dhe ato qendrore, duke u kthyer në punë 47 ditë pas dorëheqjes.

### Fatmir Sejdiu jep dorëheqjen si President i Kosovës

Presidenti i Kosovës, në një deklaratë për mediat, drejtuar të gjithë popullit më 27 shtator 2010, rreth orës 14:30, dha dorëheqjen e parevokueshme nga ky post, duke respektuar, siç u shpreh ai, vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Me sinqeritet e krenari Sejdiu ka bërë rezyrenë e punës së tij të gjatë në krye të shtetit të Kosovës, ku në dy mandatet presidenciale përmendi arritjet më të bujshme. "Kur kthehem të shoh të kaluarën ndjehem krenar të them se edhe unë kam vënë një vulë në lirinë dhe pavarësinë e vendit", - deklaroi Sejdiu.

Vendimin për largimin nga posti i Presidentit, Sejdiu e justifikoi si një vendim që respekton, në thelb, interesin e qytetarëve dhe institucionet e vendit. Mbajtja e dy posteve, sipas tij, nuk përbën shkelje të Kushtetutës, por meqë Gjykata Kushtetuese vendosi të kundërtën, presidenti Sejdiu nuk i ngelet gjë tjetër, veçse ta pranojë. "Unë kam besuar se mbajtja e postit të LDK-së, duke mos e ushtruar atë profesion,



# E QË SOLLËN 12 DHJETORIN

nuk përbën shkelje të Kushtetutës. Megjithatë Gjykata Kushtetuese vendosi të kundërtën dhe unë e respektoj këtë vendim." Kërkesën e tij, zoti Sejdiu e ka bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, sipas të cilit, ai e "ka shkelur seriozisht Kushtetutën", me faktin se ka mbajtur dy poste, atë të presidentit të Kosovës dhe të kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Në përputhje me Kushtetutën, postin e Presidentit të Kosovës përkohësisht e mori kryeparlamentari Jakup Krasniqi, i cili do të jetë ushtrues i detyrës së Presidentit deri në zgjedhjen e Presidentit të ri, por këtë detyrë, në bazë të kushtetutës, nuk mund ta ushtrojë më shumë se gjashtë muaj.

## Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë

Presidenti në detyrë Jakup Krasniqi, më 15 tetor 2010, shpalli vendimin sipas të cilit zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë do të mbaheshin më 13 shkurt 2011.

Vendimi është marrë duke u bazuar në nenin 90 dhe në nenin 84, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 4, pika 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, si dhe me marrëveshje me partitë politike dhe Komisionin Qendror Zgjedhor.



Vlen të ceket së Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ishte e pajtimit me këtë datë, duke marrë si shkak edhe seancën e Kuvendit të Kosovës, ku pati përplasje të dy partive në koalicionin PDK-së dhe LDK-së. Pas të gjitha këtyre zhvillimeve dramatike, LDK-ja në përpjekje për t'u faktorizuar në skenën politike të Kosovës, bëri një akrobacion të befashëm, përmes të cilit nuk arriti efektin e dëshiruar. Edhe pse ishte caktuar data e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Kosovë, të cilat ishin paraparë të mbaheshin më 13 shkurt 2011, prapëseprapë Fatmir Sejdiu vendosi që LDK-ja ta braktiste koalicionin. Ministrat dhe zv-ministrat e LDK-së u larguan nga Qeveria Thaçi. Ekspertët dhe njohësit e mirë të Kushtetutës theksuan se ministrat, me veprimet e tyre, bënë shkeljen e Kushtetutës pasi që është dashur që ta vazhdonin punën si ministra në dorëheqje, derisa të bëhej zëvendësimi i tyre.

## Bie qeveria Thaçi - zgjedhjet parlamentare më 12 dhjetor

Më 2 nëntor 2010 ra qeveria e Republikës së Kosovës, u shpërnda parlamenti dhe u shpallën zgjedhjet e jashtëzakonshme, që do të mbahen më 12 dhjetor të këtij viti. Vendimi për zgjedhjet e jashtëzakonshme pasoi seancën e Parlamentit të Kosovës që me 66 vota pro, një kundër dhe dy abstenime, i mori besimin qeverisë së kryeministrit Hashim Thaçi. Votimi i mocionit u bë

i mundur me votat e Partisë Demokratike, e cila votoi për rrëzimin e qeverisë së udhëhequr prej liderit të saj.

Mocioni i hartuar nga Aleanca Kosova e Re, i nënshkruar nga 40 deputetë, që u mbështet nga Partia Demokratike në pushtet, nga përfaqësuesit e pakicave kombëtare dhe partia opozitare - Lidhja Demokratike e Dardanisë, u kundërshtua nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Pas votimit, kryeministri në dorëheqje Hashim Thaçi tha se kjo ishte rruga e vetme për daljen nga kriza institucionale.

Pas miratimit të mocionit, ushtruesi i detyrës së presidentit të Kosovës, Jakup Krasniqi, shpalli vendimin për shpërndarjen e Parlamentit dhe njëkohësisht caktoi 12 dhjetorin e këtij viti,





datë të zgjedhjeve të jashtëzakonshme, duke shfuqizuar vendimin e mëherëshëm për zgjedhjet e parakohshme më 13 shkurt të vitit 2011.

Këto vendime pasuan zhvillimet politike pas dorëheqjes së ish-presidentit të Kosovës Fatmir Sejdiu dhe tërheqjes së Lidhjes Demokratike të Kosovës nga koalicioni qeverisës.

Koalicioni qeverisës ndërmjet rivalëve të vjetër, Partisë Demokratike dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, pasoi zgjedhjet e përgjithshme të nëntorit të vitit 2007. Marrëveshja për bashkëqeverisje u arrit në janar të vitit 2008, ndërsa një muaj më vonë, në shkurt të vitit 2008, Kosova shpalli pavarësinë, e cila është njohur nga 70 vende të botës. Zgjedhjet lokale të vitit 2009 shënuan një periudhë përplasjesh ndërmjet partnerëve të koalicionit.

## Partia Demokratike me Kongres Express

Partia Demokratike e Kosovës mbajti kongresin e pestë zgjedhor, në të cilin u zgjodh kryetari i partisë, këshilli drejtues dhe u miratua statuti dhe një deklaratë politike.

Ky subjekt politik konfirmoi për kryetar edhe një mandat Hashim Thaçin, zgjodhi anëtarët e Këshillit Drejtues, i miratoi disa ndryshime statutare dhe nxori një deklaratë politike; edhe pse nuk ka zhvilluar zgjedhje paraprake në nivel aktivësh, nëndegësh e degësh.

Kësisoj, delegatët me afat të skaduar votuan strukturat e reja qendrore, në prag të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të Kosovës. Ngutja për Kongresin është bërë për shkak se subjektet politike, në bazë të legjislacionit kosovar, janë të obliguara t'i mbajnë kuvendet e

tyre zgjedhore jo më larg se 36 muaj nga ai paraprak, nëse duan të certifikohen për të marrë pjesë në zgjedhje.

Që nga themelimi i PDK-së më 1999, Hashim Thaçi ka qenë kryetar i saj. PDK-ja ka bashkëqeverisur nga viti 2001 deri në vitin 2004, me kryeministër të saj Bajram Rexhepin dhe me 2 ministra. Prej përfundimit të këtij mandati e deri në fund të 2007-s ka qëndruar në opozitë, derisa kjo parti u konfirmua si forca e parë politike në vend.

Në fillim të 2008-s, Thaçi u vu në krye të Qeverisë. Ai e drejton akoma ekzekutivin, por është kryeministër në dorëheqje, meqë Kuvendi i Republikës së Kosovës është shpërndarë dhe meqë janë shpallur zgjedhjet e jashtëzakonshme për t'u mbajtur më 12 dhjetor 2010.

## Isa Mustafa kryetar i LDK-së

Delegatët e Lidhjes Demokratike të Kosovës kanë vendosur me votën e tyre që Isa Mustafa të jetë kryetar i LDK-së në katër vitet e ardhshme.

Kuvendi i shtatë zgjedhor i LDK-së u zhvillua me ngut, pas ngjarjeve të reja politike që e karakterizuan Kosovën,

përkatësisht pasi ra Qeveria Thaçi dhe u bë shpërbërja e Kuvendit si dhe shpallja e zgjedhjeve të jashtëzakonshme.

Delegatët e LDK-së duhej të vendosnin për zgjedhjen e strukturave udhëheqëse, kryetarit dhe këshillit të përgjithshëm të partisë.

Gara për të parin e partisë u zhvillua ndërmjet kryetarit të deritanishëm të partisë, Fatmir Sejdiut dhe kryetarit të Prishtinës, Isa Mustafës, ndërsa pas numërimit të votave, ky i fundit doli fitues i mandatit të ardhshëm të kreut të LDK-së.

Të 359 delegatët kanë hedhur votën e tyre për njërin prej dy kandidatëve. Isa Mustafa fitoi me 235 vota, kundrejt 124 votave për kundërkandidatin e tij, Fatmir Sejdiun.

Në fjalimin e tij pas zgjedhjes kryetar i LDK-së, Isa Mustafa ka kërkuar nga delegatët e Kuvendit të VII-të zgjedhor të partisë që Fatmir Sejdiu të shpallet kryetar nderi i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Duke folur për zgjedhjen e tij, Mustafa tha se kjo fitore nuk ishte vetëm e tij, por edhe e Fatmir Sejdiut. Ai pohoi se është i vetëdijshëm se të gjithë presin ndryshime nga ai si kryetar i ri i LDK-së, por tha se këto ndryshime do të bëhen së bashku.

Kosovës i duhet Lidhja Demokratike e Kosovës dhe ajo tashmë po e dëshmon demokracinë e brendshme që e ka përcjellë që nga themelimi i saj - shtoi Mustafa.

Edhe në këtë kuvend, edhe pse ishin pak minuta që kur u bë kryetar i LDK-së, Mustafa nuk la pa kritikuar qeverisjen e deritanishme, duke përsëritur se ai vazhdon të qëndrojë pas mendimit të tij se ajo nuk ka kontribuar për të mirën e vendit.

Kreu i ri i LDK-së u ka bërë thirrje anëtarëve që e kanë braktisur partinë të kthehen dhe t'i fitojnë zgjedhjet bashkërisht. ■



Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka mbajtur Kuvendin e Pestë Zgjedhor

# HASHIM THAÇI RIZGJIDHET KRYETAR I PDK-SË

**Bukurie OSMANI**

**P**artia Demokratike e Kosovës ka mbajtur Kuvendin e Pestë Zgjedhor në të cilin me shumicë votash dhe pas asnjë kundërkandidaturë është rizgjedhur edhe për një mandat kryetar Hashim Thaçi. Në Kongres, po ashtu, është rikonfirmuar edhe mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe i kryesisë.

Kongresi i PDK-së është zhvilluar jashtë agjendës së planifikuar, pas prishjes së koalicionit me Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe pas shpalljes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme.

Pas riemërimit të tij në krye të PDK-së, Thaçi i ka siguruar të pranishmit se partia, të cilën e drejton ai, do të dalë fituese edhe në zgjedhjet e ardhshme, ashtu siç ka fituar në zgjedhjet e kaluara parlamentare.

“Është një besim për suksesin e ri, të cilin do ta arrijmë bashkërisht. Kam marr një përgjegjësi shtesë, të cilën do ta kryej me nder, dinjitet dhe integritet; në përputhje të plotë me kushtetutën dhe ligjet e vendit. Jemi në rrugë të mirë për të shënuar fitore të re, e cila buron prej vullnetit të qytetarëve të Kosovës. Besimi juaj unanimit për mua është besim dhe forcim në bindjen tonë për fitore më bindëse dhe më të thellë në zgjedhjet e ardhshme parlamentare”, - ka thënë Thaçi.

Thaçi ka folur edhe për mandatin e ardhshëm, duke thënë se nën drejtimin e PDK-së, Kosova do ta fitojë liberalizimin e vizave dhe do të jetë e anëtarësuar në NATO dhe në BE.

“Kemi dijeninë, guximin, vendosmërinë, vizionin dhe motivin, prandaj edhe do të korrim sukses, i cili do të frymojë në zhvillimin, modernizimin dhe integrimin e Kosovës edhe në NATO edhe në BE. Mandati i dytë duhet të jetë vit i konsolidimit të shtetit tonë të plotë, i zhvillimit të vendit, krijimit të vendeve të reja të punës, si dhe i rritjes së mirëqenies sociale. Në vitin e parë të mandatit të dytë të qeverisjes sime, qytetari do ta përfitojë liberalizimin e

vizave dhe Kosovën do ta fusim në NATO. Do ta ofrojmë në rrugën drejt BE-së. Kjo do të arrihet me bashkëqeverisje efikase dhe transparente”, - ka deklaruar Thaçi.

Ndër të tjera, i pari i PDK-së ka folur edhe për të arriturat e Kosovës gjatë tre vjetëve të qeverisjes nga ai.

“Kam besim të plotë në vullnetin dhe kapacitetin tuaj, prandaj vizioni ynë i përbashkët do të bartet në çdo qytet, fshat, lagje, familje dhe te çdo qytetar i Kosovës, i etur për t'i vazhduar projektet për zhvillim, të cilat i kemi filluar si nevojë dhe domosdoshmëri për zhvillimin dhe modernizimin e vendit”, - është shprehur kryetari i saporizgjedhur i Partisë Demokratike të Kosovës.

## **Krasniqi: PDK-ja do të bashkëpunojë me të gjitha partitë**

Gjatë punimeve të Kongresit është lexuar edhe një deklaratë politike përmes të cilës është dërguar një mesazh i qartë se PDK-ja, si partia më me madhe e vendit, do të kujdeset për gjitha proceset, të cilat e presin vendin, duke përfshirë edhe zgjedhjet.

Deklaratën e ka lexuar sekretari i përgjithshëm i partisë, Jakup Krasniqi, i cili ka thënë se PDK-ja beson se edhe në zgjedhjet e lira dhe demokratike do ta fitojë prapë besimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

“PDK-ja e ka udhëhequr vendin gjatë proceseve më të rëndësishme, në veçanti në tre vjetet e fundit. PDK-ja beson se zgjedhjet e radhës do të jenë plotësisht demokratike, transparente dhe të monitoruara nga vëzhgues vendorë e ndërkombëtarë. PDK-ja do të bashkëpunojë me të gjitha subjektet politike për të mirën e vendit dhe të qytetarëve tanë”, - ka lexuar fjalë nga kjo deklaratë Krasniqi.

Pas përfundimit të këtij Kongresi, Këshilli Drejtues ka mbajtur mbledhjen e parë, në të cilën ka konfirmuar edhe mandatin e anëtarëve të deritashëm të kryesisë, deri në zgjedhjet e reja brenda partiake.

## **Limaj: PDK-ja e bëri realitet ëndrrën e popullit të Kosovës**

Para të pranishmëve ka folur edhe nënkryet-

ari i kësaj partie Fatmir Limaj i cili ka vlerësuar se PDK-ja gjatë qeverisjes në mandatin e parë ka arritur shumë suksese, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal.

“Kam nderin që në emër të partisë të paraqes një raport për punën në mes të dy kongreseve. Një raport modest, i cili do t'i paraqesë të arriturat madhore të PDK-së gjatë proceseve në të cilat ka kaluar vendi. Për këtë kohë mund të flitet dhe të thuhet shumë për rezultatet dhe sukseset që ka arritur PDK-ja edhe sa ishte në opozitë, por edhe sa është në pushtet”, - ka deklaruar Limaj duke shtuar se:

“Kontributi juaj, delegatë të nderuar, i anëtarëve dhe simpatizantëve të partisë, të cilët punuan në mes të dy kongreseve, dha mundësi që vizioni i fuqishëm i lidershipit, i udhëhequr nga kryetari i partisë, Hashim Thaçi, ta bëjë realitet ëndrrën e kamotshme të popullit për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran”, - ka thënë Limaj.

Sipas tij, resurset njerëzore të PDK-së janë garanci e fuqishme për stabilitetin e partisë, por edhe të vendit në përgjithësi. “PDK-ja, si forca politike më e madhe në vend, ka një shtrirje të gjithanshme në tërë territorin e Kosovës. Partia jonë ka shtuar dhe vazhdimisht shton anëtarë të rinj. Ajo është e përkushtuar fuqimisht në ngritjen e cilësisë së politikave të saj. Resurset njerëzore të PDK-së janë garanci e fuqishme për stabilitetin e partisë, por edhe të vendit në përgjithësi”, - është shprehur Limaj.

Të pranishëm në Kongresin e Pestë Zgjedhor të PDK-së kanë qenë të ftuar edhe përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike. Të pranishëm ishin vetëm përfaqësuesit nga AKR-

ja, PSD-ja dhe nga minoritetet e përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës. Në këtë kongres ka qenë i pranishëm edhe ambasadori i SHBA-ve në Kosovë, Christopher Dell. ■



Lidhja Demokratike e Kosovës ka mbajtur Kuvendin e Shtatë Zgjedhor, në të cilin kanë marrë pjesë 359 delegatë

# Isa Mustafa – Kryetar i LDK-së

Lulzim JAHIRI

**E**dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), pas një debati të gjatë dhe të tensionuar, ka mbajtur Kuvendin e Shtatë Zgjedhor, në të cilin është zgjedhur kryetar Isa Mustafa me 234 vota, kundrejt ish kryetarit Fatmir Sejdiu, i cili ka marrë vetëm 124 vota të delegatëve nga gjithsej 359 delegatë.

Me këtë rast, kryetari i sapozgjedhur i LDK-së, Isa Mustafa ka thënë se fitorja e tij i takon edhe ish-kryetarit Fatmir Sejdiu, të cilin edhe e ka shpallur kryetar nderi.

“Këtë fitore nuk e konsideroj si timen, e konsideroj si fitore të profesor Sejdiut dhe timen, bashkë me ju, sepse kjo është një fitore e përbashkët, sepse vetëm bashkërisht ne mund t’ia arrijmë qëllimet para vetes”, - ka thënë Mustafa.

Ai ka deklaruar para të pranishmëve se do të punojë me të gjithë së bashku për ta fuqizuar LDK-në, për ta rigjeneruar atë dhe për ta kthyer si forcën më të madhe politike në vend.

“Bashkë po marrim përsipër ta bëjmë LDK-në prijëse të proceseve të ndërtimit dhe zhvillimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ne bashkë do ta fuqizojmë LDK-në, do ta hapim atë për të rinjtë, do ta rigjenerojmë dhe do ta kthejmë atë në pozitën të cilës i takon në këtë vend”, - është shprehur kryetari i ri i LDK-së, Isa Mustafa, duke thënë se LDK-në e presin shumë sfida në të ardhmen.

Ndër të tjera, ai ka deklaruar se LDK-ja mbetet simbol i demokracisë në Kosovë dhe një gjë të tillë e ka vërtetuar edhe në kuvendin e fundit zgjedhor.

“Vërtetua se LDK-ja ka qenë dhe mbetet simbol i demokracisë dhe i kulturës politike në vend. Në këtë proces zgjedhor u vërtetua se ne e respektojmë votën dhe se vetëm me votë mund të zgjidhen dhe të ndërrohen individët dhe

në asnjë mënyrë tjetër”, - është shprehur Mustafa, duke shtuar se, si udhëheqës i LDK-së, do të jetë përgjegjës para delegatëve dhe para qytetarëve të Kosovës.

“Kam marr përgjegjësi të madhe para jush dhe para qytetarëve të Kosovës dhe kjo përgjegjësi e jona është përgjegjësi për fitore dhe jemi të bindur në fitoren e të gjithë neve, të atyre që votuan në degë dhe që do të votojnë në zgjedhjet nacionale”, - ka deklaruar ai.

Në Kuvendin Zgjedhor të LDK-së kanë marr pjesë 359 delegatë nga e gjithë Kosova, të cilët ende pa u nisur votimet brohoritnin për Isa Mustafën. LDK-ja ishte kujdesur që i gjithë procesi zgjedhor të shkonte sipas planifikimit, duke thirrur forca të shumta të sigurimit, të cilat mbanin gjithçka nën kontroll.

## Sejdiu: Isha pre e sulmeve

Ndërkaq, i pari i cili foli në Kuvendin Zgjedhor ishte ish-kryetari i kësaj partie, Fatmir Sejdiu, i cili para delegatëve në Kuvendin Zgjedhor të kësaj partie ka bërë thirrje për bashkimin e LDK-së dhe kthimin në shtëpinë e përbashkët të të gjithë atyre që janë larguar ndërkohë nga kjo parti.

Ai ka thënë se LDK-ja është parti e hapur e ideve dhe e veprimeve të guximshme, parti moderne ku realizohen potenciale me kuadro të reja. LDK-ja kombinon tradicionalen dhe modernen.

“Janë këto parime që i dhanë identitetin fisnik, politik dhe qytetëruës popullit dhe vendit tonë, Republikës së Kosovës që ka për embleme filozofinë e presidentit historik të pavarësisë dhe shtetit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugovës, i cili u bë dhe është shenjë respekti për Kosovën në këto 21 vjet kudo në botë”, - ka thënë Sejdiu.

Ndër të tjera Sejdiu ka folur edhe për zhvillimet, të cilat e kanë përcjellë LDK-në gjatë gjithë fushatës parazgjedhore.

“Kohëve të fundit, për muaj të tërë, një fushatë e orkestruar me fyerje dhe denigrime ra mbi veprën e fisme të LDK-së. Unë isha më i godituri, sepse isha në krye të saj, por qëllimi i një sulmi të programuar pa etikë, pa parime kishte për synim të krijonte përçarje, dezintegrim, konfuzion dhe

dobësim të LDK-së, por LDK-ja nuk ra pre e fushatave të orkestruara. E bashkuar pas një procesi të gjerë dhe demokratik zgjedhor sot po dëshmon se është e fuqishme, pikërisht, sepse është partia e njerëzve të lirë dhe e përkushtimit të madh demokratik”, - është shprehur Sejdiu.

## Isa Mustafa në krye të listës zgjedhore

Me të marrë kreun e partisë Isa Mustafa ka bërë të ditur se do të jetë në krye të listës së LDK-së në zgjedhjet e jashtëzakonshme që do të mbahen me 12 dhjetor.

“Do të jem në krye të listës, sepse nuk ka pengesa formale që t’i prij kësaj liste dhe natyrisht pasi të përfundojnë zgjedhjet do të vendos se cilën pozitë do ta mbaj”, - ka thënë Mustafa.

Ai ka kërkuar nga gjithë ata që janë larguar nga LDK-ja që t’i bashkohen kësaj partie për të ecur drejt fitores në zgjedhjet e ardhshme.

“Ne do të jemi të hapur që të bashkëpunojmë. Ne gjithsesi do ta shtrijmë dorën për gjithë ata që dëshirojnë të bashkëpunojnë me ne dhe mendojnë që të futemi në zgjedhje, në të cilat edhe do të fitojmë”, - ka theksuar Mustafa, duke vlerësuar lart zhvillimet në Kuvendin e LDK-së.

“Ne sot përfundua punimet në Kuvendin zgjedhor të LDK-së, kuvend i cili reflektoi demokracinë, votimin transparent dhe unitetin tonë që bashkërisht t’i pranojmë rezultatet e kuvendit”.

Ai, ndër të tjera, ka shprehur bindjen e tij se LDK-ja do të jetë udhëheqëse e vendit pas zgjedhjeve të ardhshme dhe do të punojë për integrimin e vendit në strukturat ndërkombëtare.

“Sot mora përgjegjësinë e kryetarit të LDK-së, përgjegjësi, e cila do të jetë edhe më tej e orientuar në punë të shumta. Ne do të punojmë për ngritjen e shtetit të Kosovës, për ligjshmëri, për demokraci dhe për integrimin tonë në komunitetin evropian”, - është shprehur kryetari i ri i LDK-së, Isa Mustafa.


Të ftuar në Kuvendin Zgjedhor të LDK-së ishin edhe përfaqësues të partive politike dhe të akredituar në Kosovë. Ndërsa pjesëmarrës kanë qenë nënkryetari i AAK-së, Blerim Shala, i cili ka përshëndetur punimet, si edhe ambasadori amerikan në Kosovë, Christopher Dell. ■



# RETROSPEKTIVË

**Jeton ARIFI**

**K**uvendi i shpërndarë ishte konstituar në bazë të rezultateve të zgjedhjeve të 17 nëntorit të vitit 2007, në të cilat Partia Demokratike e Kosovës, e kryesuar nga Hashim Thaçi, arriti t'i fitonte zgjedhjet, duke u renditur partia e parë. Por nuk kaloi shumë kohë dhe Thaçi zgjodhi si partner në qeverinë e re rivalin historik të partisë së tij, Lidhjen Demokratike të Kosovës. Ndërkohë që pavarësia ishte shumë afër, Kosova arriti "marrëveshjen për koalicionin e madh". Vendi filloi të qeverisej nga një kabinet i përbashkët mes PDK-së dhe LDK-së. Marrëveshja u arrit shumë shpejt duke ndarë edhe rolet, kreu i LDK-së, Fatmir Sejdiu, u zgjodh president i vendit, ndërsa kryetari i partisë fituese, Hashim Thaçi, kryeministër. Një hapësirë të rëndësishme në kabinetin "Thaçi" kishin edhe pakicat. Qeveria e drejtuar nga Hashim Thaçi udhëhoqi Kosovën drejt ngjarjes më të madhe, 17 shkurtin e vitit 2008, kur u shpall pavarësia e Republikës së Kosovës. Pas pavarësisë, sfidat më të shpejta ishin njohja ndërkombëtare dhe integrimi në institucionet e rëndësishme botërore. Sfida ishte mjaft e vështirë, pasi Serbia hodhi në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë legjitimitetin e pavarësisë së Kosovës. Më 22 korrik, kjo gjykatë vendosi se pavarësia e Kosovës nuk ishte në mospërputhje me të drejtat ndërkombëtare. Më 15 nëntor të vitit 2009 u zhvilluan edhe zgjedhjet lo-



kale në Kosovë, të cilat ishin të parat të organizuara nga shteti i pavarur. Këto zgjedhje i fitoi në shumicë Partia De-

mokratike e Kosovës, e udhëhequr nga Kryeministri Hashim Thaçi. Lidhja Demokratike e Kosovës, e Presidentit Fatmir Sejdiu, humbi ndjeshëm këto zgjedhje dhe brenda partisë së themeluar nga presidenti i ndjerë Ibrahim Rugova, nisi një proces i gjerë analize, ku një pjesë e oponentëve të Sejdiut kërkonin përgjegjësi të kreu i partisë. LDK-ja megjithatë, pati një dritë në fund të tunelit në zgjedhjet lokale të 15 nëntorit. Kjo "dritë" kishte si terren kryeqytetin dhe si emër Isa Mustafën, i cili arriti të marrë një mandat tjetër si kryetar i komunës më të madhe, duke fituar me mbi 60 për qind të votave. Mustafa, i cili në zgjedhjet lokale përjetoi ngritjen e yllit të tij politik, akuzoi rëndë partnerin kryesor në qeverisje, Partinë Demokratike të Kosovës. Kritikën më pas u zgjeruan edhe nga figura të tjera të LDK-së, që kërkuan ndryshime. Problemet nuk u sheshuan edhe pas një rikompozimi të qeverisë, ku oponentët u bënë ministra. ■

## Numri i vendeve në Kuvend

PDK: 37 deputetë  
LDK: 25 deputetë  
AKR: 13 deputetë  
LDD-PSHDK: 11 deputetë  
AAK: 10 deputetë  
KDTP: 3 deputetë  
PDAK: 3 deputetë  
SLS: 3 deputetë  
SDSKiM: 3 deputetë  
SDA: 2 deputetë  
SNS: 1 deputet  
ND: 1 deputet  
GIG: 1 deputet  
SKMS: 1 deputet  
IRDK: 1 deputet  
SNSDKiM: 1 deputet  
PREBK: 1 deputet

Intervistë me analistin politik, Haqif Mulliqin

# KOSOVA DUHET TË KETË POZIT

- ✦ KQZ-ja më e përgatitur për zgjedhje sesa disa parti politike
- ✦ Isa Mustafa nuk është lideri që ka pritur LDK-ja
- ✦ Është shumë herët që Kosova të ndahet në dy blloqe politike

**Intervistoi: Osman D. GASHI**

**K**osova, brenda një kohe shumë të shkurtër, përjetoi shumë ndryshime në skenën e saj politike. Konstatimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës se ish-presidenti Sejdiu kishte shkelur Kushtetutën, pastaj dorëheqja e tij, menjëherë pas saj, tërheqja e Lidhjes Demokratike të Kosovës prej koalicionit qeverisës që kishte me partnerin e saj Partinë Demokratike të Kosovës, e dërgoi Kosovën në kaos institucional dhe për pasojë solli situatën që Kosova duhej të shkonte në zgjedhje të jashtëzakonshme.

Zgjedhjet u caktuan të mbahen më 12 dhjetor. Tani jemi në periudhën e transferimeve politike, garën e aderimeve të shumta, daljen në skenë të partive dhe listave të reja që synojnë të garojnë dhe të 'rrembejnë' votat e qytetarëve. Është kohë e shkurtër dhe një sfidë për Kosovën që të zgjedhë atë që do ta udhëheqë edhe për katër vite të tjera.

Për tërë këto probleme dhe sfida që e kanë pllakosur Kosovën, për zgjedhjet, për ndryshimet në skenën politike dhe për një parashikim analitik të rezultatit përfundimtar të këtyre zgjedhjeve do të flasim me analistin Haqif Mulliqin.

## **KQZ-ja më e përgatitur për zgjedhje sesa disa parti politike**

**PAQJA: Zgjedhjet e jashtëzakonshme janë caktuar që të mbahen më 12 dhjetor. A është në gjendje Kosova të organizojë zgjedhje të lira dhe demokratike brenda kësaj kohe kaq të shkurtër, duke përfshirë këtu Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ), partitë politike dhe popullin e Kosovës në përgjithësi?**

**MULLIQI:** Unë mendoj se natyra e këtyre zgjedhjeve të parakohshme është vërtet e jashtëzakonshme, por, janë disa çështje të cilat, sipas mendimit tim, janë ngritur për debat në mënyrë të sforcuar për të krijuar ndonjë argument politik, nëse rezultatet e zgjedhjeve nuk do të dalin sipas pritjeve të ndonjë

subjekti politik. Në fund të fundit, KQZ-ja nuk është ndonjë organizatë ad hoc, por është një organizatë e strukturuar, e cila e ka obligim dhe paguhet që të jetë e gatshme që ta ushtrojë funksionin e vet në çdo rrethanë. Pastaj, unë, seriozisht nuk e di se çfarë dallimi esencial dhe spektakolar do të priste dikush të ndeshnim te KQZ-ja, nëse zgjedhjet do mbaheshin në shkurtin e ardhshëm. Unë mendoj se KQZ-ja nuk do ishte, as më shumë e as më pak, e përgatitur edhe nëse këto zgjedhje do shkonin në afatin e rregullt vitin e ardhshëm. Kjo,

s'do mend se nuk do të thotë se KQZ-ja s'është strukturë e aftë, e përgatitur dhe me mundësi që të jetë në krye të detyrës. Bile, unë mendoj se, nëse do t'u referoheshim zgjedhjeve të shkuara në Kosovë dhe nëse do të tërhiqim ndonjë analogji me rajonin,

edhe KQZ-ja edhe organet e tjera ishin dhe janë në nivel dukshëm më të mirë. Ndaj nuk e kuptoj këtë dozë të "frikës" ose të nihilizmit. Nga tërë kjo zhurmë dhe shamatë lidhur me atë se a është a s'është koha për zgjedhje dhe a do t'ia dilnim mbanë, unë e kuptoj vetëm AAK-në, ngase ky subjekt e ka identitet figurën e liderit të saj, Ramush Haradinajn dhe ata të AAK-së, sikundër të gjithë ne në Kosovë, presim që ai ta sfidojë edhe këtë përballje me drejtësinë ndërkombëtare dhe të kthehet në Kosovë. Ramushi është shumë i rëndësishëm për AAK-në. Ndaj dhe argumentet e AAK-së, karshi mosaftësisë së KQZ-së, ishin një tentativë për "blerjen" e kohës dhe ishin krejt të ligjshme. Madje, madje, nëse do të duhej të tërhiqim paralele mes gatishmërisë së KQZ-së nga njëra anë dhe disa subjekteve "skeptike" në lidhje me këto zgjedhje, mbase me keqardhje mund të konstatojmë se, gjithsesi më e përgatitur (dhe më profesionale) del të jetë KQZ-ja se sa disa prej partive politike që ishin të zhur-



# TË DHE OPOZITË TË FUQISHME

mshme lidhur me futjen e parakohshme në këtë proces. Në këtë rrafsh, besoj se është për ta kritikuar edhe skepticizmin e kryetares së KQZ-së e cila, në një mënyrë a tjetrën, hodhi benzinë mbi zjarr kur u paralajmëruan zgjedhjet e dhjetorit, pas taktikave të gabueshme të Fatmir Sejdiut dhe njerëzve rreth tij e që i kushtuan shumë.

**PAQJA: Sa pritet që qytetarët e Kosovës të jenë të gatshëm të dalin në votime në zgjedhjet e para parlamentare që mbahen pas Pavarësisë së Kosovës?**

**MULLIQI:** Shikuar hollë e hollë, mendoj se ndonjë përgjigje pretenduese karshi pyetjes suaj mund të ishte një lloj spekulimi. Janë shumë faktorë që do ta determinojnë interesimin e qytetarëve për këto zgjedhje. Nuk besoj se do jetë ndonjë motiv shtesë ai që e përmendet ju - zgjedhjet e para pas pavarësisë. Të gjithë i dimë shifrën e zgjedhësve në prag të pavarësisë, që ishte një nga momentet më sublimë në historinë e shqiptarëve. Atëherë doli që qytetarët ishin disi të dekurajuar dhe shifrat lanë për të dëshiruar. Me këtë nuk po e them se njerëzit do të abstenojnë, ose nuk duhet të jenë të shumtë në numër, por unë, personalisht, pres që numri të pësojë një rënie në krahasim me zgjedhjet e 2007-ës. Faktorët mund të jenë të ndryshëm, e në veçanti do t'i vë në pah proceset brenda Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me ç'rast, besoj se shumë militantë dhe partizanë të këtij formacioni politik do të jenë tronditur nga skenat dhe prapaske-nat që ndodhën në kuvendin e kësaj partie, por edhe lëvizjet që pasuan.

**Isa Mustafa nuk është lideri që ka pritur LDK-ja**

**PAQJA: Sa do të ndikojë zgjedhja e Isa Mustafës në postin e kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në skenën politike në Kosovë, e sidomos për oponentin e saj, Partinë Demokratike të Kosovës (PDK)?**

**MULLIQI:** Unë, seriozisht, këtyre ditëve jam përpjekur që ta ndaj personalitetin e zotit Mustafa në tre rrafsh: e para – politikanin e talentuar; e dyta – në sfiduesin e krahut radikal



dhe anti PDK (apo anti UÇK) të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të cilët nuk u pajtuan me pozitën dhe rolin që kishte kjo parti në koalicionin qeveritar, dhe, e treta, në politikanin i cili, edhe përkundër premtimeve për forcim dhe unifikim të partisë dhe kthimin e saj në pozitën e dikurshme, e thelloi ndarjen në LDK dhe e ushquu procesin e frank-sionizimit të saj.

Mustafa, edhe për mua ishte mjaft simpatik, me veçimin e mendimit brenda LDK-së, në lidhje me koalicionin, pozitën dhe ambiciet e LDK-së, por, nuk duhet harruar se ardhja e Mustafës në LDK ka krijuar ndarje të reja, të cilat mund të jenë të rrezikshme e të cilat, edhe nëse kanë ekzistuar në kohën e Fatmir Sejdiut, të paktën nuk janë shpërfaqur në përmasë serioze. Ndaj dhe unë mendoj se LDK-ja në një të ardhme shumë të afërme do të shkojë në procese të reja, të ashpra dhe ndonjëherë dramatike të brendshme, ngase, seriozisht besoj se zoti Mustafa nuk është lideri, të cilin e ka pritur kjo parti.

**PAQJA: Si e konsideroni formimin e partive të reja dhe listave qytetare që kanë hyrë në garë në këto zgjedhje të jashtëzakonshme?**

**MULLIQI:** Unë kam respekt për “Vetëvendosjen” dhe liderin e saj. Por, besoj se ata kanë bërë lëvizje më të

ngadalësuar se sa që është dashur. Ata janë konstituuar shumë ngadalë, mbase duke mos i parashikuar proceset politike dhe futjen kaq të shpejtë në zgjedhje. Po të kishin pak më shumë kohë, mendoj se ky subjekt do të ishte shumë më domethënës në skenën politike në Kosovë. Unë mendoj se, po e kaloi pragun prej 5 %, “Vetëvendosja” do të futet fuqishëm që të luajë rol në të ardhmen. Kjo mund të jetë e vështirë ngase asnjëherë në Kosovë deri më tash nuk jemi përballur me një strukturë elektorale më heterogjene seç e ka “Vetëvendosja”. Kjo mund të shkaktojë hendikep.

Sa i përket “FER”-it, unë seriozisht nuk kam vënë re diçka të domethënshme te djemtë që e kanë krijuar atë subjekt. Madje edhe retorika politike e tyre nuk i tejkalon përmasat e retorikës së përditshme të asaj që e kanë thënë ose artikuluar kur ishin në OJQ. Bile, kam frikë se me futjen e Shpend Ahmetit dhe Ilir Dedës në politikë, skena kosovare i ka fituar dy politikanë të flashkët dhe pa mundësi dhe i ka humbur dy OJQ-istë agilë dhe të talentuar.

Në këtë pjesë të gjykimit duhet të them edhe diçka për listën “LDK-Ibrahim Rugova”. Të gjithë njohësit e politikës këtyre ditëve e kanë hetuar një moment i cili ka mundur ta nxirrte LDK-në nga kriza. Besoj se e kuptoni: kjo ka të bëjë me rënien (gati revolucio-

nare) të Fatmir Sejdiut. Unë besoj se po qe se Isa Mustafa do ishte më plastik në gjykim; më i arsyeshëm politikisht, me krijimin e mundësisë së negociimit me Ukë Rugovën dhe njerëzit nga lista e tij, padyshim ka mundur që nga një LDK e plagosur rëndë të krijoj një subjekt shumë pretendues. Por, fatkeqësisht për LDK- në kjo nuk ndodhi. Nuk do mend se Mustafa, as oponentët e tij nga kjo listë, nuk u treguan të aftë që ta menaxhojnë këtë situatë dhe e tëra është kështu si është: LDK e goditur edhe njëherë nga brenda dhe ikja e Ukë Rugovës në përfaqim të AAK-së. Dhe, nëse i lexojmë shenjat politike të kësaj lëvizjeje, objektivisht mund të konkludojmë një gjë: me këtë kalim, pa dyshim më së shumti ka fituar AAK-ja, ngase, duke pasur parasysh faktin se një pjesë e ish-elektoratit të LDK-së ishte e ideologjizuar me mitin, figurën ose atë që e

kanë identifikuar ata: “filozofinë politike të Ibrahim Rugovës”, nuk do mend se duke e shënjestruar Ukën si pasardhës biologjik të tij, do të rreshtohen në drejtim të AAK-së. Por, në fund të fundit, mund të fitojë edhe Rugova dhe dikush prej listës së tij, sado që unë personalisht mendoj se Ukë Rugova është dashur të futet në zgjedhje si subjekt i pavarur, ta sfidojë elektoratin e tij, të fitojë forcë elektorale dhe të faktorizohet në skenën politike kosovare. Por, ajo që mund ta them unë është se ndarja e Ukë Rugovës dhe të tjerëve nga LDK-ja është definitive, dhe se ky, të ardhmen e vet, sigurisht do të përpiqet ta kërkojë në një të ardhme brenda strukturave të AAK-së, ku del të jetë i mirëpritur.

### **Është shumë herët që Kosova të ndahet në dy blloqe politike**

**PAQJA:** *Shumë parti kanë nënshkruar koalicione parazgjedhore, sidomos me Aleancën Kosova e Re (AKR). A do të thotë kjo që Kosova gradualisht po ndahet në dy blloqe të mëdha politike, ku partitë më të vogla po iu bashkëngjiten partive më të mëdha?*

**MULLIQI:** Jo, jo, jo...

Mendoj se për një ndarje të tillë Kosova duhet të presë edhe shumë vjet. Fundja, nuk është e domosdoshme. Ja, nëse i hedhim një shikim edhe lëvizjeve politike në regjion është e qartë se akoma nuk ka ndodhur kjo. Shikoni Serbinë, Maqedoninë, Bullgarinë... Një ndarje e tillë në blloqe është paralajmërim i futjes së

vendit në procese të qëndrueshme politike. Por, sido që të jetë, në Kosovë ka shumë ambicie politike, ambicie për pushtet, ambicie për b a - j r a k - t a -

rizëm dhe as optimistët më të mëdhenj nuk besoj se mund ta parashohin se kur do krijohet skena bipolare politike. Në fakt, aktualisht në skenën politike të Kosovës kemi tre subjekte të fuqishme politike: PDK, AAK dhe LDK. Për të ndodhur ajo për të cilën po flasim, domosdoshmërisht do të duhej të ndodhte dobësimi i njërit prej këtyre subjekteve. Nëse më pyetni se cili do jetë ky, atëherë, në bazë të dobësimit elektorale, krizave dhe skandaleve të brendshme, mendoj se po qe se LDK-ja nuk do të nxjerrë një lider të fuqishëm dhe me vizion, një lider i cili do të jetë i liruar nga praktikatat e të vepruarit që ka pasur në zbatim kjo parti, dikur lëvizje e fuqishme dhe nëse nuk e përzgjedhin një lider pa ngarkesa lokaliste dhe provinciale, atëherë kësaj partie nuk i shkruhet mirë. Test i madh për LDK-në, shumë më i madh se sa besojnë ata vetë, do jenë këto zgjedhje.

**PAQJA:** *Me syrin e analistit, si e parashikoni të ardhmen pas zgjedhjeve? Kë e shihni në pozitë dhe kë në opozitë?*

**MULLIQI:** Kjo do të ishte përgjigja më e pameritueshme që mund t'ua jap në këtë çast. Unë, nga këndvështrimi im, e shoh se partia e cila do të dalë me numrin më të madh të deputetëve nga këto zgjedhje, gjithsesi, do të jetë PDK-ja. Pse? Sepse janë më homogjenë. Sepse e mbajnë pjesën më të madhe të pushtetit vendor. Sepse e kanë identifikuar prijësin e tyre, të cilit mendojmë se i besojnë. Sepse nuk kanë skandale të brendshme dhe luftë të brendshme politike në parti dhe sepse është e qartë se duan të fitojnë përsëri. S'do mend se PDK-ja do të bëjë çmos që të sigurojë një parti më të vogël për koalicionin shqiptar të qeverisë së re të Kosovës, ndërsa secili opsion është i hapur. Por, mbase, për momentin, nuk është aspak e rëndësishme nga ky këndvështrim se kush do fitojë, por cili ose cilat subjekte do kalojnë në opozitë. Kjo më kthen te një konstatim im i para disa muajve në një televizion në Kosovë, kur e kam thënë se pjesa më e dobët e sistemit politik në Kosovë është opozita e dobët dhe jofunksionale. Kjo është një nga ato situata në të cilën Kosova nuk duhet të kthehet. Kjo do të ishte jo vetëm dëm, por edhe rrezik për Kosovën. Ndërsa, dëshira ime për t'i parë në koalicion qeveritar do të ishte marrëveshja mes PDK -së dhe AAK-së gjë që, për mua, mbetet një mision i mundshëm. ■



Partitë politike të gatshme ta nisin garën për zgjedhjet e jashtëzakonshme të dymbëdhjetë dhjetorit

# GARË E NXEHTË NË ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME

**Muhamet JAHIRI**

**Z**gjedhjet e jashtëzakonshme, të shpallura më 12 dhjetor, i kanë shtyrë partitë politike që t'i bëjnë në mënyrë intensive të gjitha përgatitjet brenda një kohe shumë të shkurtër. Partitë politike, përveç përfundimit të kuvendeve zgjedhore, koalicioneve paraelektorale, kanë finalizuar edhe listat e tyre me kandidatët që do të garojnë për deputetë në Kuvendin e Kosovës. Koalicionet dhe aderimet e shumta që janë bërë nëpër subjektet politike kanë ndikuar që shumë parti të kenë edhe probleme me emërtimin e listës për deputetë dhe renditjen e tyre në listë.

Hashim Thaçi i prin listës së PDK-së, Isa Mustafa të LDK-së, Ramush Haradinaj të AAK-së, Behgjet Pacolli listës së koalicionit të partive që janë rreshtuar pas AKR-së, Nexhat Daci të LDD-së, kurse listës së Lëvizjes Vetëvendosje! i prin Albin Kurti. Por ende mbetet e paqartë nëse Haradinaj, Kurti dhe Daci do të jenë pjesë e garës më 12 dhjetor. Për dallim nga zgjedhjet e kaluara, në këto zgjedhje do të marrin pjesë edhe disa subjekte të reja politike si: Lëvizja Vetëvendosje!, Partia Fryma e Re (FER), si dhe Lëvizja qytetare si fraksion i LDK-së, e emëruar Lista "LDK-Ibrahim Rugova".

## **PDK dhjetëshen e parë institucionale**

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në dhjetëshen e parë ka renditur përfaqësuesit kryesorë të partisë. Me numrin një është renditur kryeministri në dorëheqje, njëherësh kryetari i kësaj partie Hashim Thaçi, e më pas kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi si dhe Flora Brovina dhe nënkryetari i parë Fatmir Limaj.



## **Lista e kandidatëve për deputetë në dhjetëshen e parë të PDK-së**

Hashim Thaçi  
Jakup Krasniqi

## **Këto janë partitë politike të cilat kanë aplikuar për certifikim në zyrat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)**

1. KOALICIONI:AKR-PD-PSD-PPI-PPK-PNDSH-PGJK
2. KOALICIONI:VAKAT
3. NOVA DEMOKRATSKA STRANKA-NDS
4. LEVIZJA VETVENDOSJE
5. GRADJANSKA INICIATIVA GORE - GIG
6. CRNOGORSKA DEMOKRATSKA STRANKA - CDS
7. PARTIJA ROME E BASHKUAR E KOSOVES- PREBK
8. PARTIJA E ASHKANLINJEVE PER INTEGRIM- PAI
9. LIDHJA E EGJIPTIANEVE TE KOSOVES-LEK
10. INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVES-IRDK
11. KOSOVA TURK BIRLIGI-KTB
12. PARTIJA DEMOKRATIKE E ASHKALIVE TE KOSOVES-PDAK
13. SOCIJALDEMOKRATSKA STRANKA GORE-SDSG
14. SAVEZ NEZAVISNIH SOCIAJALDEMOKRATA-SNDS
15. SRPSKA DEMOKRATSKA STRANKA KIM-SDSKIM
16. SRPSKA KOSOVSKOMETOHIJSKA STRANKA -SKMS
17. Gradjanska inicijativa-JEDINSTVENA SRPSKA LISTA-JLS
18. BOŠNJAČKA STRANKA DEMOKRATSKE AKCIJE KOSOVA-BSDAK
19. STRANKA DEMOKRATSKE AKCIJE-SDA
20. LIDHJA DEMOKRATIKE E DARDANISË-LDD
21. SRPSKA NARODNA STRANKA-SNS
22. KOSOVA DEMOKRATIK TURK PARTISI-KDTP
23. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVES
24. AAK-RAMUSH HARADINAJ- Lista "LDK-Dr.IBRAHIM RUGOVA"
25. SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA-SLS
26. SRPSKASOCIJALDEMOKRATSKA-SSDS
27. PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVES-PDK
28. FRYMA E RE (FER)

Flora Brovina  
Fatmir Limaj  
Azem Syla  
Vlora Çitaku  
Rrustem Mustafa  
Hajredin Kuçi  
Justina Pula  
Enver Hoxhaj

## **Vetëvendosje: Nis me Albin Kurtin**

Për dallim nga PDK-ja, lëvizja Vetëvendosje! e cila është regjistruar si lëvizje qytetare, listën e saj për deputetë e ka krijuar mbi radhitjen alfabetike. Edhe në këtë formë të përdorimit listës së Vetëvendosjes! i prinë, lideri i saj Albin Kurti, ndërkaq aktivistët më me zë të kësaj lëvizje Glauk Konjufca dhe Visar Ymeri, janë renditur jashtë dhjetëshes se parë.

## **Lista e kandidatëve për deputetë në dhjetëshen e parë të Vetëvendosjes!**

**LËVIZJA  
VETËVENDOSJE!**

Albin Kurti  
Afrim Hoti  
Albana Fetoshi  
Afrim Kasolli  
Agim Kuleta  
Albana Gashi  
Agron Limani  
Ali Jonuzi  
Albulena Haxhiu  
Ali Lahu

## **AKR mbledh rreth vetës shumë parti**

Për dallim nga partitë e tjera Aleanca Kosova e Re (AKR), ka lidhur koalicion

me një numër të madh të partive. AKR-ja ka lidhur koalicion parazgjedhor me Partinë e Drejtësisë (PD), Partinë Socialdemokrate (PSD), Partinë e Pensionistëve dhe Invalidëve (PPI), Partia e Pensionistëve të Kosovës (PPK), Partinë Nacionale Demokratike Shqiptare (PNDSH) dhe Partinë e Gjelbër të Kosovës (PGJK). Kjo parti ka marrë në gjirin e saj edhe një numër të madh të ekonomistëve. Koalicionet e shumta në këtë parti kanë ndikuar edhe në listën e kandidatëve për deputet. I pari në listë radhitet Behgjet Pacolli nga (AKR), e më pas Ferid Agani (PD), Mimoza Kusari – Lila, Muhamet Mustafa (Ekonomist) etj.



### Lista e kandidatëve për deputetë në dhjetëshen e parë të AKR-së me koalicionet

Behgjet Pacolli  
Ferid Agani  
Mimoza Kusari - Lila  
Muhamet Mustafa  
Agim Ceku  
Myzejene Selmani  
Ibrahim Makolli  
Ibrahim Gashi  
Suzana Novobrdaliju  
Esad Brajšhori

### AAK – Lista “LDK- Ibrahim Rugova”, në krye të saj Haradinaj e Ukë Rugova

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), në momentet e fundit, ka lidhur koalicion me iniciativën qytetare Lista “LDK- Ibrahim Rugova”, me të cilën kanë ndërtuar edhe një listë të përbashkët për deputetë. Listës për deputetë i prin i pari kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, i cili momentalisht gjendet në Hagë, ndërsa i dyti në listë është renditur djali i ish-presidentit Ibrahim Rugova, Uka. Ndërsa më të zëshmit e AAK-së, Ahmet Isufi dhe



Naim Maloku, nuk janë radhitur fare në pjesën e parë të renditjes.

### Lista e kandidatëve për deputetë në dhjetëshen e parë të AAK- Lista “LDK- Ibrahim Rugova”

Ramush Haradinaj  
Ukë Rugova -Lista I. Rugova  
Donika Kada - Bujupi  
Blerim Shala  
Ardian Gjini  
Melihate Tërmmkollu  
Burim Ramadani  
Bujar Bukoshi - Lista I. Rugova  
Zylfije Hundozi  
Zafir Berisha - Bashkimi Demokratik

Ndërkaq, lista e Lidhjes Demokratike të Dardanisë, për dallim nga listat e tjera, nuk ka pësuar ndonjë ndryshim. Në dhjetëshen e parë të kësaj partie përsëri janë renditur të gjithë përfaqësuesit kryesorë të kësaj partie, duke filluar nga i pari akademik Nexhat Daci, e më pas edhe nënkryetarja Besa Gaxheri e sekretari i përgjithshëm Lulzim Zeneli.

### Lista e kandidatëve për deputetë në dhjetëshen e parë të LDD-së

Nexhat Daci  
Besa Gaxherri  
Lulzim Zeneli  
Xhemajl Hyseni  
Gani Geci  
Qamile Morina  
Naser Rugova  
Sejdë Tolaj  
Sinavere Rysha  
Sokol Haliti



### LDK-ja e nis listën me Isa Mustafën



Për dallim nga shumica e partive të tjera, Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka dashur ta bëjë publike listën e saj të deputetëve, për shkak të zhvillimeve të fundit në këtë parti. Ndërsa e gjithë ajo çka dihet nga kjo parti është vetëm ajo se në krye të listës për deputet do të jetë kryetari i sapozgjedhur i kësaj partie, i cili njëherësh është edhe kryetar i Prishtinës, Isa Mustafa.

## Zgjedhjet e parak

Demokracia kosovare tanimë gjendet para një sfide të madhe të ndërtimit të një tradite qeverisëse të mirë, ku kërkohet që të vendoset se a jemi për sundimin e parimeve ligjore dhe demokratike, apo dëshirojmë të ndërtojmë institucione dhe shtet të dobët, pa një perspektivë të qartë për integritet ndërkombëtar.

### Ma.sc. Flamur HYSENI

Në demokraci dhe në pluralizmin politik është gjë normale edhe paraqitja e krizave qeveritare, përderisa edhe në shtetet me një traditë të madhe në demokraci, shpeshherë, kemi kriza qeveritare. Është shumë normale që edhe në demokracinë tonë të re dhe të papërvujtë të na paraqitet në momente të caktuara kriza qeveritare. Italia si shtet mjaft i zhvilluar ekonomikisht, politikisht, por edhe si shtet ligjor, anëtare themeluese e BE-së, pas Luftës së Dytë Botërore gjer më tani, ka ndërruar mbi pesëdhjetë qeveri, që i bie se gati çdo vit ka pas krizë qeveritare dhe tanimë është krijuar një traditë e mirë në zhvillimin e demokracisë dhe gjërat kalojnë pa u përjetuar dhe pa u politizuar në nivel të padurueshëm.

Shoqëria kosovare duhet të mësohet t'i ndajë problemet politike nga organizimi i një jete më të mirë për gjeneratat që do të vijnë, duhet të mësohet të dijë të zgjedhë, duhet të mësohet të dijë të



# Parakohshme (e jashtëzakonshme), zgjidhja më e mirë

kërkojë llogari nga të zgjedhurit. Mediet në Kosovë duhet ta ndërrojnë agjendën e ofrimit të informatës të kjo shoqëri, e jo të bëjnë çmos që ta politizojnë çdo pore të jetës shoqërore (është shumë e qartë se kjo është sëmundje ballkanase, por duhet filluar së shëruari). Nuk munden të gjithë intelektualë dhe jo intelektualë, ekspertë dhe jo ekspertë, të jenë kompetentë të flasin vend e pa vend publikisht lidhur me krizën qeveritare që ishte në vend, sepse kjo shpie te një pasiguri politike në vend dhe, domosdo, shndërrohet në kaos politik dhe dezinformim total të shoqërisë.

Shteti ynë është i papërvujtë për nga aplikimi i mirëfilltë i legjisllacionit dhe sundimit të ligjit, edhe pse gjer më tani është vlerësuar pozitivisht për organizim të mirë të të gjitha zgjedhjeve që nga çlirimi, por tanimë demokracia kosovare gjendet para një sfide të madhe të ndërtimit të një tradite qeverisëse të mirë, ku kërkohet që të vendoset, se a jemi për sundim të parimeve ligjore dhe demokratike, apo dëshirojmë të ndërtojmë institucione dhe shtet të dobët, pa një perspektivë të qartë për integritet ndërkombëtar.

Situata në të cilën u gjend qeverisja në Kosovë imponoi një numër mundësish për të dalë nga kriza qeveritare. Në këtë drejtim, mendoj se nga shumë zgjidhje të mundshme, zgjidhja më e mirë është bërë me vendosjen e votimit të mosbesimit të qeverisë në Kuvend, e cila çoi në shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme. Zgjedhje të cilat në aspektin politik po quhen dhe mund të trajtohen si zgjedhje

të jashtëzakonshme, në asnjë mënyrë në aspektin ligjor – kushtetues nuk janë zgjedhje të jashtëzakonshme, por këto zgjedhje janë zgjedhje të parakohshme (shih Kushtetutën e Republikës së Kosovës, 2008, Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë).

Duke analizuar dispozitat e kushtetutës lidhur me mundësinë e zëvendësimit të postit të presidentit në rast se ai jep dorëheqje, ose për ndonjë arsye tjetër nuk do të mund ta ushtrojë funksionin e tij, përcaktohet se atë e zëvendëson Kryetari i Kuvendit, i cili do të jetë në këtë funksion jo më shumë se gjashtë muaj. Kjo praktikë e krijuar tanimë në Kosovë, po tregon se Kushtetuta, ka nevojë të ndryshohet në këtë drejtim, sepse është e mangët sa i përket çështjes së zëvendësimit të presidentit, sepse jep mundësi që presidentin mund ta zëvendësojë Kryetari i Kuvendit. Kjo do të shkaktojë edhe në të ardhmen paqartësi, sepse, po ashtu, me Kushtetutë është e rregulluar që Kryetari i Kuvendit zgjidhet nga grupi parlamentar që ka numrin më të madh të deputetëve në Kuvend, ku përsëri nëse presidenti do të ishte nga partia tjetër dhe në rast të largimit në gjysmë të mandatit ai duhet zëvendësuar nga Kryetari i Kuvendit, i cili është nga partia tjetër dhe, në këtë rast, do të ketë mos pajtueshmëri ndërmjet koalicionit qeverisës dhe do të vijë deri te kriza qeveritare, sepse dihet që qeveria medemos duhet të jetë qeveri e koalicionit, sepse vështirë se në demokracinë kosovare do të mund t'i fitojë shumicën e vendeve në Kuvend një parti e vetme.

Rasti konkret që patëm ishte mjaft specifik, por me gjithë atë kishte prapë zgjidhje. Duke ju referuar dispozitave kushtetuese dhe dispozitave të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, Kuvendi duhet të shpërndahet, gjë e cila ndodhi dhe data e zgjedhjeve të parakohshme duhet caktuar nga presidenti aktual në detyrë, brenda dhjetë ditëve pas shpërndarjes së Kuvendit dhe këto zgjedhje nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë ditë dhe as më vonë se dyzetepesë ditë pas shpërndarjes së Kuvendit (neni 4, paragrafi 5 i ligjit për zgjedhjet e përgjithshme të Republikës së Kosovës). Në këtë drejtim i duhet dhënë përparësi interesit shtetëror dhe shoqëror. Tanimë, shoqëria kosovare dhe institucionet e saj, kanë rastin të tregohen se janë të

gatshme të përballen me sfidat e tilla, duke i respektuar ligjet në fuqi dhe të fillojnë të ndërtojnë një traditë të mirë bashkëpunimi për interesat e përgjithshme të shtetit. Për fat jo të mirë, po në këto momente, ndodhi që edhe dy subjektet politike më të mëdha në vend të gjenden në procesin e tyre të brendshëm zgjedhor, i cili domosdoshmërisht ndikon jo mirë në procesin e tejkalimit të kësaj krize qeveritare, kur dihet se ende institucionet shtetërore janë në fazën fillestare të fitimit të besimit nga ana e popullit, se është duke u ndërtuar shteti ligjor, funksional dhe demokratik.

Nuk do t'i shërbejë interesit publik në asnjë mënyrë deklarimi i zyrtarëve të KQZ-së, në momentet kur qeverisja u fut në krizë, se nuk jemi të përgatitur për zgjedhje, ose nuk garantojmë sukses në mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme ose kaq të shpejta, siç është shprehur KQZ-ja. KQZ-ja duhet ta dijë dhe duhet të jetë në gjendje gatishmërie tash e tutje, sepse në sistemin tonë të qeverisjes ka qeveri të koalicionit dhe në çdo moment pritet të ketë zgjedhje.

Fundja, KQZ-ja është organ kompetent dhe ka obligim ligjor t'i përgjigjet çdo rrethane që eventualisht do të mund të krijohej, sepse kjo është demokracia praktike, për dallim nga ajo teorike. Në demokraci kërkohet që të punohet duke i respektuar rregullat.

Tanimë kur është caktuar 12 dhjetori, data kur do të mbahen zgjedhjet e parakohshme, i gjithë ky proces duhet të kalojë me sa më pak pasoja jo të mira politike dhe ndërtimi i demokracisë dhe funksionimi i saj në Kosovë të shkojë nga drejtimi i demokratizimit të partive politike, sepse nga kjo varet se sa do të jetë edhe shteti demokratik. Kosova ka nevojë për dy parti politike të mëdha dhe dy tjera më të vogla, ashtu që të krijohen parakushte të funksionimit të shtetit në mënyrë sa më demokratike dhe ligjore, kështu që do të ketë edhe opozitë më të fortë, e cila do të kontribuojë më shumë në ndërtimin e shtetit ligjor dhe demokratik, por jo të shkohet me këtë model që është aktual, ku të gjitha partitë, pa marrë parasysh, a kanë potencial dhe kapacitete për ta udhëhequr shtetin, synojnë të marrin pushtetin. ■

*(Autori është asistent në Katedrën e shkencave Kushtetuese – Administrative, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës)*





# Zgjedhjet e imponuara dhe të domosdoshme

**Jeton ISUFI**

**Z**gjedhjet e jashtëzakonshme pasohen si rezultat i krizave institucionale dhe qeveritare në të cilat mund të futet një vend si pasojë e keqmenaxhimit dhe keqpërdorimit, e para se gjithash shkeljeve të dispozitave parimore të shtetit. Futjen e shtetit në kriza të tilla domosdo e sjellin ata të cilët janë bartës të përgjegjësisë institucionale dhe shtetërore, të cilët me dashje ose nga pakujdesia, e sjellin vendin në një situatë të tillë, ku zgjedhjet e jashtëzakonshme janë zgjidhja më e mirë për të dalë nga kriza dhe për ta vendosur vendin edhe njëherë në binaret e funksionimit të legjislacionit të atij vendi. Zgjedhjet e jashtëzakonshme edhe nëse vinë si rezultat i faktorëve jashtë institucionale dhe shtetërore, prapëseprapë në raste të tilla bartësit e institucioneve do fajësohen për mos aftësi. Mirëpo përparësi është se rregullativa e mirë e një vendi i parashihet zgjedhjet e jashtëzakonshme pikërisht në kriza të tilla.

## Pasojat

Pasojat e zgjedhjeve të jashtëzakonshme mund të kenë dimensione të ndryshme, nëse nuk organizohen mirë. Mund të kenë pasoja negative në mbarëvajtjen e tërë procesit zgjedhor dhe mund ta fusin vendin në thellimin e krizave të tjera. Pasojat e tyre, më se shumti, i pësojnë qytetarët e atij vendi. E kundërta, organizimi i mirë i tyre dhe vullneti i të gjithëve për organizimin e tyre do të ketë pasojë pozitive në ndërtimin e in-

stitucioneve më stabile dhe më të qëndrueshme për bartjen e përgjegjësisë.

## Zgjedhjet e jashtëzakonshme në Kosovë të 12 dhjetorit 2010

Shpesh kemi dëgjuar se Kosova është rast 'sui generis' ose i llojit të veçantë. Si duket edhe këto zgjedhje, nga një kënd ose interpretim, janë "sui generis" vështruar nga shumë pikëpamje dhe analiza të shumë analistëve vendorë.

1. Këto zgjedhje erdhën si rezultat i futjes së institucioneve në një krizë, e cila e ka zanafillën në lidhjen e një koalicioni qeveritar të pakapshëm logjiksht, koalicioni i cili u quajt 'për shtetin'. Duke u kamufluar nën këtë moto 'për shtetin ose shtet-ndërtimin', ky koalicion nuk qe jetëgjatë, ngaqë më vonë ndërroi kah dhe u shndërrua në koalicion të lidhur për interesa personale dhe grupe (sepse grupet brenda partive të koalicionit nuk u kënaqën me përfitime).

2. Shpesh këto zgjedhje arsyetohen me atë se parashihen edhe me dispozita ligjore dhe se me këtë rast po zbatohen ato dispozita.

3. Në përgatitjen e këtyre zgjedhjeve dëgjojmë edhe shprehjen që jemi mësuar më shumë ta dëgjojmë në sport: transferimet. Transferimet dhe aderimet e figurave politike dhe jo politike janë më se të theksuara dhe mund të krahasohen lehtë me lojtarët e ekipeve të ligës së kampionëve, madje edhe vetë politikanët i krahasojnë partitë e tyre me ekipe, si "Realiteti".

4. Ajo çka po i bën edhe më interesante këto zgjedhje është inkuadrimi

në politikën institucionale, i atyre të cilët deri dje e kritikonin atë, pra, politikën dhe pozitat politike. Pra, janë këto shoqëritë civile dhe listat qytetare në garë për të zënë ndonjë vend në pozitat shtetërore, duke menduar se aty do ta jepnin kontributin e tyre për "shtetin".

## Këshillë për votuesin (qytetarin)

Zgjedhjet parlamentare ose nacionale, sido që të quhen, qofshin ato të zakonshme a të jashtëzakonshme, janë një proces ose fenomen, i cili tashmë është më se i përhapur në botën demokratike dhe një instrument, i cili po përdoret për të vënë në zbatim demokracinë parlamentare (përfaqësuese), andaj është shumë me rëndësi që këtë instrument ta përdorim mirë, në mënyrë që ky proces të dëshmojë pjekurinë qytetare të vendit tonë në sendërtimin e institucioneve stabile, me njerëz stabilë, në mënyrë që vendi ynë t'i plotësojë standardet ndërkombëtare të një vendi ku zbatohen dispozitat ligjore, në të mirë të qytetarit dhe vetë shtetit, ku funksionimi i mirëfilltë i institucioneve dhe zbatimi i dispozitave ligjore është primar për të zgjedhurit tanë dhe brenga e qytetarit bëhet edhe brengë e përfaqësuesit. Ata të cilët kanë vendosur për të kontribuar në këtë proces, uroj të kenë maturi dhe të dëshmojnë mençuri për zgjedhjen e një lidhshme, i cili interesat e përgjithshme i ka primare dhe mbi ato personale, lidhshme i cili mundohet për ta nxjerrë vendin nga kriza, e jo i tillë që, nga pakujdesia dhe mosdija, veç sa krijon probleme të tjera. ■

Disa nga qytetarët e Kosovës preferojnë të dalin në zgjedhjet e jashtëzakonshme të 12 dhjetorit, pjesa tjetër thotë se nuk do të votojnë, sepse nuk kanë parë udhëheqësi të mirë

## QYTETARËT: DO TË DALIM NË ZGJEDHJE DHE DO TË VOTOJMË ATË QË DO TA SHPIE KOSOVËN DREJT BE-SË DHE NATO-S

Dymbëdhjetë dhjetori po afrohet. Kjo ditë do t'i bashkojë adhuruesit e partive të ndryshme të Kosovës në pika të caktuara për të votuar. Edhe pse këto zgjedhje janë caktuar si të jashtëzakonshme, disa nga qytetarët e Kosovës, për revistën "Paqja", nuk kanë hezitur të tregojnë se do të dalin në zgjedhje dhe do të votojnë atë që do ta shpie Kosovën drejt Bashkimit Evropian dhe NATO-s

### Qëndresë MUSTAFA

**P**rishtinë – Dymbëdhjetë dhjetori po afrohet. Kjo ditë do t'i bashkojë adhuruesit e partive të ndryshme të Kosovës në pika të caktuara për të votuar. Edhe pse këto zgjedhje janë caktuar si të jashtëzakonshme, disa nga qytetarët e Kosovës për revistën "Paqja" nuk kanë hezitur të tregojnë se do të dalin në zgjedhje dhe do të votojnë atë që do ta shpie Kosovën drejt Bashkimit Evropian dhe NATO-s.



Haqif Fana

Haqif Fana, profesor i historisë, ka thënë se do të marrë pjesë në zgjedhjet e 12 dhjetorit. Ai nuk ka hezitur madje të tregojë edhe partinë për të

cilën do të votojë.

"Do të dal në votime më 12 dhjetor dhe do të votoj për më të mirin, pra për Partinë Demokratike të Kosovës, krahun e luftës", - është shprehur Fana.

Ai ka thënë se kjo parti, për tre vite më radhë, ka qeverisur mirë në Kosovë.

"Qeverisja këto tri vite ka qenë e shkëlqyeshme, në bazë të asaj që unë e kam përcjell. Si punëtor i arsimit jam i bindur se edhe dy mandate PDK-ja do ta fitojë qeverisjen e vendit", - ka deklaruar Fana.



Fahri Gashi

Edhe qytetari tjetër nga Prishtina, Fahri Gashi, ka pohuar se do të marrë pjesë në zgjedhjet e 12 dhjetorit dhe se do të votojë për Hashim Thaçin.

"Në zgjedhje do të dal gjithsesi, sepse është Hashim Thaçi, ai i cili e ka shpallur

pavarësinë e Kosovës dhe i ka meritat që gjithmonë të jetë udhëheqës i Kosovës", - ka deklaruar Gashi.

Ai është shprehur i bindur që edhe kësaj radhe PDK-ja do të dalë e para në zgjedhje dhe, sipas tij, me këtë fitore Kosova do të jetë pjesë e NATO-s dhe BE-së.

"Edhe kësaj radhe PDK-ja do të fitojë sepse këto partitë e tjera janë si kalamaj kundrejt PDK-së. Me fitoren e PDK-së, Kosova do të hyjë në NATO dhe në Bashkimin Evropian sepse këto janë edhe qëllimet kryesore të kësaj partie, ndërsa qëllimet e tjera i ka përfunduar", - është shprehur Gashi.



Adnan Berisha

N d r y s h e nga ta, i riu nga Prishtina, Adnan Berisha ka thënë se nuk do të dalë në zgjedhje, sepse politikanët që deri më sot kanë udhëhequr vendin

nuk kanë bërë asgjë për të rinjtë e vendit.

"Personalisht nuk do të dal në zgjedhjet e 12 dhjetorit, pra nuk do të votoj për askënd, sepse deri më sot këta politikanët tanë nuk kanë kryer punë për shtetin dhe rininë tonë", - ka thënë Berisha.

Ai ka treguar se është i vetmi në familjen e tij që nuk do të votojë.

"Ndryshe nga unë, familjarët e mi kanë mendim tjetër dhe ata janë shprehur se do të votojnë", - ka theksuar Berisha.

Pyetjes së redaksisë se: 'A do të dalin në zgjedhjet e 12 dhjetorit?' - i janë përgjigjur edhe Riza Brada dhe Melihate Brada, dy bashkëshortja nga Prishtina.



Riza Brada

"Do të dal në zgjedhje sepse janë votimet më të rëndësishme

deri më sot, sepse tashmë caktohet fakti i Kosovës, prej atij që do t'ia besojë populli votën", - ka thënë Riza Brada, profesor në Universitetin e Prishtinës.

Ai shpreson se popullata e Kosovës kësaj radhe do të votojë njeriun që sipas tij e meriton udhëheqjen e vendit.

"Shpresoj se ky popull do mbushet mend kësaj radhe dhe do ta votojë atë që e meriton. Sipas mendimit tim do të fitojnë ata që e fituan lirinë dhe ata që kanë luftuar", - ka thënë Brada.

Edhe bashkëshortja e tij, Melihate Brada ka deklaruar se do të dalë në



Melihate Brada

zgjedhje sepse pret ditë më të mira për Kosovën.

"Do të dal në zgjedhje dhe do të votoj, sepse po pres ditë më të mira për Kosovën dhe do të votoj për atë që kam votuar gjithmonë dhe nuk do ta tradhtoj", - ka thënë qytetarja Brada.

Ajo, në fund të deklaratës së saj, ka shprehur besimin se në këto zgjedhje do të fitojë më i miri.

"Unë do të votoj për ata që luftuan për ta sjell lirinë dhe ditë të mira për vendin tonë", - është shprehur Brada.

Dymbëdhjetë dhjetori, dita e zgjedhjeve të jashtëzakonshme, është caktuar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi. Një vendim i tillë ka ardhur pas shpartallimit të Kuvendit të Kosovës dhe rënies së Qeverisë.

Vendimi për zgjedhjet e jashtëzakonshme është marrë duke u bazuar në nenin 90, në nenin 66, paragrafi 2, në nenin 84, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në nenin 4, paragrafët 4.5 dhe 4.6 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. ■

# Personat me nevoja të veçanta pa kushte votimi

Në zgjedhjet e 12 dhjetorit, vetëm në Komunën e Prishtinës pritet të votojnë qindra qytetarë me nevoja të veçanta. Mirëpo, për një gjë të tillë, atyre u mungojnë edhe kushtet më elementare, siç janë rrugët e veçanta për karroca, kabinat shumë të larta të votimit dhe dalin edhe probleme të tjera që shfaqen gjatë votimit. Përgjegjësi i HANDIKOS-it në Prishtinë, Faruk Kukaj, ka theksuar se kushtet e votimit kanë qenë më të mira në zgjedhjet e dyta ose të treta pas luftës, sesa këto. Megjithatë përfaqësues të Komisionit Qendror Zgjedhor kanë deklaruar se po krijohen kushtet edhe për këtë kategori të qytetarëve

## Drita VITIA

**Z**gjedhjet për Kuvendin e Kosovës, të cilat pritet të mbahen në Kosovë më 12 dhjetor, po afrohen. Në votim pritet të dalin një numër i konsiderueshëm i qytetarëve me aftësi të kufizuara ose me nevoja të veçanta. Mirëpo, kjo kategori e qytetarëve edhe në këto zgjedhje do të ballafaqohet me vështirësitë e viteve të kaluara. Kjo për shkak se shumica e vendvotimeve në Prishtinë, edhe këtë vit, vazhdojnë të mos kenë rrugica ose kalime për karroca. Kurse Komisioni Qendror Zgjedhor,

edhe këtë vit, vazhdon të mos krijojë kabina të veçanta për këtë kategori të qytetarëve. Faruk Kukaj, përgjegjësi i HANDIKOS-it për zyrën Prishtinë, duke parasysh rindërtimin e lokaliteteve të shpallura të dëmshme nga lufta, ka thënë se marrëdhëniet me autoritetet lokale në Prishtinë, si dhe me Komisionin Qendror Zgjedhor, janë të këqija. Ai ka thënë se marrëdhëniet me autoritetet lokale në Prishtinë, si dhe me Komisionin Qendror Zgjedhor, janë të këqija. Ai ka thënë se marrëdhëniet me autoritetet lokale në Prishtinë, si dhe me Komisionin Qendror Zgjedhor, janë të këqija.

diku në katin e dytë, ku e kam pasur të pamundur të ngjitem dhe jam detyruar të votoj me kusht”, - është shprehur Kukaj. Ai ka shtuar se kjo formë e votimit nuk është formë demokratike dhe se i është mohuar e drejta e votimit.

## Vendvotime të papërshtatshme

Një ndër problemet me të cilët përballen për çdo zgjedhje personat me nevoja të veçanta, janë edhe kabinat e votimit dhe tavolinat e papërshtatshme. Sipas Faruk Kukajt, nga karroca është shumë e vështirë të kryhet procesi i votimit dhe ai ka shtuar se kabinat janë të paarritshme pa ndihmën e dikujt. Sipas tij, KQZ është dashur të vendosë të paktën një kabinë të votimit në çdo

ua mundësojnë atyre votimin.

## KQZ regjistron qytetarët me nevoja të veçanta me të drejtë vote

Megjithatë, Komisioni Qendror Zgjedhor, kohë më parë ka filluar regjistrimin e personave me nevoja të veçanta. Mbështetur në Ligjin për Zgjedhjet dhe në Planin Operacional për Zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010, koha e aplikimit për Regjistrimin e Personave me Nevoja të Veçanta ka zgjatuar prej datës 08 nëntor 2010, deri më 26 nëntor 2010. Programi i regjistrimit të personave me nevoja të veçanta, ka të

### Shteti demokratik

Faruk Kukaj ka apeluar te përfaqësuesit e institucioneve dhe veçanërisht te KQZ-së për krijimin e kushteve për votim. Ai ka thënë se: “kur shteti është demokratik dhe i organizon zgjedhjet, ai duhet të mundësojë votimin për këtë pjesë të popullatës sepse edhe ne jemi pjesë e shoqërisë dhe kemi të drejtë të votojmë. Duam të zgjedhim personin që ne e duam. Ne kërkojmë qasje të barabartë, sepse nuk është shumë për shtetin ose për organizatorin të përgatisin qasje në vendvotim dhe jo të votojmë me ndihmën ose përkujdesjen e dikujt”. Sipas tij, e drejta e votës nuk është të votohet me kusht.

lokaliteteve të shpallura të dëmshme nga lufta, ka thënë se marrëdhëniet me autoritetet lokale në Prishtinë, si dhe me Komisionin Qendror Zgjedhor, janë të këqija.

vendvotim, që do të ishte më e ulët dhe personat me nevoja të veçanta do të mund ta kryenin këtë proces shumë më lehtë e mos ta bojkotonin tërësisht. “Unë edhe pse kam votuar me kusht në një vendvotim tjetër e kam pas vendvotimin shumë të papërshtatshëm, sepse kabina ka qenë shumë e lartë”, - ka theksuar Kukaj. Ai ka shtuar se gjatë takimeve dhe debateve me anëtarët e KQZ-së, këta të fundit janë ankuar se nuk kanë mjete që të bëjnë më shumë në këtë drejtim. Megjithatë, Kukaj ka theksuar se KQZ-ja ka kërkuar listat e personave që janë në shtrat dhe të palëvizshëm, te të cilët shkojnë ekipet mobile të KQZ-së dhe

votimin e zapër shkak të fizike, tësore do tjetër. zotësisë ju-tu regjistruar për votim me këtë program janë: Votuesi duhet t'i ketë së paku 18 vjet, të ketë të kryer regjistrimin civil dhe të dëshmojë identitetin e vet përmes letërnjoftimit të vlefshëm, pasaportës së vlefshme, dokumentit të vlefshëm të udhëtimit, patentës së vlefshme të Kosovës, kartelës së vlefshme të PZHBV-së, ose kartelës së vlefshme e refugjatis. ■